


# STUDIM MBI ÇËSHTJET MJEDISORE RAJONI QENDROR





# Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri

---

Studim tematik mbi çështjet mjedisore në rajonin qendror

**Co-PLAN**  
**Instituti për Zhvillimin e Habitatit**

Shtator 2023

Publikuar nga:  
Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5. rr. Bylis nr.12, Kashar,  
Tiranë, Shqipëri

Web: [www.co-plan.org](http://www.co-plan.org)

Email: [co-plan@co-plan.org](mailto:co-plan@co-plan.org)

Projekti: "Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri"

Autorë:

<b>PhD.C. Rodion Gjoka</b>	Inxhinier Mjedisi dhe Energjie
<b>MP. Erni Kocani</b>	Ekspert Mjedisi
<b>MSC. Sara Korreshi</b>	Ekspert Mjedisi

Redaktoi: **Ana Zhibaj**

## Shënim

"Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit Green-AL, një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida, me fondet e Qeverisë Suedeze. Mendimet dhe sugjerimet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë me domosdoshmëri pikëpamjet e donatorit."

## PASQYRA E LËNDËS

<b>LISTA E SHKURTIMEVE.....</b>	<b>4</b>
<b>LISTA E TABELAVE.....</b>	<b>5</b>
<b>LISTA E FIGURAVE .....</b>	<b>5</b>
<b>LISTA E GRAFIKËVE .....</b>	<b>7</b>
<b>RRETH GREEN-AL.....</b>	<b>8</b>
<b>PËRSE KY DOKUMENT .....</b>	<b>11</b>
<b>1. SFONI RAJONAL .....</b>	<b>12</b>
1.1 TË DHËNAT GJEOGRAFIKE DHE ADMINISTRATIVE .....	12
1.2 BURIMET NATYRORE .....	20
1.3 ASPEKTI SOCIO-EKONOMIK.....	36
1.4 TË DHËNA DEMOGRAFIKE .....	42
1.5 MJEDISI.....	46
<b>2. GRUPE INTERESI TË PËRFSHIRË .....</b>	<b>58</b>
<b>3.PROJEKTE TE ZBATUARA.....</b>	<b>63</b>
3.1 PROJEKTI: "MBROJTJA E BIMËVE MEDICINALE DHE AROMATIKE" .....	63
3.1.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS .....	63
3.1.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	66
3.2 PROJEKTI: ERZENI THËRRET .....	70
3.2.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS.....	70
3.2.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	72
3.2.3 SUGJERIME .....	78
3.3 PROJEKTI: ACTIVE WATER .....	78
3.3.1 SFONDI/PREZANTIMI I ÇËSHTJES .....	78
3.3.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	80
3.3.3 SUGJERIME .....	88
3.4 PROJEKTI: "TRAJTIMI I INTEGRUAR I UJËRAVE TË PËRDORUR PREJ KOMPANIVE TURISTIKE, NË DOBI TË MJEDISIT DHE TURIZMIT, NË PLAZHIN SPILLE, RROGOZHINË" .....	89
3.4.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES.....	89
3.4.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	91
3.4.3 SUGJERIME .....	97
3.5 PROJEKTI: TIRANA JUNGLE CITY .....	98
3.5.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES.....	98
3.5.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	99
3.5.3 SUGJERIME .....	102
3.6 PROJEKTI: EKONOMI QARKULLUESE NËPËRMJET KOMPOSTIMIT TË MBETJEVE ORGANIKE NË BALDUSHK.....	102
3.6.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES.....	102
3.6.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	103
3.6.3 SUGJERIME .....	107

3.7 PROJEKTI: MONITORIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE NËPËRMJET DIXHITALIZIMIT TË TË DHËNAVE.....	107
3.7.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES .....	107
3.7.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	108
3.7.3 SUGJERIME .....	114
3.8 PROJEKTI: FUQIZIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR MROJTJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI .....	115
3.8.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES .....	115
3.8.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	115
3.8.3 SUGJERIME .....	118
<b>4.SUGJERIME DHE MASA.....</b>	<b>119</b>

## LISTA E SHKURTIMEVE

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AMK	Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit Tiranë
BE	Bashkimi European
BMA	Bimë medicinale aromatike
BP	Ballkani Perëndimor
CISP	Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli
COSV	Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
HEC	Hydrocentral
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikës
OJF	Organizata jo-fitimprurëse
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
PBB	Prodhim i Brendshëm Bruto
SIDA	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim
TJS	Tirana Jungle City
UNESCO	Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
VIS	Volontariato Internazionale per lo Sviluppo
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Ndarja administrative .....	13
Tabela 2. Sipërfaqja e qarqeve të rajonit qendror .....	14
TABELA 3: Struktura e vlerës së shtuar bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore në %, 2019 .....	38
TABELA 4: Ndërmarrjet sipas veprimtarisë ekonomike dhe qarqeve, 2020-2021 .....	40
Tabela 5. Popullsia, sipërfaqja e densiteti i popullsisë në rajonin qendror .....	43
Tabela 6. Popullsia rurale .....	44
Tabela 7: Mbetje e krijuara në raport me të menaxhuara. ....	51
Tabela 8: Trajtimi i mbetjeve në tonë në rajonin qendror, 2021. ....	52
Tabela 9. Projekte të zbatuara në rajonin qendror .....	59
Tabela 10. Niveli i ndotjes ne Tiranë përgjatë viteve.....	98

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Ndarja territoriale e vendit për qëllime menaxheriale të Green-AL.....	10
Figura 2: Harta administrative e rajonit qendror .....	12
Figura 3: Harta infrastrukturore e rajonit qendror.....	15
Figura 4: Relievi i rajonit qendror.....	16
Figura 5: Mesatarja e rrezatimit diellor .....	18
Figura 6: Sistemet e territorit në rajonin qendror .....	19
Figura 7: Burimet natyrore në rajonin qendror .....	20
Figura 8: Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta .....	21
Figura 9: Parku Kombëtar Shebenik .....	22
Figura 10: Parku Kombëtar i Dajtit .....	23
Figura 11: Problematika mjedisore në malin e Tomorrit .....	24
Figura 12: Pamje nga Parku Natyror Qafshatamë .....	26
Figura 13 : Harta e monumenteve të natyrës dhe rrejtit ZRSH .....	27
Figura 14: Hidrografia e rajonit qendror.....	29
Figura 15: Fotografi nga lugina e Vjosës.....	30
Figura 16: Pamje ajroreve e liqeneve të Dumresë .....	32
Figura 17: Temperaturat mesatare të ajrit për periudhën 2017 – 2022 dhe sipas normës	34
Figura 18: Vlerat e reshjeve për periudhën 2017 – 2022 kundrejt normës .....	34
Figura 19: Ditët me reshje për vitet 2017 – 2022 kundrejt normës .....	35
Figura 20: Rritja e temperaturave mesatare ndër vite.....	36
Figura 21:Harta e institucioneve arsimore në rajonin qendror .....	41
Figura 22: Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve .....	50
Figura 23: Harta e vërshimit të ujit dhe përmbytjeve në Shqipëri.....	55
Figura 24: Harta e bashkisë Librazhd.....	64
Figura 25: Bimët medicinale aromatike .....	65
Figura 26: Orët mësimore në shkollat e mesme të bashkuara Librazhd .....	67



Figura 27: Mbjellja e fidanëve të aronias në bashkinë Librazhd.....	68
Figura 28: Trajnimi i kultivuesit të BMA-ve .....	69
Figura 29: Vizita studimore në Strugë .....	69
Figura 30: Harta e rrjedhës së lumit Erzen .....	71
Figura 31: Infografikat ndërgjegjësuese.....	74
Figura 32: Ndotja në lumin Erzen .....	75
Figura 33: Pikat e monitorimit .....	75
Figura 34: Organizimi i tryezave të rrumbullakëta, projekti “Erzeni Thërret” .....	77
Figura 35: Intervista me ekspertë mjedisi të zhvilluara nga North Green Association.....	77
Figura 36: Skema ujitëse Arbanë .....	81
Figura 37: Ndotja në kanalim ujitës të Arbanës .....	82
Figura 38: Ndotja e lumit.....	88
Figura 39: Vija bregdetare, Spille.....	90
Figura 40: Pamje e kanalit vaditës i ndotur nga shkarkimet e ujërave të zeza të fshatit Spille .....	91
Figura 41: Lagunazhi Natyror në Francë dhe Maqedoninë e Veriut .....	92
Figura 42: Pamje e kanalit kullues i cili derdhet në detin Adriatik.....	93
Figura 43: Foto nga takimet me grupet e interesit, Bashkia Rogozhinë .....	94
Figura 44 a) Lagunazh me rrjedhje sipërfaqësore (RS)      b) Lagunazh me rrjedhje vertikale (RV).....	95
Figura 45: Pamje të një impianti natyral lagunor me pjesët përbërëse të tij .....	96
Figura 46: Prezantime me nxënësit e klasave të para .....	100
Figura 47: Krijimi i një hapësire të gjelbër të mbjellë nga nxënësit .....	101
Figura 48: Foto nga depozitimi i mbetjeve në Nj.A. Baldushk.....	104
Figura 49: Foto nga trajnimi i fermerëve në Nj.A-në Baldushk .....	105
Figura 50: Foto nga shpërndarja e kontejnerëve të kompostimit në Baldushk.....	105
Figura 51: Foto nga procesi i monitorimit të familjeve gjatë aplikimit të kompostimit ....	106
Figura 52: Foto nga takimi i fundit i projektit të zbatuar nga IPM .....	106
Figura 53: Pamje e platformës dixhitale për monitorimin e gazeve serë.....	109
Figura 54: Foto nga procesi i grumbullimit të të dhënave në bashkitë e projektit .....	110
Figura 55: Foto nga procesi i konsultimit me grupet e interesit në bashkitë e projektit ..	113
Figura 56: Foto nga takimet ndërgjegjësuese me studentët e shkollave të mesme në bashkitë e projektit .....	114
Figura 57: Fotografi nga fushata e ndërgjegjësimit në bashkitë Patos e Roskovec <i>Burimi: Eco Partners for Sustainable Development</i> .....	116
Figura 58: Foto nga procesi i gjelbërimit në bashkitë Patos e Roskovec .....	117
Figura 59: Foto nga procesit i konsultimit të gjetjeve të projektit në bashkinë Roskovec .....	117

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Punësimi sipas sektorëve të ekonomisë .....	39
Grafiku 2: Popullsia e rajonit qendror, janar 2022 .....	43
Grafiku 3: Raporti gjinor në rajonin qendror .....	44
Grafiku 4: Koeficienti bruto i migrimit të brendshëm neto, sipas qarkut 2021 .....	45
Grafiku 5: Gjinia e pjesëmarrësve në aktivitetet e zhvilluara nga OSHC-të .....	61
Grafiku 6: Gjinia e pjesëmarrësve në trajnimet e "Procesit të inkubimit" .....	63
Grafiku 7: Ndotja në segmentin "Burimi i lumit Erzen-Ura e Beshirit" .....	73
Grafiku 8: Parametrat e makro-elementëve dhe të kripshmërisë së ujit .....	84
Grafiku 9: Parametrat e toksicitetit, Bori mg/l .....	84
Grafiku 10: Parametrat e toksicitetit, Kobalt Mg/l .....	85
Grafiku 11: Parametrat biologjikë, BOD Mg/L .....	86
Grafiku 12: Parametrat biologjikë, E.coli CFU / 100 ML .....	86
Grafiku 13: Parametrat biologjikë, Koliforet totale CFU/100 ML .....	87
Grafiku 14: Parametrat biologjikë, Intestinal enterococci, Cfu/100 ml .....	87
Grafiku 15: Konsumi i energjisë elektrike në kWh në bashkinë Roskovec .....	111
Grafiku 16: Konsumi i energjisë elektrike në kWh në bashkinë Divjakë .....	111
Grafiku 17: Konsumi i energjisë elektrike në kWh në bashkinë Kavajë .....	112

## RRETH GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri", Green-AL, janar 2021 – dhjetor 2023, zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me CISP, *Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli*; VIS, *Volontariato Internazionale per lo Sviluppo*; COSV, *Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario*, (Partneriteti). Green-AL është një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida, me fondet e Qeverisë Suedeze.

Projekti ka pasur për qëllim të japë kontribut në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve mjedisore dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve, organizatave me bazë lokale, autoriteteve publike në nivel lokal e kombëtar, institucioneve arsimore, bizneseve dhe komunitetit, duke synuar krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesit për të ngritur e trajtuar çështje mjedisore në nivel lokal, rajonal e kombëtar. Për të arritur këtë qëllim projekti ka pasur këto objektiva:

- 1- Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për të rritur kapacitetet e OSHC-ve mjedisore në vend;
- 2- Prezantimi i modeleve novatore në menaxhimin e mjedisit përmes një skeme gjithëpërfshirëse të nën-granteve;
- 3- Faktorizimi i kontributit të OSHC-ve mjedisore dhe rolit të advokimit në proceset e hartimit të politikave mjedisore.

Për të siguruar një menaxhim të mirë të projektit dhe një mbështetje të vazhdueshme të organizatave mjedisore në Shqipëri, partnerët e projektit, për çështje menaxhimi kanë vendosur të 'ndajnë' territorin e vendit në 4 rajone kryesore. Secili nga partnerët ka qenë përgjegjës për t'u ofruar asistencë dhe mentorim OSHC-ve, të cilat operojnë në rajonin përkatës. Partnerët e Green-AL kanë një eksperiencë të gjatë në hartimin dhe zbatimin e projekteve mjedisore, si dhe në mbështetjen e OSHC-ve në nivel lokal e kombëtar.

### Rajoni qendror

**Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit**, është një organizatë jo-fitimprurëse me një përvojë të gjatë dhe një portofol të gjerë kërkimi në fushën e ofrimit të shërbimeve publike, zhvillimit rajonal, planifikimit urban, menaxhimit të mjedisit, forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe punonjësve të administratës publike, kërkimit në politika e çështje ndër-sektoriale dhe advokimit në proceset politikë-bërëse. Co-PLAN, pozicionohet midis aktorëve me ndikim, me përvojë e të mirë-formuar të Shoqërisë Civile në Shqipëri, me mbi 200 projekte zhvillimi të zbatuara, e angazhuar që nga viti 1995 për ngritjen e advokimit për çështjet mjedisore nëpërmjet dialogut sistematik me institucionet në nivel kombëtar e lokal duke ndërmarrë nisma të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit lidhur me mjedisin.

### **Rajoni veriperëndimor**

**Volontariato Internazionale per lo Sviluppo, VIS Albania/Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillim**, është i pranishëm në Shqipëri që nga viti 1995, me hapjen e vendit ndaj pjesës tjetër të botës. *VIS Albania* është një degë e *International VIS* me seli në Romë, Itali. *VIS Albania* është pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të OJQ-ve nga Spanja, Gjermania, Belgjika dhe Austria dhe ka qenë e vazhdon të jetë e pranishme me projekte zhvillimi në 50 vende të botës, në të gjitha kontinentet. Në kuadër të ndërgjegjësimit botëror për çështjet mjedisore, krahas arsimit, VIS po orientohet gjithnjë e më shumë në zbatimin e projekteve që synojnë ruajtjen e biodiversitetit (Amerika e Jugut) dhe zhvillimin rural (Afrikë dhe Ballkan).

### **Rajoni verilindor**

**Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli, CISP/Komiteti Ndërkombëtar për Zhvillimin e Popujve**, është një organizatë jo-qeveritare europiane (OJQ) e krijuar në vitin 1982 dhe e themeluar zyrtarisht në 1983. Ajo është e vendosur në Itali dhe vepron në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. CISP punon në Shqipëri që nga viti 1998. Në nivel sektorial, gjatë viteve të para të pranisë së saj në Shqipëri, CISP ka realizuar aktivitete me qëllim ndihmën humanitare dhe fushata informuese në nivel kombëtar në çështjet sociale dhe mjekësore. Kohët e fundit, një sektor i ri i ndërhyrjes është zhvillimi urban dhe menaxhimi i territorit, si dhe mbrojtja e mjedisit, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve, ndërgjegjësimin dhe informacionin për çështjet mjedisore në tërësi.

### **Rajoni jugor**

**Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario, COSV/Koordinimi i Organizatave të Shërbimit Vullnetar**, është një shoqatë jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 1968, e angazhuar në zhvillim dhe ndërhyrje humanitare në Europë, Ballkan, Afrikën Jugore dhe Lindjen e Mesme. COSV operon për paqen, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit, përmes shtigjeve gjithëpërfshirëse të zhvillimit të ndërtuara mbi qasjen e partneritetit dhe rrjetëzimit, për të përmirësuar rrethanat lokale dhe për të krijuar një ndikim të provuar e afatgjatë. Puna jonë është e frymëzuar nga "kultura e bashkëpunimit" e kuptuar si solidaritet midis komuniteteve dhe është e orientuar në rindërtimin e kapitalit vendas dhe në vendosjen, përmes komuniteteve dhe në to, të marrëdhënieve të forta, për të mbështetur transformimet e rëndësishme politike dhe ekonomike në themel të zhvillimit.

Figura 1: Ndarja territoriale e vendit për qëllime menaxheriale të Green-AL



Burimi: Përpunuar nga autorët

Përgjatë thujtje 3 viteve të zbatimit të tij, Green-AL ka arritur të mbështesë në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet skemave të granteve më shumë se 50 OSHC, me një shumë totale prej rreth 800, 000 euro të vënë në dispozicion të organizatave që kanë aplikuar. Në thirrjet për projekt propozime në dy skemat e granteve të hapura në Green-AL, OSHC-të mjedisore, kanë aplikuar me rreth 103 projekt-propozime, nga të cilat 31 aplikime janë shpallur fituese dhe kanë zbatuar projektet e tyre në 25 bashki të vendit e trajtuar çështje të cilat shqetësojnë komunitetet të vogla lokale deri tek çështjet mjedisore në nivel kombëtar si ndryshimet klimatike, mbrojtja e natyrës e ndotja.

Partnerët e Green-AL në bashkëpunim me organizatat përfituese të granteve kanë organizuar [5 Forume Kombëtare](#) me qëllim advokimin për çështjet mjedisore të cilat shqetësojnë komunitetet dhe janë me rëndësi kombëtare, duke ofruar gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në proceset e përafrimit të legjislacionit në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian, me fokus kryesor Kapitullin 27, Mjedisori.

## PËRSE KY DOKUMENT

Studimet tematike janë një produkt i hartuar nga Partnerët Green-AL me qëllim evidentimin e çështjeve kryesore mjedisore në 4 rajonet në të cilat zbatohet ky projekt. Ky dokument pasqyron situatën mjedisore të rajonit duke marrë në konsideratë historikun e problematikave, si edhe përditësimin e situatës gjatë viteve 2022-2023.

Në këtë dokument paraqitet një informacion jo shterues për zhvillimin socio-ekonomik e mjedisor në rajonin qendror, për të nxjerrë në pah pikat e forta të këtij rajoni me qëllim promovimin e aseteve dhe potencialeve të zhvillimit, e nga ana tjetër evidentimin e problematikave kryesore mjedisore në mënyrë të fillë që të mund t'i shërbejë grupeve të interesit, me fokus kryesor OSHC-të mjedisore, të cilat në të ardhmen mund t'i adresojnë këto problematika me anë të projekteve mjedisore edhe përtej Green-AL.

Ky dokument, ndër të tjera, ndërton nga praktikatat hulumtuese realizuar nga projektet e zbatuara në Rajonin Qendror më qëllim kapitalizimin e punës së kryer nga OSHC-të mjedisore në këtë rajon. Për këtë qëllim, autori në pjesën e parë të dokumentit paraqet një pasqyrë të përgjithshme të këtij rajoni duke u fokusuar tek zhvillimi urban, social-ekonomik dhe ndikimin e mundshëm që ky zhvillim mund të ketë në mjedis. Ndërsa në pjesën e dytë të këtij dokumenti pasqyrohet puna e kryer e sjellë nga zbatuesit e projekteve.

Të dhënat e paraqitura në këtë dokument janë marrë nga burime zyrtare të informacionit si dhe punime të vetë autorëve. Hartat e paraqitura në raport kanë qëllim ilustrues dhe janë përpunuar nga informacioni ortoimazherik, e për këtë arsye nëse do të zbatohen projekte të cilat parashikojnë ndërhyrje infrastrukturore në zonat urbane apo zonat e mbrojtura, matje e rëvime do të duhet të kryhen në terren për të përfutur sipërfaqe të sakta.

# 1. SFONI RAJONAL

## 1.1 TË DHËNAT GJEOGRAFIKE DHE ADMINISTRATIVE

Rajoni qendror shtrihet në zonën qendrore të Republikës së Shqipërisë si pjesë e Ultësirës Perëndimore dhe kufizohet në veri dhe verilindje me qarqet Lezhë dhe Dibër, në lindje e juglindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe qarkun e Korçës, në jug me qarqet e Beratit, Vlorës dhe Gjirokastrës, ndërsa në pjesën perëndimore kufizohet me Detin Adriatik, me një gjatësi vije bregdetare prej rreth 135 km nga Kepi i Rodonit deri tek grykëderdhja e lumit Seman.

Figura 2: Harta administrative e rajonit qendror



Burimi: Përpunuar nga autorët

Nga pikëpamja administrativo-territoriale, rajoni përbëhet nga 4 qarqe (Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier), nga 21 bashki dhe 137 njësi administrative. Qendra më e madhe administrative e rajonit është qyteti i Tiranës, njëkohësisht dhe kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, në të cilin janë përqendruar edhe institucionet kryesore administrative, financiare dhe arsimore të vendit.

Tabela 1. Ndarja administrative

Ndarja administrative		
Qarku	Bashkia	Njësitë administrative
Tiranë	Tiranë	Tiranë; Petrelë; Farkë; Dajt; Zall-Bastar; Bërzhitë; Krrabë; Baldushk; Shëngjergj; Vaqarr; Kashar; Pezë; Ndroq; Zall-Herr.
	Kamëz	Kamëz; Paskuqan.
	Kavajë	Kavajë; Synej; Luz i Vogël; Golem; Helmas.
	Rrogozhinë	Rrogozhinë; Kryevindh; Sinaballaj; Lekaj; Gosë.
	Vorë	Vorë; Prezë; Bërxullë.
Durrës	Durrës	Durrës; Sukth; Ishëm; Katund i ri; Rrashbull; Manëz.
	Shijak	Shijak; Maminas; Xhafzotaj; Gjepalaj.
	Krujë	Krujë; Fushë-Krujë; Bubq; Nikël; Thumanë; Cudhi.
Elbasan	Elbasan	Elbasan; Labinot-Fushë; Labinot-Mal; Gjinar; Shushicë; Gjergjan; Funar; Shirgjan; Tregan; Gracen; Bradashesh; Zavalinë; Papër.
	Belsh	Belsh; Grekan; Kajan; Fierzë; Rrasë.
	Cërrik	Cërrik; Gostimë; Mollas; Shalës; Klos.
	Gramsh	Gramsh; Pishaj; Kodovjat; Kukur; Kushovë; Lenie; Poroçan; Skënderbegas; Sult; Tunjë.
	Librazhd	Librazhd; Qendër Librazhd; Holtisht; Lunik; Stëblevë Polis; Orenjë.
	Peqin	Peqin; Pajovë; Karinë; Përparim; Gjocaj; Shezë.
	Prenjas	Prenjas; Qykës; Rrajcë; Stravaj.
Fier	Fier	Fier; Cakran; Mbrostar Ura; Libofshë; Qendër; Dërmenas; Topojë; Levan; Frakull; Portës.
	Divjakë	Divjakë; Tërbuf; Grabjan; Gradishtë; Remas.
	Lushnjë	Lushnjë; Allkaj; Bubullimë; Hysgjokaj; Golem; Dushk; Karbunarë; Ballagat; Fier Shegan; Kolonjë; Krutje.
	Mallakastër	Ballsh; Qendër Dukas; Greshicë; Aranitas; Hekal; Ngraçan; Kutë; Fratar; Selitë.
	Patos	Patos; Zharëz; Ruzhdie.
	Roskovec	Roskovec; Kuman; Kurjan; Strum.



Sipërfaqja e përgjithshme e rajonit qendror është 7,575 km<sup>2</sup>, ku qarku i Elbasanit është ai që ka sipërfaqen më të madhe, i ndjekur nga ai i Fierit, Tiranës e Durrësit, siç paraqiten edhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Sipërfaqja e qarqeve të rajonit qendror

Sipërfaqja e rajonit qendror	
Qarku	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )
Tiranë	1,636
Durrës	779
Fier	1,875
Elbasan	3,285
Totali	7,575

Burimi: Përpunim i autorit

## Pozicioni gjeografik

Ky rajon ka një pozicion mjaft të favorshëm gjeografik: duke qenë se është i pozicionuar në qendër të territorit të vendit, ka lidhje të mirë infrastrukturore me të gjitha rajonet e tjera të vendit. Siç ilustron edhe në hartën e paraqitur më poshtë, ky rajon lidhet mjaft mirë nëpërmjet infrastrukturës rrugore me qarkun e Lezhë e cila më pas të mundëson të drejtohesh drejt Republikës së Malit të Zi dhe Kosovës; me qarkun e Korçës, e cila më pas të mundëson të drejtohesh drejt juglindjes së vendit për t'iu qasur pikave kufitare të cilat të lidhin me Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë; qarkun e Vlorës e cila më pas të mundëson qasje në Rivierën shqiptare, portin e Vlorës e Sarandës, si dhe pikat kufitare në jug të vendit të cilat të lidhin me Greqinë.

Një ndër pikat e forta të rajonit qendror është edhe prezenca e aeroportit të Rinasit (më i madhi në vend) si dhe Porti i Durrësit i cili është porti kryesor i vendit si për nga numri i udhëtarëve por edhe në raport me import-eksportit e mallrave dhe produkteve të ndryshme. Gjatë vitit 2021, ka filluar puna edhe për rehabilitimin e infrastrukturës hekurudhore që përfshikon Tiranë-Rinas-Durrës dhe do të lehtësojë më tej transportin e pasagjerëve dhe mallrave ndërmjet këtyre dy qyteteve kryesore të vendit. Projekti i rikonstruksionit të infrastrukturës hekurudhore është një projekt i financuar pjesërisht nga grante në masën 50% dhe 50% është kredi me terma të butë e akorduar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZH.<sup>1</sup> Rindërtimi i rrjetit hekurudhor i cili pas viteve 90' ka shkuar drejt degradimit do të sjellë një zhvillim të mëtejshëm ekonomik të zonës Tiranë-Durrës si dhe do të shërbejë si një hap i parë për ripërtëritjen e infrastrukturës hekurudhore, për t'iu ndjekur më pas me projekte të tjera për rikonstruksionin e rrjetit i cili

<sup>1</sup> <https://www.ebrd.com/news/2021/ebd-and-eu-support-rehabilitation-of-albanian-railway.html>

të lidh me Malin e Zi , qytetin e Vlorës e Elbasanit por potencialisht edhe zgjatimin e saj nga Durrësi në Shkup, pjesë e Korridorit VIII.

Figura 3: Harta infrastrukture e rajonit qendror




Burimi: Co-PLAN 2023, përpunuar nga autorët

## Relievi

Rajoni qendror ka një larmishmëri të formave të relievit duke kaluar nga një lartësi maksimale prej 2,250 m mbi nivelin e detit në Majën e Rreshpës në Parkun Kombëtar Shebenik, Bashkia Librazhd në pjesën lindore duke ardhur e duke u ulur në drejtim të ultësirës perëndimore aty ku bashkohet edhe me detin Adriatik.

Në tërësi, rajoni karakterizohet nga një reliev kodrinor-malor në pjesën lindore të tij kryesisht në qarkun e Elbasanit ku bashkia: e Elbasanit në pjesën lindore, Librazhdit, Gramshit e Përrenjasit kanë një lartësi mesatare më shumë se 700 m mbi nivelin e detit ashtu si dhe pjesa lindore e bashkisë Tiranë dhe Krujë në të cilat shtrihet edhe vargmali i Skënderbeut i cili lidh këto dy bashki, si dhe Mali i Dajtit dhe mali më Gropa me një lartësi maksimale prej 1,600 dhe 1,800 m mbi nivelin e detit.

Figura 4: Relievi i rajonit qendror



Burimi: Co-PLAN 2023, përpunuar nga autorët

Pjesa qendrore e rajonit ka kryesisht një reliev kodrinor fushor me kodra me lartësi nga 700 në 200 m mbi nivelin e detit të cilat karakterizojnë kryesisht territorin e bashkive, Tiranë, Peqin, Belsh, Durrës, Rogozhinë, Patos, Roskovec e pjesërisht në bashkitë Fier e Lushnje. Këto kodra janë kryesisht të mbjella me ullishte e pemë të tjera frutore të cilat ofrojnë edhe peizazhe tepër të bukura rurale e oportunitete për zhvillimin e agro-turizmit e turizmit rural.

Ndërsa pjesa perëndimore e territorit është kryesisht fushore me një lartësi nga 0 m në pjesën ku takohet me vijën bregdetare deri në 200 m mbi nivelin e detit në disa pjesë të territorit. Këto territore fushore të cilat kryesisht janë të vendosura në bashkitë e Lushnjës, Fierit, Kavajës dhe Divjakës njihen për kultivimin e produkteve bujqësore dhe konsiderohen si motori i zhvillimit bujqësor të vendit, të cilat furnizojnë tregun vendas por një pjesë e produkteve të tyre shkojnë edhe për eksport në vendet e Ballkanit Perëndimor e Europë.

## Klima


Pozicioni gjeografik i Shqipërisë bën të mundur që ajo të ketë një klimë mesdhetare me dimër të butë dhe të lagësht e verë të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare vjetore të ajrit ndryshojnë nga 11,3 °C në zonat malore deri në 21,8 °C në ultësi dhe zonat bregdetare, ndërsa temperaturat minimale mesatare vjetore ndryshojnë përkatësisht nga -0,1 °C deri në 14,6 °C.<sup>2</sup>

Sa i përket rajonit qendror, nuk ka të dhëna të disagreguara vetëm për këtë rajon por mund të themi që nuk ka ndryshime nga klima tipike mesdhetare e vendit me dimër të ftohtë e me reshje e verë të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare të këtij rajoni variojnë nga 23.5°C gjatë stinës së verës deri në 6.4°C në stinën e dimrit. Shqipëria për shkak edhe të pozicionit të saj të favorshëm gjeografik ka një rrezatim të mirë diellor përgjatë gjithë vitit, duke arritur në rreth 300 ditë me diell në vit. Më poshtë paraqitet harta e rrezatimit diellor të Shqipërisë dhe potencialit energjetik të saj, referuar zonave të rrezatimit vërehet se bashkitë e rajonit qendror kanë një ekspozim të mirë dhe potencial të lartë energjetik i cili mund të shfrytëzohet nga qytetarët e bizneset për të diversifikuar burimet e energjisë.

---

<sup>2</sup> The Fourth National Communication of Albania on Climate Change

Figura 5: Mesatarja e rrezatimit diellor ditor



Burimi: RDPA 2018

bujqësor me 40 %, ndërsa sistemi urban i cili është i shpërndarë në qytete, fshatra e grumbuj banesash zë vetëm 5% pjesa tjetër rreth 1.4% zihet nga lumenjtë, liqenet e ligatinat. Në hartën e mëposhtme paraqitet në mënyrë grafike shpërndarja e sistemeve ku mund të dallohet qartë që pjesën më të madhe të tij e zë sistemi natyror i përbërë nga pyje, kullota e sipërfaqe me shkurre, e më pas ai bujqësor.


Pavarësisht se sipërfaqja e urbanizuar zë vetëm 5% të territorit të këtij rajoni, ndër shqetësimet kryesore është edhe urbanizimi i shpejt i qyteteve apo zonave peri-urbane, fenomen i cili është shfaqur kryesisht pas viteve 2000 si pasojë e lëvizjeve demografike brenda vendit, me drejtim nga zonat e brendshme të vendit në drejtim të qyteteve

## Sistemet e territorit

Rajoni qendror shtrihet në një zonë gjeografike shumë interesante, ku lehtësisht dallohet diversiteti dhe potencialet e shumta natyrore, e në territorin e saj mund të gjenden male e kodra të veshura me pyje, larmishmëri e burimeve hidrike me liqene e lumenj që përshkojnë këtë territor nga lindja në perëndim e toka pjellore të cilat favorizojnë zhvillimin e bujqësisë. Ky rajon ka dalje në detin Adriatik, me një vijë bregdetare prej rreth 135 km që favorizon zhvillimin e turizmit bregdetar, diversitet të ofertës turistike duke i dhënë mundësinë t'i qasen turizmit malor, lumor si dhe atë të lagunave. Më tej, të apasionuarit ndaj biodiversitetit mund kryejnë aktivitete si ai i vëzhgimit të shpendëve (*birdwatching*) në lagunën e Nartës dhe atë të Karavastasë, pjesë integrale e këtij rajoni. Pavarësisht se mund të konsiderohet një rajon i zhvilluar nga ana e urbanizimit, pjesën më të madhe të sipërfaqes së tij e zë sistemi natyror me 54% të sipërfaqes dhe ai

kryesore si Tirana, Durrësi, Elbasani, Fieri etj. Urbanizimi i shpejt i këtyre qyteteve ka sjellë edhe ndryshime të qenësishme në përdorimin e tokës për të akomoduar nevojat për zhvillim duke i hapur vendin ndërtimit të objekteve rezidenciale, tregtare dhe infrastrukturore duke ndikuar kështu në uljen e cilësisë së mjedisit dhe duke i ekspozuar qytetarët e zonave urbane ndaj problematikave si zvogëlimi sipërfaqeve të gjelbra, cilësi e ulët e ajrit dhe niveli i lartë i zhurmave.

Figura 6: Sistemet e territorit në rajonin qendror




Burimi: Co-PLAN 2023, përpunuar nga autorët

## 1.2 BURIMET NATYRORE

Pjesë e sistemeve natyrore janë edhe zonat e mbrojtura (ZM) të cilat paraqiten në hartën e mëposhtme. Në këtë hartë ilustrohen edhe ato ZM të cila janë kufitare me rajonin qendror pasi menaxhimi i zonave të mbrojtura përfshin një sërë aktorësh në nivel lokal, rajonal, kombëtar e në disa raste ndërkufitar ndërmjet 2 apo më shumë shteteve siç është rasti i parkut të Shebenikut i cili shtrihet edhe në territorin e Republikës së Shqipërisë por edhe në atë të Maqedonisë së Veriut.

Figura 7: Burimet natyrore në rajonin qendror

### Zonat e Mbrojtura Rajoni Qendror



Burimi: Co-PLAN 2023, Përpunuar nga autorët

Në këtë rajon gjenden rreth 19 zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme të cilat ndër më kryesoret janë:

**Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta** është zona e mbrojtur më e rëndësishme përgjatë bregut të rajonit, me sipërfaqe 22,389 ha, sipërfaqe e rishikuar me VKM.59 datë 26.01.20222. Divjakë-Karavasta është shpallur park kombëtar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.687, datë 19.10.2007 dhe si edhe zonë e mbrojtur natyrore për shpendët e ujit, si ligatinë me rëndësi ndërkombëtare sipas Konventës së Ramsarit. Zona strehon rreth 51,000 shpendë uji dhe rreth 500 çifte folezues. Ka habitate të ndryshme, siç janë lagunat, deltat e lumenjve, pyjet e pishave, bimët higrofite etj. Parku dhe zonat përreth përfshijnë edhe vendet kulturore dhe historike, e të gjitha së bashku përbëjnë një potencial të vlefshëm për zhvillimin e turizmit.

Ky park kombëtar është vazhdimisht nën presion, si pasojë e zhvillimit urban dhe aktiviteteve bujqësore të zonës. Ky presion do vazhdojë të rritet, si rrjedhojë e VKM për rishikimin e kufijve të zonave të mbrojtura. Vendimi përjashton nga territori i Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta një sipërfaqe të madhe tokash bujqësore me përdorim tradicional dhe të kontrolluar, duke lënë vend për zhvillim të bujqësisë intensive dhe zhvillimit urban. Referuar Shoqatës Ornitologjike Shqiptare (AOS), pasojat e para negative kanë filluar, dhe pas rishikimit të kufijve gjatë vitit 2022 sipërfaqja e habitateve e zënë me aktivitete bujqësore ka arritur në 39.58% nga 7.75% që ishte në vitin 2012.

Figura 8: Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta



Burimi: Shoqata Ornitologjike Shqiptare (AOS)



**Shebenik** është shpallur Park Kombëtar i kategorisë II, sipas VKM-së nr. 640, datë 21.05.2008. Pjesën kryesore të territorit të parkut e zënë sipërfaqet pyjore, bujqësore dhe kullimore, ndërsa me VKM-në nr.59 datë 26.01.2022, sipërfaqja e ekosistemit natyror Shebenik është rritur nga 33,894 në 34,507. Në territoret e parkut ka një florë të pasur e të larmishme, ku gjenden rreth 32% e florës së Shqipërisë, duke filluar nga bimësia e ulët, pyjet e dushkut, pishës së zezë, ahut, bredhit të bardhë e deri tek kullotat alpine. Specie të rëndësishme të faunës në këtë territor mund të përmendim tritonin, troftën e malit, kaprollin, dhinë e egër, rrëqebullin, shqiponjën, thëllëzën malit etj. Në brendësi të parkut gjejmë disa monumente natyre si Mështekna e Qarrishtës, Shpella e Kosharishtit, Burimi i Studnës, Rrapi i Taksimit, Liqeni i Rajcës etj.

Parku shtrihet në një zonë ndër-kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, ku në të dy anët e kufijve ka pothuajse të njëjtat problematika mjedisore. Problematikat kryesore të parkut janë shfrytëzimi i paligjshëm i pyjeve për dru zjarri, mbetjet të cilat shkaktohen nga turistët dhe komuniteti dhe ndërtimi i paligjshëm. Këto problematika ndikojnë në shkatërrim të habitatit, duke ndikuar drejtë për së drejti në biodiversitetit e zonës.

Figura 9: Parku Kombëtar Shebenik



Burimi: Portali "Digital Invest in Albania"

Ndërtimi i HEC-eve është problematika më e madhe e këtij territori. Referuar hulumtimeve të bëra nga Top-Channel dhe organizata Ekolëvizja, ndër vite vetëm në territorin e Librazhdit janë parashikuar 85 HEC-e, ku 45 prej tyre në territorin e Parkun Kombëtar të

Shebenikut. Organizata mjedisore kanë kundërshtuar ndërtimet e HEC-eve, por pavarësisht kësaj, disa HEC-e janë funksionale dhe kanë sjell dëmtime të mëdha në territor. Ndërmjet fshatit Dragostunj dhe Hotolisht, në vitin 2009 u dha leja e ndërtimit për një HEC, i cili nga veprimtaria e tij ka sjellë devijimin e shtratit të lumit të Shkumbinit dhe shkatërrimin e biodiversitetit të zonës. HEC-et nuk janë i vetmi kërcënim mjedisor i Parkut Kombëtar të Shebenikut. Kullotja, zjarret, prerja e pyjeve dhe gjuetia e paligjshme sjell kërcënime për habitatet, florën dhe faunën.

**Mali i Dajtit** ndodhet në verilindje të qytetit të Tiranës dhe është shpallur Park Kombëtar i kategorisë së II sipas VKM-së nr.59, datë 26.01.2022. Sipërfaqja e parkut është 28,561 ha dhe shtrihet në pjesë qendrore të vargmalit Krujë-Dajt, me gjatësi rreth 30 km dhe gjerësi 10-15 km. Sasia e madhe e reshjeve në kombinim me terrenin shkëmbor të papërshkrueshëm, ka favorizuar krijimin e një rrjeti të dendur ujor. Në territorin e parkut janë identifikuar 991 lloje bimësh enëzore, 4 lloje endemike bimore, 122 lloje shpendësh dhe 43 lloje gjitarësh. Referuar Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Tiranë, në brendësi të parkut gjenden një numër i lartë llojesh me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat bëjnë pjesë në listën e llojeve të rrezikuara (*Red List*, IUCN) me lloje si: *Lilium albanicum*, *Orchis albanicus* (endemike), *Cerastium pierperanum*, *Corylus colure*, *Digitalis lanata*, *Taxus bacata*, *Saturea montana*, *Quercus ilex* etj.

Figura 10: Parku Kombëtar i Dajtit



Burimi: Instituti i Edukimit, Trashëgimisë dhe Turizmit

Pavarësisht mjedisit natyror të rëndësishëm që ka ky park, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për rishikimin e kufijve të zonave të mbrojtura, këtij parku i është reduktuar sipërfaqja nga 29,384 ha në 28,561 ha. Përveç reduktimit të sipërfaqes së tij, parku kombëtar është i rrezikuar nga aktiviteti i disa kompanive të cilat operojnë në territorin e këtij parku duke tërhequr prej ti materiale inerte e duke zvogëluar në këtë mënyrë sipërfaqen e gjelbër. Gjithashtu duke qenë se parku i madh i Dajtit është një atraksion turistik për banorët e qytetit të Tiranës por jo vetëm, problematika ka gjithashtu me urbanizimin dhe menaxhimin e mbetjeve shtëpiake, ku jo rrallë në territorin e këtij parku gjenden pirgje me mbetje të ndryshme.

**Mali i Tomorrit**, pjesë e qarkut të Elbasanit, është shpallur Park Kombëtar referuar VKM-së nr.432, datë 18.07.2012. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 26.01.2022 ky park zgjerohet nga 26,106.176 në 27,158.5 ha. Në territorin e parkut gjenden rreth 141 lloje shpendësh, 34 lloje gjitarësh, 11 lloje amfibësh, 19 lloje zvarranikësh, 22 lloje flore të rëndësishme, 18 lloje endemike etj. Burimet e famshme të Bogovës, të Kërpicës, ujëvara e Sotirës, luginat e gjelbra dhe malet e parkut krijojnë një peizazh çlodhës dhe një vend të përsosur për veprimtari të larmishme turistike: mundësi të shumta për ski, ngjitje mali dhe alpinizëm, çiklizëm malor etj.

Figura 11: Problematika mjedisore në malin e Tomorrit



Burimi: Top Channel

Megjithatë, pavarësisht larmishmërisë së florës dhe faunës, në këtë park nuk mungojnë edhe problemet mjedisore. Parku ndër vite i është nënshtruar prerjeve të paligjshme të pyjeve, veprimtari e cila ka rezultuar në humbjen e habitateve të vlefshme dhe ka kërcënuar mbijetesën e shumë specieve bimore dhe shtazore. Gjuetia e kafshëve të egra është një problem madhor në park, ku kafshët si arinjtë e murrmë, ujçërit dhe rrëqebulli janë veçanërisht të prekshme ndaj kësaj veprimtarie, gjë që mund të ndikojë ndjeshëm në popullatat e tyre.

Ndër problematikat më shqetësuese në malin e Tomorrit është veprimtaria e guroreve. Shumë kompani të cilat operojnë në biznesin e nxjerrjes së pllakave të gurit, e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre ndër vite në këtë zonë të cilat shpesh herë në kundërshtim me lejet mjedisore të marra për ushtrimin e aktivitetit nuk kanë marrë masa për rehabilitimin e natyrës duke lënë një mjedis të degraduar e vështirësisht të rikuperueshëm.

Pas paditjeve të shumta të organizatave mjedisore dhe medias, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka pezulluar aktivitetin e disa prej kompanive që operonin në këtë park, megjithatë një monitorim i vazhdueshëm duhet të ndërmerret nga instancat ligj-zbatuese për të mbajtur në kontroll shfrytëzimin e këtij asemi natyror.

**Parku Natyror “Qafështamë”**, i cili me VKM nr. 60, datë 26.1.2022 i ndryshoi statusi nga Park Kombëtar në “park natyror” (kategoria IV e zonave të mbrojtura), me sipërfaqe nga 2,000 ha në 6,864.36 ha.

Ky park është pjesë e vargmaleve malore të Skënderbeut i cili përbëhet nga dy vargmale kryesore Krujë-Dajt dhe vargmali Mali i Skënderbeut – Mali me Gropa. Ky park ka vlera të larta të florës dhe faunës, ky pyjet e tij janë kryesisht të dominuara nga pisha e zezë dhe ahë në lartësitë mbi 800-900 m mbi nivelin e detit ose me dushqe dhe shkozë poshtë këtyre lartësive. Gjithashtu janë identifikuar disa lloje amfibësh e zvarranikësh si: *Salamandra salamandra*, *Triturus vulgaris*, *Bufo bufo*, *Rana dalmatina* dhe *Hyla arbore*; apo shpendë të ndryshëm si: Bufi (*Bubo bubo*), shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*), huta grerëza-ngrënëse (*Pernis apivorus*), Krahëthati (*Falco peregrinus*), gjeraqina (*Accipiter gentilis*), qukapiku i zi (*Dryocopus martius*), korbi (*Corvus corvus*). Ky park njihet edhe për burimet e ujit të pijshëm ndër më kryesorët është edhe Kroji i Nënës Mbretëreshë, i cili është edhe biomonument natyror.

Parku i Qafështamës ka potencial të lartë zhvillimi duke qenë se ndodhet afër qyteteve të Durrësit, Krujës dhe Tiranës por për shkak të infrastrukturës së dobët automobilistike ka pasur zhvillim të vogël, e cila nga një anë mund të konsiderohet edhe si një aspekt pozitiv pasi e ka ruajtur atë nga degradimi dhe shfrytëzimi i burimeve. Ndër problematikat kryesore në këtë park mund të përmendim zjarret, të cilat shpesh herë kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në masivin pyjor të këtij parku.

Figura 12: Pamje nga Parku Natyror Qafshatamë




Burimi: AlpeNews

Gjithashtu në rajonin qendror ka edhe 5 zona të rëndësishme për shpendët (ZRSH, ose IBA - Important Bird Areas), të cilat konsiderohen tepër të rëndësishme për shpendët dhe kryesisht në këtë rajon janë përqendruar përgjatë brigjeve detare ku një pjesë e tyre janë edhe pjesë e zonave të mbrojtura.

Në hartën e mëposhtme përtej ZRSH-ve paraqiten edhe monumentet e natyrës të cilat janë nga më të ndryshmet, ku mund të listojmë: shpella karstike, burime të ndryshme, dru/grupe drush, kanione, liqene akullnajore, peizazhe karstike, plazhe për një total prej 174 monumente natyrore.

Figura 13 : Harta e monumenteve të natyrës dhe rrjetit ZRSH

## Monumentet e natyrës dhe rrjeti ZRSH



Burimi: Co-PLAN 2023, përpunuar nga autorët

Pavarësisht rëndësisë së tyre, këto habitate dhe specie janë duke u përballur me sfida, të cilat kryesisht kanë ardhur si pasojë e aktivitetit njerëzor sikurse janë veprimtarit e guroreve, depozitimi i mbetjeve, shkarkimi i ujërave teknologjike të pa-trajtura nga sektori i përpunimit të naftës, prerja e pyjeve, gjuetia e paligjshme, zjarret, ndërtimi i HEC-eve si edhe rishikimi i kufijve të zonave të mbrojtura. Këto aktivitete kanë sjell dëmtime të qenësishme në territoret e lartë përmendura sikurse janë humbja e habitateve të vlefshme e cila ka kërcënuar mbijetesën e shumë specieve bimore dhe shtazore; reduktim i sipërfaqes së zonave të mbrojtura, zhveshje të shpateve të maleve nga gjelbërimi, devijim të shtratit të lumenjve, shkatërrimin e biodiversitetit dhe të peizazhit të zonës.

## Hidrografia

Rajoni qendror ka një rrjet hidrografik tepër të pasur duke qenë se territorin e tij përshkojnë 5 lumenj ndër më kryesorët në vend të cilët e përshkojnë atë kryesisht nga lindja në drejtim të perëndimit për tu derdhur më pas në Detin Adriatik. Rajoni qendror ka edhe një numër të madh rezervuarësh artificiale të krijuara nga njeriu me qëllim grumbullimin e ujit të shirave dhe shfrytëzimin për vaditje në tokat bujqësore nëpërmjet rrjetit të kanaleve kullues e vaditës, i ilustruar edhe në hartë, si edhe disa liqene ku ndër më kryesorët mund të përmendim grupin e 88 liqeneve të Dumresë të cilët janë me origjinë karstike.

Këtë rajon e përshkojnë 5 lumenj kryesor të cilët janë (Pano, 2008):

**Lumi Vjosa** është një nga lumenjtë e fundit natyror në Europë. Vjosa së bashku me degët e saj ka një gjatësi prej 400<sup>3</sup> km i cili buron nga vargmali i Pindit në Greqi duke përshkruar vendin tonë nga juglindja deri në pjesën jug perëndimore në afërsi të Poros në detin Adriatik.

Lugina e Vjosës përbën një sistem dinamik dhe zë pothuajse 16% të territorit të Shqipërisë, ku me ndarjen e re territoriale të viti 2014, 10.13% e territorit të saj shtrihet në qarkun e Fierit. Habitatet e këtij ekosistemi strehojnë një shumëllojshmëri specimesh të florës dhe faunës e cila ngjall shumë interes për vizitorët vendas e të huaj.

Ndërtimi i HEC-eve në këtë luginë ka qenë një kërcënim shumë i madh ndër vite pasi ndërtimi i digave mund të sillte pasoja të rënda për mjedisin natyror dhe habitatin. Përgjatë rrjedhës së Vjosës parashikohej të ndërtohej një total prej 42 HEC-esh, projektet e të cilave u kundërshtuan nga komuniteti lokal në forma të ndryshme si ankesa administrative, protesta, padi në gjykatë dhe peticione të drejtuara instancave të ndryshme në nivel lokal vendor, kombëtar e ndërkombëtar. Kërkesat e komunitetit u mbështetën nga njësitë e qeverisjes vendore, OSHC-të kombëtare dhe ndërkombëtare, rrethet shkencore dhe personalitete të shquara.

<sup>3</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Lumi Vjosa. (<https://akzm.gov.al/lumi-vjosa/>)

Figura 14: Hidrografia e rajonit qendror



Burimi: Co-PLAN 2023, përpunuar nga autorët

Pas kundërshtimeve të shumta, Lumi Vjosa me VKM nr. 155 datë 13.03.2023 u shpall nga Qeveria e Shqipërisë Park Kombëtar kategori II. Megjithatë, pavarësisht VKM-së, e cila shpalli luginën e Vjosës Park Kombëtar, kërcënimet ndaj këtij habitati, vazhdojnë të jenë



të pranishme dhe do të duhet të shtohen monitorimet për të mirë-menaxhuar këtë pasuri publike.

Një ndër problematikat më të mëdha, e cila ka krijuar shqetësime dhe ka sjell raportime nga ambientalistë dhe ekspertë mjedisorë, është derdhja e mbetjeve të përpunimit të naftës, e cila derdhet në përrenj, e më pas përfundojnë në rrjedhën e lumit Vjosa, duke sjell ndotje dhe shkatërrim të këtij habitati.

Figura 15: Fotografi nga lugina e Vjosës



Burimi: Gazeta dixhitale Balkan Green Energy

**Lumi Erzen** buron nga Mali me Gropa në një lartësi prej 1,300 m mbi nivelin e detit (Pano, 2008) përshkon vendbanime të ndryshme në bashkitë e Tiranës, Shijakut e Durrësit. Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës të lumit Erzen është 760 km<sup>2</sup> më një lartësi mesatare të pellgut prej 435 m mbi nivelin e detit dhe gjatësi të shtratit 109 km (Pano, 2008), për tu derdhur në afërsi të Gjirit të Lalzit në detin Adriatik.

Ky lum përshkon shumë zona rurale përgjatë shtrirjes së tij dhe është një burim kryesor uji për tokat bujqësore në zonat që ai përshkon pasi prej tij furnizohen kanalet vaditëse të cilat shërbejnë për vaditjen e tokave bujqësore gjatë stinës së verës.

Një nga problemet kryesore ka të bëjë me ndotjen e lumit e cila shkaktohet nga shkarkimet e pakontrolluara të ujërave të ndotur, ujërave teknologjike nga bizneset që operojnë përgjatë rrjedhës së tij si dhe nga depozitimi i mbetjeve urbane nga ana qytetarëve të cilët e shohin lumin si një vend-depozitim e jo si një aset i cili duhet mbrojtur. Kjo ndotje raportohet edhe nga OSHC-të të cilat monitorojnë rrjedhën e lumit por edhe

nga instancat shtetërore të cilat pohojnë se ky është një lum i ndotur, ndikimi i së cilës shihet me sy të lirë përgjatë rrjedhës së lumit në zonat urbane si dhe në grykëderdhjen e tij, ku gjenden ndër të tjera një sasi e madhe mbetjesh plastike të cilat arrijnë të pluskojnë përgjatë rrjedhës.

**Lumi Ishëm** cilësohet si një nga lumenjtë më të vegjël në rrjetin hidrografik shqiptar me një sipërfaqe të pellgut ujë-mbledhës rreth 673 km<sup>2</sup> me lartësi mesatare 357 m mbi nivelin e detit dhe një gjatësi prej 79.2 km

Ishmi formohet nga bashkimi i ujërave të lumit të Tiranës, i cili konsiderohet edhe si dega kryesore, Tërkuzës dhe Zezës. Lumi Ishëm derdhet në Gjirin e Rodonit dhe shërben si një ndarje natyrale ndërmjet qarkut të Durrësit dhe Lezhës.

Lumi i Ishmit për shkak se formohet edhe nga bashkimi i tre lumenjve të cilat kalojnë në zona me intensitet të lartë zhvillimi urban kanë problematika të mëdha sa i përket ndotjes së shkaktuar nga depozitimi i mbetjeve urbane, ato inerte dhe shkarkimi i pa-trajtuar i ujërave urban, pasoja të cilat duken me sy të lirë në ngjyrën e ujit dhe materialeve plastike të cilat pluskojnë përgjatë rrjedhës së lumit deri në grykëderdhjen e tij. Problematika ka gjithashtu gjatë reshjeve të dendura me daljen e degëve të këtij lumi kryesisht lumit të Tiranës i cili shkakton përmbytje në zonën e Paskuqanit dhe atë të njohur si Bregu i Lumit.

**Lumi Seman** cilësohet si një nga lumenjtë më të rëndësishëm të vendit tonë i cili shtrihet përgjatë Shqipërisë së Mesme dhe formohet nga bashkimi i lumenjve Devoll dhe Osum, bashkimi i këtyre lumenjve ndodh në bashkinë Kuçovë.

Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës të lumit Seman është 5,649 km<sup>2</sup> me një lartësi mesatare të pellgut prej 863 m mbi nivelin e detit dhe një gjatësi shtrati prej rreth 283 km (Pano, 2008). Gjatë rrjedhës së këtij lumi në territorin e bashkisë Fier i bashkohet edhe lumi i Gjanicës, i cili njihet si një lum tejet i ndotur nga shkarkimet e ujërave, industriale, nga përpunimi i hidrokarbureve të cilat përpunohen në zonën naftë nxjerrëse Patos-Marinëz, si dhe nga shkarkimet e ujërave të ndotur urban si dhe depozitimi i mbetjeve urbane përgjatë rrjedhës së tij.

Një ndër problematikat që karakterizon lumin Seman është edhe fakti se ky lum ndër vite ka dalë disa herë nga shtrati duke sjellë përmbytje të shumta në tokat bujqësore të qarkut të Fierit të cilat duke u bashkuar me ujërat e ndotur industrial shkaktojnë dëme në tokën bujqësore duke i ndotur ato, ndotja e cila mund të shkojë tek banorët e zonës nëpërmjet zinxhirit ushqimor.

**Lumi Shkumbin** renditet si një ndër lumenjtë më të rëndësishëm të vendit pasi pellgu ujëmbledhës i këtij lumi është i vendosur në Shqipërinë e mesme me drejtim nga lindja në perëndim. Sipërfaqja ujëmbledhëse e këtij pellgu lumor është 2,445 km<sup>2</sup> me një lartësi

mesatare 753 metra mbi nivelin e detit me një gjatësi shtrati prej 181 km (Pano, 2008), i cili derdhet në detin Adriatik pranë Plazhit të Vile-Bashtovës.

Lumi Shkumbin deri në afërsi të qytetit të Elbasanit mund të konsiderohet si një lum malor por më pas ndryshon karakterin e rrjedhës duke marrë gradualisht natyrën e një lumi kodrinor e në afërsi të Rrogozhinës karakterin e një lumi fushor.

Përgjatë luginës së këtij lumi janë ndërtuar shumë vendbanime, banorët e të cilëve përdorin burimet ujore të lumit për të zhvilluar aktivitetin e tyre bujqësor pasi kjo luginë në të dyja krahët e saj ka toka bujqësore tepër produktive të cilat shërbejnë për prodhimin e produkteve bujqësore.

Duke qenë se ky lum kalon në disa zona urbane një ndër problematikat kryesore ashtu si në pjesën më të madhe të lumenjve të Shqipërisë janë shkarkimet e pakontrolluara të ujërave industriale, ujërave të ndotur urban dhe depozitimi i mbetjeve urbane e inerte përgjatë rrjedhës së tij. Një ndër problematikat e tjera është edhe gërryerja e shtratit të lumit nga subjekte të ndryshme biznesi të cilat operojnë përgjatë shtratit të lumit duke marrë lëndën e parë nga lumi duke ndikuar në degradimin e tij.

**Liqenet e Dumresë** kanë origjinë karstike dhe shtrihen në territorin e bashkisë së Belshit të cilët përbëjnë grupin më të madh të liqeneve në rrethin hidrografik të Shqipërisë me 88 liqene më një sipërfaqe totale prej 14,2 km<sup>2</sup>.

Figura 16: Pamje ajrore e liqeneve të Dumresë



Burimi: TravelMagazine<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Travel Magazine: <https://travel-al.com/albanian-food-tours-2018-belshi-from-the-lakes-to-slow-food-and-saffron-tea/>

Rezervuarët dhe kanalet kulluese e vaditëse janë një tjetër element i hidrografisë së këtij rajoni, të cilët duke parë se 40% e sipërfaqes së rajonit kategorizohet si tokë bujqësore ato luajnë një rol të rëndësishëm për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin për të ndikuar në rritjen e mirëqenies ekonomike e sociale të banorëve të rajonit. Rezervuarët në këtë rajon, pjesërisht, janë ndërtuar nga njeriu me qëllim grumbullimin e ujërave të shirave gjatë stinës së vjeshtës e dimrit për ta përdorur atë për vaditjen e tokave bujqësore gjatë stinës së verës dukë qenë se për shkak të klimës mesdhetare vera është kryesisht e thatë. Nga ana tjetër kanalet kulluese e vaditëse shërbejnë për të transportuar ujin nga rezervuarët apo stacionet e pompimit, të cilët kryesisht janë pozicionuar pranë lumenjve, për të vaditur tokat bujqësore por edhe për të bërë kullimin e ujërave të tepërt, kryesisht gjatë stinës së dimrit për të evituar përmbytjen e tokave.

Problematika me rezervuarët janë të lidhura me mungesën e investimit për mirëmbajtjen e tyre në vite, për të kryer gjurmime për thellimin e tyre apo monitorimit të cilësisë së ujit në këto rezervuare, pasi ndotja potenciale që ato mund të kenë mund të kalojë tek njeriu nëpërmjet zinxhirit ushqimor. Infrastruktura e kanaleve kulluese e vaditëse nga ana tjetër përballët me problematika si: depozitimi mbetjeve të ngurta bashkiake e atyre inerte, shkarkime të ujërave industrial e përdorur urban të cilat shkaktojnë ulje të cilësisë së ujit për vaditje. Bllokimi i kanaleve kulluese është potencial për shtimin e rrezikut të përmbytjes së tokave bujqësore duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e cilësisë së tokës.

## Klima

Shqipëria ndodhet në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe referuar Indeksit Botëror të Riskut<sup>5</sup> (*World Risk Index 2022*), Shqipëria renditet në vendin e 82 nga 192 vende në botë si më të ekspozuarat në raport me fatkeqësitë natyrore si dhe ndër vendet me faktor të lart ekspozimi ndaj tyre.

Skenarët e ardhshëm të klimës për Shqipërinë parashikojnë ndryshime, si prirjet në rritje të temperaturave vjetore dhe stinore, si në vlerat minimale dhe maksimale, ulje të reshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme. Sipas Komunikatës së Tretë Kombëtare (KTK) të UNFCCC, deri në verën e vitit 2050, zona bregdetare nuk ka gjasa të përjetojë temperatura mesatare nën 25°C; Deri në vitin 2100, temperatura mesatare deri në 30°C pritet të dominojë të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, të gjithë skenarët parashikojnë një ulje të mundshme të reshjeve stinore në të gjitha stinët në krahasim me vlerat e vitit 1990.


Një fenomen i cili po vërehet vitet e fundit është ngritja e temperaturave mesatare përgjatë muajve të ndryshëm të vitit kjo për shkak të efekteve të ndryshimeve klimatike. Në grafikun e mëposhtëm<sup>6</sup> paraqiten të dhënat për temperaturat mesatare për

<sup>5</sup> [https://weltrisikobericht.de/wp-content/uploads/2022/09/WorldRiskReport-2022\\_Online.pdf](https://weltrisikobericht.de/wp-content/uploads/2022/09/WorldRiskReport-2022_Online.pdf)

<sup>6</sup> Prof. Petrit ZORBA, Departamenti i Meteorologjisë IGEO / UPT – Tirana © Mars 28, 2023. Forumi Kombëtar 'Ndryshimet Klimatike' Green-AL

periudhën 2017 – 2022 në raport me normën dhe shohim se, me përjashtim të muajit janar, kemi një rritje të temperaturave mesatare në vend me një maksimum në muajin e gushtit me 24.8 °C dhe një minimum në muajin janar me 4.1°C.


Figura 17: Temperaturat mesatare të ajrit për periudhën 2017 – 2022 dhe sipas normës



Burimi: Prof. Petrit ZORBA, Departamenti i Meteorologjisë IGEO / UPT

Ndryshimi i temperaturave mesatare ka ndikuar edhe tek reshjet duke ndikuar në vlerat mesatare të reshjeve të shpërndarja gjatë muajve të vitit si dhe ditëve me shi në disa muaj. Siç ilustron edhe në grafikët e më poshtëm (fig. 18) shohim se ka një rënie me 4.6% të sasisë së reshjeve në një vit por ka ngritje të sasisë së reshjeve në krahasim me mesataren në disa muaj specifik e më konkretisht në korrik, shtator, nëntor e dhjetor.

Figura 18: Vlerat e reshjeve për periudhën 2017 – 2022 kundrejt normës



Burimi: Prof. Petrit ZORBA, Departamenti i Meteorologjisë IGEO / UPT

Figura 19: Ditët me reshje për vitet 2017 – 2022 kundrejt normës



Burimi: Prof. Petrit ZORBA, Departamenti i Meteorologjisë IGEO / UPT


Rritja e temperaturave mesatare nuk është një fenomen i cili vërehet vetëm në vendin tonë, por në të gjithë planetin Tokë, duke ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së njerëzve, ushtruar presion mbi burimet natyrore dhe bujqësinë e cila është tepër e ndjeshme ndaj këtyre fenomeneve. Më poshtë paraqitet një grafik i cili tregon rritjen e temperaturave mesatare në planetin Tokë nga viti 1880 – 2020 krahasuar me temperaturën mesatare të viteve 1951 – 1980, ku vërehet një rritje e temperaturës mesatare me 0.89 °C.

Ngjarjet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike me gjasë do të ndikojnë në shtimin e fatkeqësive natyrore të tilla si thatësitat, shirat e rrëmbyeshëm, përmblytjet e zjarret duke ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve e për këtë arsye do të duhet të merren masa nga ana e qeverisë në nivel qendror e lokal të cila duhet të bashkëpunojë me OSHC-të dhe qytetarët, për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike.

Figura 20: Rritja e temperaturave mesatare ndër vite

### Last 9 Years Warmest on Record

Global Temperature Anomaly (°C compared to the 1951-1980 average)



Burimi: Earthobservatory, NASA<sup>7</sup>

### 1.3 ASPEKTI SOCIO-EKONOMIK

Rajoni qendror është rajoni më i zhvilluar në vend në aspektin socio-ekonomik pasi në të strehohet rreth 66% e popullsisë rezidentë në vend. Ky përqendrim i lartë i popullsisë ndikon edhe në zhvillimin ekonomik të tij, pasi pjesa më e madhe e industrisë, shërbimeve, institucioneve arsimore e shëndetësore, instituteve të kërkimit shkencor dhe Organizatave të Shoqërisë Civile janë përqendruar në këtë rajon. Ky është një potencial, i cili mund të kthehet në nxitës të zhvillimit social e ekonomik të vendit.

Zona metropolitane "Durana" është motori kryesor i zhvillimit, jo vetëm në rajon por edhe në vend. Pozicioni strategjik i kësaj zone metropolitane, me dalje në detin Adriatik dhe ndërlidhje ndërkombëtare, si rezultat i vendndodhjes së aeroportit të Rinasit dhe portit të Durrësit, lehtëson zhvillimin e mëtejshëm social e ekonomik të këtij rajoni.

Rajoni qendror prodhon 71% të PBB në vend dhe qarku i Tiranës dhe Fierit kanë të ardhurat më të larta për frymë me respektivisht 886 dhe 714 (mijë lekë) në raport me mesataren e vendit e cila është 660 (mijë Lekë).<sup>8</sup> Në tabelën e mëposhtme paraqitet PBB sipas qarqeve dhe vërehet se qarqet e rajonit qendror janë ato të cilat prodhojnë më shumë.

<sup>7</sup> Article, World of change: Global Temperatures. <https://earthobservatory.nasa.gov/world-of-change/global-temperatures>

<sup>8</sup> Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2021. Instat.

TABELA 3: PBB SIPAS QARQEVE

Qarku	PBB çmime korrente (milion Lekë)	% ndaj totalit
Dibër	53,504	3%
<b>Durrës</b>	<b>186,709</b>	<b>10%</b>
Kukës	29,027	2%
Lezhë	54,831	3%
Shkodër	91,117	5%
<b>Elbasan</b>	<b>124,976</b>	<b>7%</b>
Tiranë	<b>811,443</b>	<b>44%</b>
Berat	62,201	3%
<b>Fier</b>	<b>201,532</b>	<b>11%</b>
Gjirokastër	38,674	2%
Korçë	96,586	5%
Vlorë	105,571	6%
<b>Rajoni qendror</b>	<b>1,324,660</b>	<b>71%</b>
<b>Total</b>	<b>1,856,172.00</b>	<b>100%</b>

Burimi: Vjetari statistikor rajonal, 2021

Nga ana tjetër, rajoni qendror kontribuon më tepër se sa të gjitha rajonet e tjera bashkërisht në strukturën e Vlerës së Shtuar Bruto, VSHB, për degë të ekonomisë, ku me përjashtim të bujqësisë dhe peshkimit e cila është në nivelin 52% në raport me rajonet e tjera, në degët e tjera të ekonomisë është më shumë se 60% me një maksimum prej rreth 90% në degën e aktiviteteve shkencore, profesionale e teknike.

Po të vërejmë edhe të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme do të shohim se qarku i Tiranës është ai që kontribuon më shumë në VSHB-në e rajonit por edhe në nivel vendi. Nëse do të bënim një profilizim të qarqeve të këtij rajoni lidhur me strukturën e VSHB-së ,vërejmë se qarku Fier dhe Elbasan jep rreth 36% të VSHB-së së bujqësisë dhe peshkimit. Nga ana tjetër, Tirana dhe Durrësi kanë tregues të lartë sa i përket VSHB-së në tregti e transport dhe aktivitete të pasurive të paluajtshme në raport me qarqet e tjera të rajonit. Një tjetër element i cili tregon se rajoni qendror është i prirur drejt zhvillimit të industrisë është vlera e VSHB-së së industrisë nxjerrëse e përpunuese, energjisë dhe ujit e cila është në nivelin e 72% në raport vendi, por edhe qarqet e këtij rajoni janë ato që kanë vlerat më të larta në raport me qarqet e tjera.



TABELA 3: Struktura e vlerës së shtuar bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore në %, 2019<sup>9</sup>

Nivelet Statistikore	Republika e Shqipërisë	Kontributi i rajonit qendror në VSHB	Durrës	Elbasan	Tiranë	Fier
<b>Bujqësia, pyjet dhe peshkimi</b>	100%	<b>51.9</b>	7.3	<b>12.4</b>	7.5	<b>24.7</b>
<b>Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë</b>	100%	<b>72.3</b>	<b>14.6</b>	8	<b>35.8</b>	13.9
<b>Ndërtimi</b>	100%	<b>77.6</b>	9.9	5	<b>56.9</b>	5.8
<b>Tregtia; Transport; Hotele</b>	100%	<b>78</b>	<b>13.6</b>	4.4	<b>53.3</b>	6.7
<b>Info. dhe kom.</b>	100%	<b>87.2</b>	3.4	1.9	<b>79.2</b>	2.7
<b>Aktivitetet financiare dhe të sigurimit</b>	100%	<b>66.2</b>	9.7	5.7	43	7.8
<b>Aktivitete të pasurive të paluajtshme</b>	100%	<b>74.4</b>	<b>14.5</b>	5.2	48.3	6.4
<b>Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike</b>	100%	<b>89.8</b>	9	1.9	<b>74.7</b>	4.2
<b>Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj</b>	100%	<b>70.1</b>	6	6.7	<b>51.4</b>	6
<b>Arte, argëtim; çlodhje etj</b>	100%	<b>82.5</b>	7	3.2	<b>68.3</b>	4
<b>VSHB me çmime korente</b>	100%	<b>71.4</b>	10.1	6.7	<b>43.7</b>	10.9

Burimi: Vjetari statistikor rajonal, 2021

Referuar të dhënave të INSTAT,<sup>10</sup> në 2021 forcat e punës në Shqipëri numërojnë rreth 1,176,381 persona nga të cilët 50.5 % e tyre janë të punësuar me pagë, ndërsa pjesa tjetër e personave konsiderohen të vetëpunësuar, si forcë punë konsiderohet grupmosha 15-64 vjeç. Nëse do ti referohemi punësimit të qytetarëve të rajonit qendror sipas sektorëve të ekonomisë vërehet sërish një ndarje ndërmjet qarkut të Elbasanit dhe Fierit ku sektori në të cilin janë punësuar kryesisht qytetarët është ai i bujqësisë me 62% dhe 55% persona e më pak në shërbime e industri. Nga ana tjetër në qarkun e Tiranës dhe Durrësit shohim se pjesa më e madhe e personave janë të punësuar në sektorin e shërbimeve


<sup>9</sup> Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2021. Instat.

<sup>10</sup> Tregu i Punës, 2021, INSTAT.

respektivisht me 69% dhe 47 % të personave të aftë për punë. Një tjetër element i cili vihet re është se në qarkun e Durrësit rreth 39 % e të punësuarve punojnë në sektorin e industrisë, shifër kjo që është edhe më e lartë se e qarkut të Tiranës e cila e ka rreth 27% të personave të aftë për punë të punësuar në këtë sektor.

Këto të dhëna na ndihmojnë për të kuptuar pak më shumë lidhur me trendet e zhvillimit të këtij rajoni por edhe qarqeve në veçanti, ku vërejmë se Elbasani dhe Fieri janë të orientuar drejt sektorit të bujqësisë ndërsa Tirana e Durrësi drejt shërbimeve e industrisë.

Grafiku 1: Punësimi sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: Tregu i punës, 2021, INSTAT.

Trendi i zhvillimit të këtij rajoni vërehet edhe nga numri i ndërmarrjeve aktive në vitin 2021 në rajonin qendror, ku në këtë rajon janë përqendruar 53% e ndërmarrjeve në rang vendi dhe 71% e prodhuesve të shërbimeve, të dhëna këto të cilat na informojnë për drejtimet e zhvillimit të këtij rajoni. Sa i përket rajonit, qarku i Tiranës është ai që ka edhe numrin më të lartë të ndërmarrjeve ku bie në sy diferenca me qarqet e tjera të rajonit, kryesisht tek numri i ndërmarrjeve të cilat ofrojnë shërbime akomodimi dhe ushqimore, tregues ky për zhvillimin e turizmit në këtë qark.

TABELA 4: Ndërmarrjet sipas veprimtarisë ekonomike dhe qarqeve, 2020-2021

Prodhuesit e shërbimeve 2021							
Qarku	Gjithsej Shqipëria	Gjithsej Prodhuesit e shërbimeve	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikimi	Shërbime të tjera
<b>Durrës</b>	13,240	9,854	4,639	694	1,459	198	2,864
<b>Elbasan</b>	15	6,500	2,934	475	1,405	130	1,556
<b>Fier</b>	26,029	8,104	4,292	459	1,474	122	1,757
<b>Tiranë</b>	57,268	48,395	17,590	2,155	6,153	2,963	19,534
<b>Rajoni qendror</b>	96,552	72,853	29,455	3,783	10,491	3,413	25,711
<b>Raporti RQ/Sh në %</b>	<b>53%</b>	<b>71%</b>	<b>69%</b>	<b>66%</b>	<b>61%</b>	<b>85%</b>	<b>78%</b>
<b>Shqipëria</b>	<b>181,549</b>	<b>102,751</b>	<b>42,995</b>	<b>5,689</b>	<b>17,121</b>	<b>4,005</b>	<b>32,941</b>


Burimi : Vjetari statistikor rajonal, 2022

Sa i përket aspektit social, në këtë dokument ilustrohet shpërndarja e kopshteve, shkollave 9-vjeçare e të mesme, publike, si një element i lidhur ngushtësisht me rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me çështjet mjedisore në nivel lokal e kombëtar. Në rajonin qendror gjenden 869 kopshte, 2,124 shkolla 9-të vjeçare dhe 516 shkolla të mesme.<sup>11</sup> Në hartë paraqitet shpërndarja e institucioneve arsimore në territorin e rajonit qendror, ku mund të themi se ka një mbulim të mirë të territorit me kopshte dhe shkolla.

Kopshtet, shkollat, universitetet janë në fokus të OSHC-ve dhe janë pjesë aktive e projekteve që zbatohen nga ana e tyre, këto institucione arsimore kanë qenë edhe në fokus të organizatave të cilat kanë përfituar fonde nga skema e granteve në projektin Green-AL. Kryesisht angazhimi i shkollave/universiteteve dhe nxënësve/studentëve ka qenë në aktivitete edukuese për tematika të ndryshme si ndarja e mbetjeve në burim, promovimi i qyteteve ekologjike, monitorimi i cilësisë së ujërave dhe ajrit, aktivitete për promovimin e natyrës etj. Përfshirja e institucioneve arsimore në proceset e promovimit dhe ruajtjes së mjedisit dhe burimeve natyrore do të ishte një vlerë e shtuar për shoqërinë shqiptare, në këtë drejtim do të ishte me tepër interes përfshirja e orëve mjedisore në kurikulën e këtyre institucioneve me qëllim sensibilizimin e brezave të ardhshëm.

<sup>11</sup> Të dhënat e paraqitura janë marrë ASIG 2017 - 2018 dhe kanë qëllim ilustrues.

Figura 21: Harta e institucioneve arsimore në rajonin qendror



Burimi: Co-PLAN 2023, përpunuar nga autorët

Rajoni qendror edhe në vitet në vijim me gjasë do të jetë rajoni i cili do të udhëheqë zhvillimin ekonomik të vendit. Në vitin 2021, sipas të dhënave të INSTAT,<sup>12</sup> janë dhënë 1,396 leje ndërtimi për hotele, ndërtesa për zyra, tregtare e industriale, nga këto 902 janë dhënë në rajonin qendror të cilat përkrijnë me 65% të lejeve të dhëna në rang vendi. Zhvillimi i vrullshëm urban i këtij rajoni duhet të shihet më vëmendje pasi për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm duhet që zhvillimi ekonomik e social të jetë në një linjë me zhvillimin mjedisor e jo të zhvillohet në kurriz të tij.

Po t'i referohemi edhe të dhënave të paraqitura më sipër, qarku i Tiranës dhe Durrësit ka një prirje të zhvillimit të ekonomisë drejt ofrimit të shërbimeve e cila me gjasë do të risë edhe numrin e turistëve të cilët vizitojnë këtë rajon, e në këtë drejtim duhet të merren masa për mbrojtjen e promovimin e burimeve natyrore si pyjet, lumenjtë e liqenet, parandalimin e ndotjes së shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve urbane pasi rritja e mirëqenies ndikon edhe në rritjen e konsumit si dhe ndërmarrja e fushatave për monitorimin e ndotjes akustike e ajrit.

Nga ana tjetër, në qarkun e Elbasanit dhe Fierit sektori më i zhvilluar është ai i bujqësisë, sektor në të cilin janë të punësuar e vetëpunësuar pjesa më e madhe e banorëve. Duke pasur parasysh skenarë të ndryshimeve klimatike dhe ndikimin që do të ketë në rritjen e temperaturave mesatare, frekuencën dhe intensitetin e reshjeve të shiut një nga sektorët më të prekur do të jetë bujqësia e rrjedhimisht qytetarët të cilët merren me bujqësi.

Në këtë drejtim është e nevojshme që institucionet në nivel lokal e qendror të ndërmarrin veprime konkrete për të mbështetur fermerët e grupet e tjera të interesit si dhe të ndërjegjësojë ata lidhur me ndikimet dhe masat që duhen ndërmarrë për t'ju përshtatur këtyre ndryshimeve me qëllim uljen e ndikimit negativ që ato mund të kenë në këtë sektor. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim përtej institucioneve mund të luajnë universitetet me profil bujqësor si dhe institutet e kërkimit shkencor për të ilustruar me të dhëna konkrete ndikimit e ndryshimeve klimatike dhe sugjeruar masa konkrete për t'i zbutur ato.


## 1.4 TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Rajoni qendror ka numrin më të lartë të popullsisë në vend, si rrjedhojë e përqendrimit të popullsisë në zonat urbane dhe lëvizjes së tyre drejt kryeqendrës së vendit për një total prej 1,748,361 banorësh. Qarku i Tiranës ka pësuar rritjen më të madhe të popullsisë, ku referuar të dhënave të Vjetarit Statistikor 2022, popullsia shënon një numër prej 919,511 banorësh, 20.4 % më shumë se viti 2011 dhe 54.1% më shumë krahasuar me vitin 2001. Vlera pozitive shënohen edhe në qarkun e Durrësit, ku sipas vlerave popullsia është rritur me 8% krahasuar me vitin 2011 dhe 19% me vitin 2001. Qarku i Elbasanit dhe Fierit shfaqen

<sup>12</sup> Vjetari statistikor 2022, INSTAT.

me vlera negative, ndërsa vetë rajoni ka rritje pozitive, nga viti 2011 me 5% dhe viti 2001 me 10.3%.

Grafiku 2: Popullsia e rajonit qendror, janar 2022



Burimi: INSTAT – Vjetari statistikor rajonal, 2022

Rajoni sikurse shënon numrin më të lartë të popullsisë, ka edhe dendësinë më të lartë në vend. Dendësia në nivel rajoni është 231 banorë/ km<sup>2</sup>. Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhëna mbi popullsinë, sipërfaqen dhe densitetin e çdo qarku pjesë e rajonit qendror.


Tabela 5. Popullsia, sipërfaqja e densiteti i popullsisë në rajonin qendror

Rajoni Qendror			
Qarku	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Popullsia, janar 2022	Densiteti (banorë/km <sup>2</sup> )
Tiranë	1,636	919,511	562
Durrës	779	291,325	374
Fier	1,875	278,413	148
Elbasan	3,285	259,112	79
<b>Totali</b>	<b>7,575</b>	<b>1,748,361</b>	<b>231</b>

Burimi: INSTAT - Vjetari Statistikor rajonal, 2022 / Përlogaritjet e autorëve

Referuar popullsisë banuese në rajonin qendror kemi një ndarje të barabartë ndërmjet burrave 50% dhe grave 50% të cilët banojnë në rajonin qendror.

Grafiku 3: Raporti gjinor në rajonin qendror



Burimi: INSTAT - Vjetari statistikor rajonal, 2022

Rajoni paraqitet kryesisht i urbanizuar në qarqet e Tiranës dhe Durrësit dhe me tipologji rurale në qarqet e Elbasanit dhe Fierit. Numri i popullsisë rurale më të lartë në rajon vihet re në qarkun e Fierit, ku përqindja e popullsisë rurale shënon 58.4%, në raport me popullsinë totale.

Tabela 6. Popullsia rurale

Popullsia rurale		
Qarku	Kategoria	% e popullsisë rurale
Tiranë	Mbizotërim urban	11.5
Durrës	Mbizotërim urban	24.7
Fier	Mbizotërim rural	58.4
Elbasan	Mbizotërim rural	55.5


Burimi: INSTAT – Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare, 2014

Ndër vite, Shqipëria ka pasur një migrim të popullsisë kryesisht nga zonat e thella në drejtim të qyteteve kryesore të vendit e më specifikisht drejt kryeqytetit, i cili për shkak të zhvillimit ekonomik, ka tërhequr shumë banorë nga qytetet e tjera të vendit dhe zonat rurale.

Migrimi i brendshëm ka qenë i pranishëm në vlera pozitive kryesisht në zonën urbane të Tiranë-Durrës. Kjo për faktin se Tirana dhe Durrësi kanë shërbyer si magnet i fortë në tërheqjen e popullsisë vendase drejt qendrave të tyre urbane, por shpesh herë edhe rurale. Referuar “Vjetarit statistikor rajonal, 2022”, Tirana dhe Durrësi janë të vetmet qarqe në rang vendi që kanë një normë bruto të migracionit të brendshëm neto në vlera pozitive. Nga ana tjetër, dy qarqet e tjera të rajonit, Fieri dhe Elbasani, si qarqe me karakter rural kanë vlera negative.

Po t'i referohemi të dhënave të paraqitura edhe në grafikun e mëposhtëm, kemi një trend ritës të shtimit të popullsisë në qarkun e Tiranës ku në vitin 2016 ka qenë 8.1 ndërsa në 2021 ka ardhur duke u rritur duke shënuar 23.7, persona për një mijë banorë, çka faktori edhe me numra përqendrimin e lart të popullsisë në kryeqytet. Nga ana tjetër, edhe qarku i Durrësit ka një trend ritës dike shënuar një rritje me rreth 12.2, persona për një mijë banorë, në raport me vitin 2016.

Grafiku 4: Koeficienti bruto i migrimit të brendshëm neto, sipas qarkut 2021



Burimi: INSTAT - Vjetari statistikor rajonal, 2022



## 1.5 MJEDISI

### **Ndotja: Uji, ajri, toka mbetjet**

Ndotja e elementëve si uji, ajri e toka janë një nga problemet kryesore mjedisore në Shqipëri. Shkaktarë kryesorë të kësaj gjendjeje janë urbanizimi i shpejt i disa zonave specifike, mungesa e monitorimit të territorit (si rrjedhojë e burimeve të pakta njerëzore në institucionet përgjegjëse), mbivendosja e kompetencave ndërmjet institucioneve, mungesa e kapacitetit të punonjësve në administratën lokale e kombëtare, si dhe mungesa e fondeve dhe mjeteve për të kryer monitorimet në kohë.

### **Uji**

Në këtë drejtim, evidentohen problematika lidhur me ndotjen e baseneve ujore në të gjithë vendin por edhe në territorin e rajonit qendror. Në vitin 2018 është ngritur edhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila është përgjegjëse për mirëqeverisjen e burimeve ujore. Në këtë periudhë, kjo agjenci ka hartuar disa plane për menaxhimin e baseneve ujore, të cilat një pjesë janë miratuar e një pjesë janë në proces konsultimi publik. Megjithatë, edhe në rastet kur këto plane janë hartuar, mbetet problematikë monitorimi i shkarkimeve të pakontrolluara në këto basene ujore. Problematikat lidhen kryesisht me shkarkimet industriale, biznese të cilat operojnë përgjatë rrjedhave lumore të cilat shkarkojnë ujërat industriale të pa-trajtuara, industria e përpunimit të hidrokarbureve në qarkun e Fierit; shkarkimet e ujërave të përdorur urban, nga njësi individuale banimi apo biznesi apo shkarkime në nivel bashkie; depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane dhe ato inerte përgjatë brigjeve të këtyre baseneve, ndotja nga aktiviteti bujqësor, kimikatet të cilat përdoren për të mbjellat janë të pa monitoruara dhe nuk ka një vlerësim për ndikimin që kanë në këto burime.

Ndotja e këtyre burimeve ndikon në cilësinë e ujit dhe mund të sjellë probleme për shëndetin e njeriut pasi këto ujëra përdoren për vaditjen e tokave bujqësore, për ujë të pijshëm e sanitar nëpërmjet puseve kryesisht në zonat rurale si dhe veprave të marrjes së ujit për të shërbyer zonat urbane me ujë të pijshëm.

Referuar raporteve të gjendjes në mjedis<sup>13</sup> publikuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në mënyrë të përvitshme, gjendja e baseneve në rajonin qendror raportohet si në vijim:

Baseni Ishëm-Erzen ka ndotje të kategorisë V (ndotje e lartë, mbi 80% e habitatit historik të dëmtuar ose zhdukur) prej vitit 2018, duke mos pasur asnjë përmirësim. Ndotja shkarkohet tërësisht e pa-trajtuar, si ajo industriale edhe urbane. Ndotja ndikon tokat

---

<sup>13</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti Gjendjes në Mjedis 2022, Tiranë, Shqipëri.

bujqësore që shfrytëzojnë këtë ujë për vaditje, si edhe akuiferët, që furnizojnë me ujë të pijshëm disa ujësjellës si edhe familje nëpërmjet pus-shpimeve.

Gjithashtu, baseni i Semanit ka ndotje të kategoria V (ndotje e lartë, mbi 65% e habitatit historik të dëmtuar ose zhdukur) prej vitit 2018 duke mos pasur asnjë përmirësim. Ndotja shkarkohet në shumë raste e pa-trajtuar; peshën më të madhe të ndikimit e ka ndotja industriale, sidomos shkarkimet nga industria e naftës në lumin Gjanicë. Duke qenë se burimet ujore përdoren për qëllime të ndryshme, ndotja e basenit mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në cilësinë e jetës së qytetarëve të këtyre zonave.

Baseni i Shkumbinit i përket kategorisë II të ndotjes (gjendje e mirë) dhe njeh përmirësimin më të theksuar: respektivisht, ka kaluar nga kategoria V në 2016, në kategorinë II në 2022. Ndërkohë, vlen të theksohet se të gjithë qytetet të cilat shkarkojnë në këtë basen nuk aplikojnë asnjë trajtim të ujërave të ndotura. Megjithatë, është e rëndësishme të përmenden se shkarkimet në zonën industriale të Elbasanit, evidentuar nga matjet e shumta nga organizata apo projekte të ndryshme, prezantojnë një situatë të rënduar nga ndotja. Zhvendosja e landfillit të Elbasan në një strukturë të re ka reduktuar shkarkimet e drejtpërdrejta të llumit (shllamit) në ujërat e këtij baseni, por nga ana tjetër mosfunksionimi i inceneratorit po risjell sërish gjurmë të kësaj ndotje në këtë basen.

Ndikimi i industrisë së marrjes dhe përpunimit të inerteve nga shtrati i këtij lumi është shqetësues—disa herë, media apo OSHC të ndryshme kanë evidentuar mosrespektimin e rregullave që ka rezultuar në ndryshimin e shtratit të lumit dhe prishjen e habitatit.

### Ajri dhe ndotja akustike

Qytetet kryesore në vend, e kryesisht ato të rajonit qendror, shfaqin problematika të cilësisë së ajrit urban dhe ndotjes akustike, për shkak të përdorimit të rritur të mjeteve motorike që shoqëroi popullimin e këtyre zonave. Në këtë drejtim, monitorimet nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo nga ana e bashkive janë të pakta ose sporadike - ato nuk kryhen në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk ofrojnë një monitorim në kohë reale. Ka pasur disa nisma nga ana e OSHC-ve për të ofruar të dhëna lidhur me ndotjen e ajrit apo ndotjen akustike nëpërmjet matjeve në kohë reale, me qëllim ngritjen e vëmendjes qytetare dhe advokimin për të marrë masa konkrete. Një prej këtyre nismave është “Mushkëri të Gjelbra/ *Green Lungs*”, një platformë e hapur dhe e qasshme që jep informacion në kohë reale për cilësinë e ajrit në qytet<sup>14</sup>. Nga monitorimet e kryera në projektin “Ajër i pastër, jetë e shëndetshme” i financuar nëpërmjet skemës së granteve të Green-AL rezultoi se:

<sup>14</sup> Më tepër të dhëna për cilësinë e ajrit, ndotjen akustike dhe gjelbërimin në disa bashki të vendit do t'i gjeni në platformën Mushkëri të Gjelbra/Green Lungs (<https://greenlungs.al/>)

**Në Tiranë**, në 400 pika monitorimi për parametrat CO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, PM10 dhe PM2.5, vlerat e matjeve të kryera gjatë sezonit të vjeshtës 2022 janë më të larta se normat e vendosura nga BE (dy deri në dhjetëfish më të larta);

**Në Durrës**, në 100 pika të monitoruara, në rrugët dhe kryqëzimet kryesore urbane të këtij qyteti, vërehet se niveli i ndotjes për 4 parametrat e matur NO<sub>2</sub>, CO<sub>2</sub>, PM2.5, PM10 ka një rritje të dukshme, ku gjatë sezonit të verës niveli i NO<sub>2</sub> është dy herë më lartë se sa norma;

**Në Elbasan**, nga 150 pika të monitoruara, vihet re se ka tejkalim të normave të NO<sub>2</sub> dhe të CO<sub>2</sub> në disa pika kryesore të qytetit.

Gjithashtu, referuar Buletinit 2021 të publikuar nga projekti "Mushkëri të Gjelbra për Qytetet Tona,<sup>15</sup> evidenton se ka një mbikalim të normave sa i përket ndotjes akustike në disa zona të qyteteve të Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit, në fasha të ndryshme gjatë ditës apo natës.

Referuar matjeve të kryera nga AKM (2022) për nivelin e zhurmave në Tiranë, 15 nga 15 pikat e matura rezultojnë mbi standardin e lejuar, gjatë ditës dhe gjatë mbrëmjes. Kontribuesit kryesor të zhurmave në zonat urbane janë kantieret e ndërtimit dhe mjetet e transportit. Studimet e kryera më herët nga organizatat dhe ekspertët të pavarur mjedisorë në Shqipëri, tregojnë se vetëm në Tiranë janë mesatarisht 71,225 familje të cilat ekspozohen çdo ditë ndaj zhurmave mbi normat e lejuara referuar Ligjit Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" të cilat janë në përputhje me standartet e OBSH.

Në tërësi, situata me menaxhimin e cilësisë së ajrit sikundër edhe të zhurmave, vlerësohet të jetë neglizhuar nga institucionet të cilat bartin detyrimet ligjore për t'i monitoruar, inspektuar dhe raportuar. Instituti i Shëndetit Publik nuk ka publikuar të dhëna të kohëve të fundit lidhur me ndotjen e ajrit urban (publikimi i fundit në vitin 2012)<sup>16</sup> apo shkalla e sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja e ajrit, që ndikojnë në kuptimin e vlerësimin e rolit të këtyre faktorëve në cilësinë e jetës së banorëve. Nga ana tjetër, mungojnë tërësisht të dhënat që dëshmojnë ndikimin e zhurmës në cilësinë e jetës së grupeve vulnerabël (të porsalindurit, fëmijët, të sëmurët kronikë, etj.).

Për të adresuar këto problematika, duhet të hartohen plane për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe zhurmave në zonat urbane, e të ngrihen stacione monitorimi që mundësojnë monitorim të vazhdueshëm e paraqesin të dhëna në kohë reale. Në këtë drejtim, OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në asistimin e institucioneve vendore e kombëtare në

<sup>15</sup> "Publikimin e plotë mund ta gjeni në linkun në vijim  
<https://drive.google.com/file/d/1ëZS3il9ZQvkserbnZPA1ëbNISU1g8HVS/vieë?pli=1>"

<sup>16</sup> Raporti Vjetor i Cilesise se Ajrit Tirana, 2012  
[http://www.ishp.gov.al/multimedia/raporti\\_vjetor\\_i\\_cilesise\\_se\\_ajrit.pdf](http://www.ishp.gov.al/multimedia/raporti_vjetor_i_cilesise_se_ajrit.pdf)

zbatimin e fushatave ndërgjegjësuere për efektet e ndotjes së ajrit e zhurmës, e masat që mund të marrin për të ndikuar në uljen e ndotjes në tërësi.

## Toka

Ashtu si edhe dy elementët e përmendur më sipër, edhe toka është një element i cili vuan pasojat e ndotjes, por edhe nga faktorë të tjerë të cilët nuk janë të shkaktuar nga aktiviteti njerëzorë siç është erozioni, zjarret etj.

Një nga problematikat kryesore të përmendura edhe në RGJM 2021, është erozioni i shkaktuar kryesisht nga lumenjtë që përshkojnë rajonin qendror. Erozioni lumor ka shkaktuar shumë dëme, duke marrë sasi të konsiderueshme të tokës bujqësore përgjatë rrjedhës së lumenjve e duke rrezikuar edhe jetën e qytetarëve. Shtimi i erozionit lumor vjen si rrjedhojë e mungesës së masave si prita lumore, skarpate, apo mungesa e bimësisë e marrja e materialeve inerte nga shtrati i tyre. Një problematik tjetër është edhe erozioni detar i cili kryesisht vërehet përgjatë bregdetit të bashkisë Kavajë, ku deti ka përparuar shumë në brendësi të tokës duke ndikuar në kripëzimin e tokave bujqësore dhe duke marrë sipërfaqe nga pjesa e bregut/plazhit.

Elemente të tjera problematike janë pikat e nxehta mjedisore që e kanë prejardhjen kryesisht nga aktiviteti industrial i zhvilluar ndër vite, ndër të cilat vlen të përmenden:

- Uzina e Plehrave Azotike, Fier: me kimikate si karbonat kaliumi;
- Uzina e Prodimit Çelikut (UPÇ): me kimikate dhe reagentë laboratorikë;
- Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera (NFIM), Elbasan: Cianure e Kimikate (lindan, sulfure, etj.);
- Depozitat në Balëz, Elbasan: kripëra të arsenikut, nitrate amoni, hidrokside të amonit;
- Nxjerrja e naftës në Ballsh, Kuçovë, Patos-Marinëz: ndotja shkaktohet nga pusët e naftës dhe shkarkimet e ujërave të pa-trajtuara.

Të gjitha këto zona kanë potencial për ndotjen e tokës e ujërave sipërfaqësor e nëntokësor dhe ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin e njerëzve.

Edhe pse zhvillimi i bujqësisë në ultësirën perëndimore ka sjellë goxha përfitime socio-ekonomike për rajonin, duhet përmendur edhe ndotja nga përdorimi gjithnjë e më i tepërt i pesticideve, herbicideve, e insekticideve, që ndikojnë në degradimin e tokës dhe mund të kalojnë dhe në ujërat nëntokësorë e sipërfaqësorë.


## Mbetjet

Një nga shkaqet e ndotjes së burimeve ujore, të tokës e të ajrit është edhe menaxhimi jo i mirë i mbetjeve në vendin tonë. Shpesh vërehen grumbuj mbetjesh urbane buzë

burimeve ujore apo në kah të rrugëve kryesore, që kontribuojnë në ndotjen e këtyre burimeve.

Menaxhimi i mbetjeve është një nga përparësitë kryesore të deklaruara nga Qeveria e Shqipërisë, 17 që ka ndërmarrë hapa përgjatë viteve për të përmirësuar këtë sektor sfidues. Në përgjithësi, raportet dëshmojnë nivel të mirë të përshtatjes së legjislacionit, (rreth 53.5%) krahasuar me direktivat kuadër (Direktivat e BE), megjithatë problem mbetet zbatimi i legjislacionit. Nga ana teknike, në nivel vendi, problematikat lidhen me mbulimin e pjesshëm të territorit me shërbim, sasi më e vogël e mbetjeve e depozituar në landfille e vend depozitime (të autorizuara apo paautorizuara), numër i kufizuar i mjeteve për grumbullimin e mbetjeve (shumica e të cilëve nuk përputhen me normat), përqindje e ulët e riciklimit, mos respektimi i hierarkisë së mbetjeve, mungesë e nxitjes për aplikimin e masave të promovimit të ekonomisë qarkulluese, mungesë e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve, tarifa të ulëta si dhe grumbullim i ulët i tarifave të cilat nuk mbulojnë koston e ofrimit të shërbimit etj.

Figura 22: Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve



Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike 2020 – 2035

Në vitin 2020, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit ka miratuar dy dokumente kryesore, "Dokumentin e Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020 – 2035"<sup>19</sup> (dokumenti i politikave strategjike) dhe "Plani Kombëtar

<sup>17</sup> Siç përcaktohet nga ligji nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>18</sup> Këndvështrimi Alternativ i Progresit Mjedisor, Green27, prill 2021.

<sup>19</sup> Miratuar me VKM nr. 418, datë 27.05.2020

Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta" 20 (plani sektorial), i cili përcakton objektivat strategjike, synimet dhe infrastrukturën kryesore të nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Këto dokumente shënojnë një moment të rëndësishëm në përmirësimin e sektorit; megjithatë, në mënyrë që të jenë efektive, ato duhet të ndiqen nga plane rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve dhe të investimeve në ndërtimin e infrastrukturës të magazinimit të përkohshëm (stacionet e transferimit) dhe landfilleve sanitare.

Referuar të dhënave të INSTAT në vitin 2021,<sup>21</sup> sasia totale e mbetjeve urbane e atyre të ngjashme të gjeneruara në vend është 956,000 tonë, ndërsa ato të menaxhuara nga ana e bashkive janë rreth 875,696 tonë, çka do të thotë se rreth 8.45% apo rreth 80,304 tonë mbetje urbane janë të pa menaxhuara — mbetje që mund të jenë depozituar në mënyrë të pakontrolluar në mjedis.

Rajoni qendror performon më mirë se niveli kombëtar, sipas të dhënave të sasisë së mbetjeve në raport me mbetjet e menaxhuara. Në këtë rajon menaxhohen 94% e mbetjeve të krijuara (ndërkohë që niveli në shkallë kombëtare është 92%). Më specifikisht, qarku i Tiranës dhe Fierit kanë nivelet më të larta të menaxhimit të mbetjeve, me respektivisht 99 dhe 95% ndërsa qarku i Elbasanit dhe i Durrësit janë në nivele më të ulëta në rajon dhe në rang vendi me respektivisht 82 dhe 84% të mbetjeve të menaxhuara.

Tabela 7: Mbetje e krijuara në raport me të menaxhuara.

Qarku	Mbetje gjithsej të krijuara në ton	Mbetjet të menaxhuara si %	Mbetje të menaxhuara në ton	Mbetje të pa menaxhuara si %
Durrës	97,213	84%	81,951	15.70%
Elbasan	54,647	82%	44,701	18.20%
Fier	94,650	95%	90,012	4.90%
Tiranë	359,679	99%	35,4284	1.50%
Rajoni qendror	606,189	94%	57,0948	5.81%
<b>Shqipëria</b>	<b>956,000</b>	<b>92%</b>	<b>875,696</b>	<b>8.40%</b>

Burimi: Vjetari statistikor rajonal 2022

Mbetjet e menaxhuara në vendin tonë trajtohen duke u depozituar në vend depozitime të autorizuara, landfille, inceneratorë (me apo përfitim energjie); vetëm një pjesë e këtyre mbetjeve riciklohet. Në rajonin qendror gjenden 2 inceneratorë, i Elbasanit në të cilin trajtohen mbetjet e qarkut Elbasan dhe ai i Fierit në të cilin trajtohen mbetjet e krijuara në

<sup>20</sup> Miratuar nga Këshilli Kombëtar Territorial me vendim nr. 1 datë 13.01.2020.

<sup>21</sup> Vjetari statistikor rajonal 2022.

këtë qark (inceneratori i Fierit nuk është aktualisht funksional). Ndërsa në bashkinë e Tiranës gjendet landfilli i Sharrës në të cilin depozitohen mbetjet e krijuara në qarkun e Tiranës dhe së fundmi të Durrësit. Në tabelat e mëposhtme, paraqiten të dhëna për trajtimin e mbetjeve të menaxhuara sipas mënyrave të trajtimit. Riciklimi i cili është një ndër hallkat e hierarkisë së mbetjeve përpara se të kalojmë në depozitimin e mbetjeve apo incenerimin për përftim ose jo të energjisë, shohim se në RQ është pak më i lartë se niveli kombëtar, ku Bashkia Durrës pati përçindjen më të lartë të riciklimit, me 25.2% të mbetjeve të menaxhuara. Këto të dhëna janë disi kontradiktore pasi vetëm në zonën urbane të bashkisë Tiranë ka kosha për ndarjen e mbetjeve në burim, ndërsa në qarqet e bashkitë e tjera të rajonit nuk ka infrastrukturë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më poshtë, rezulton se në përgjithësi, në nivel rajoni dhe kombëtar, mënyra më e përdorur e trajtimit të mbetjeve është depozitimi në landfill, e cila është hallka e fundit e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve referuar edhe dokumentit të politikave strategjike si dhe legjislacionit në fuqi.

Tabela 8: Trajtimi i mbetjeve në tonë në rajonin qendror, 2021.

Qarku	Djegje në inceneratorë	Riciklim	Riciklimi në raport me mbetjet e menaxhuara në %	Depozituar në landfille	Hedhur jashtë landfilli
Durrës	-	20.666	25.2%	60.727	600
Elbasan	13.831	8.171	18.3%	22.721	-
Fier	3.358	12.562	14%	74.117	-
Tiranë	-	69.756	19.7%	284.524	-
Rajoni qendror	17.189	111.155	19.5%	442.089	600
Shqipëria	17.189	164.444	18.8%	691.352	1.811

Burimi: Vjetari statistikor rajonal 2022

Përtej të dhënave të paraqitura nga INSTAT, ka shumë projekte apo kronika televizive të cilat raportojnë për një sasi të madhe mbetjesh të cilat depozitohen të pakontrolluara në mjedis: ky është rasti i projektit “Erzeni Thërret”, i zbatuar nga organizata *North Green*, e cila, gjatë zbatimit të projektit, ka evidentuar depozitime ilegale mbetjesh urbane e inerte përgjatë rrjedhës së lumit Erzen.

Në këtë drejtim, edhe pse rajoni qendror raportohet në të dhënat nga INSTAT si rajoni me nivelin më të lartë të mbetjeve të menaxhuara në përpjesëtim me mbetjet e krijuara, ka nevojë të dukshme për mbulim më të mirë të territorit me shërbim, zëvendësim të infrastrukturës e mjeteve për grumbullimin e mbetjeve (kosha dhe mjete motorike),

zbatimi i hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, monitorim të territorit dhe promovim të praktikave 3R (redukto, ripërdor, riciklo), ndërmarrje të fushatave ndërgjegjësuere me komunitetin si dhe përfshirje të nxënësve dhe studentëve në promovimin e praktikave për reduktimin dhe menaxhimin e mbetjeve.

Përtej komunitetit, ndërmarrjet ekonomike apo bizneset e shërbimit duhet të bëhen pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe të mbështeten nëpërmjet rritjes së njohurive. Kështu, përfshirja do të nxisë përdorimin e praktikave të kapjes së vlerës së produktit, për të filluar zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese me qëllim uljen e sasisë së mbetjeve që krijohen e depozitohen në landfille, inceneratorë apo në mënyrë të pakontrolluar në mjedis.

Një ndër proceset në përputhje me aplikimin e parimit të “Ekonomisë qarkulluese” është edhe shfrytëzimi i mbetjeve si lëndë djegëse alternative<sup>22</sup>.

## Mbrojtja e natyrës/Biodiversiteti e pyjet

Shqipëria konsiderohet si një zonë e rëndësishme e biodiversitetit në Europë, me një biodiversitet të larmishëm dhe burime të shumta natyrore, të cilat për shkak të presionit të shtuar nga zhvillimi i shpejt i viteve të fundit, po përballen me sfida të mëdha. Këto problematika janë të ngjashme në mbarë vendin, e sidomos në rajonin qendror, ku burimet natyrore ndeshen me presionin e lartë ekonomik.

Në vitin 2022, Qeveria Shqiptare miratoi me Vendim të Këshillit të Ministrave, tre vendime (respektivisht nr. 59/2022, nr. 60/2022, 694/2022) që rishikuan kufijtë e disa prej zonave të mbrojtura<sup>23</sup>. OSHC-të janë shprehur vazhdimisht për rolin negativ të vendimeve në larminë biologjike kombëtare, duke cenuar integritetin biologjik të ZM-ve ligatinore bregdetare e duke fragmentuar habitatin, që rrjedhimisht do të ndikojë në humbjen e habitatit dhe specieve.<sup>24</sup>

Menaxhimi i ZM-ve është një sfidë për institucionet në nivel lokal e kombëtare pasi ka mungesë të kontrollit të territorit, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore si dhe burimeve financiare. Nga ana tjetër, shpallja e lumit Vjosa si Park Kombëtar (VKM nr. 155, datë 13.03.2023) është pritur pozitivisht, si Parku i parë Kombëtar i një lumi të egër në Europë. Ky vendim me gjasë do të rrisë mbrojtjen e lumit të Vjosës dhe zonave të tij buferike nga zhvillimi i pakontrolluar dhe shfrytëzimi i burimeve.

Administrimi i fondit pyjor i ka kaluar si kompetencë njësie të vetëqeverisjes vendore me anë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

<sup>22</sup> Mbetjet e refuzuara të cilat pasi kanë kaluar procesin e riciklimit përpunohen dhe përdoren si një alternativë e lëndëve djegëse fosile kryesisht në industrinë e prodhimit të çimentos. Më tepër mbi proceset dhe aplikimin e saj në vendin tonë mund të gjeni në faqen e projektit: [Nga mbetje në energji për industrinë e çimentos në Ballkanin Perëndimor](#)

<sup>23</sup> Përfaqësues të OSHC-ve në vend shprehen se Zonat e Mbrojtura janë shtuar në sipërfaqje por janë ulur nga ana cilësore.

<sup>24</sup> Deklaratë nga “Forumi për zonat e mbrojtura 2023”, Tiranë, 26 Janar 2023.



janë përgjegjëse për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve, të cilat nuk janë hartuar deri tani, për shkak të burimeve të pakta njerëzore dhe kapaciteteve të ulëta. Mungesa e hartimit të këtyre planeve sjell vështirësi në menaxhimin e fondit pyjor si dhe ulje të ardhurave të përfuara nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i këtij asemi për bashkitë. Në vitin 2016, Qeveria Shqiptare miratoi ligjin nr.5 "Për shpalljen e moratoriumit të pyjeve në Republikën e Shqipërisë", ky moratorium ndalon prerjen e druve pyjorë për qëllime industriale, duke e kushtëzuar prerjen e pyjeve vetëm për mbulimin e nevojave të komunitetit. Edhe pse ligji ka reduktuar prerjen e paligjshme të pyjeve, megjithatë problematikat me këtë fenomen janë të vazhdueshme.

Mungesa e burimeve njerëzore dhe monitorimit të territorit ngjall problematika edhe me zjarret në pyje, të cilat në vitet e fundit janë shtuar edhe si pasojë e efekteve të ndryshimeve klimatike (përpos rritjes së zjarrvënieve të qëllimshme). Referuar *Desinventar*<sup>25</sup> (sistem i menaxhimit të informacionit për fatkeqësitë natyrore) në rajonin qendror në vitet 2020 – 2022, kanë ndodhur 276 zjarre në pyje të cilat kanë dëmtuar sipërfaqe të shumta pyjore, duke rrezikuar jetët e njerëzve dhe biodiversitetin e zonës.

Në këtë drejtim, hartimi i planeve të menaxhimit dhe një monitorim më i mirë i territorit do të ndikonin në uljen e rasteve të zjarreve në pyll por edhe evidentimin e tyre në fazat fillestare për të reduktuar dëmet.


## Ndryshimet klimatike dhe energjia

Ndryshimet klimatike janë tanimë një realitet global, efektet e të cilës po shihen e po 'preken' në disa vende të botës, si edhe në Shqipëri, si një vend me ekspozim të lartë lidhur me fatkeqësitë natyrore. Në Komunikatën e Tretë dhe të Katërt Kombëtarë të Shqipërisë në UNFCCC, paraqiten të dhëna që tregojnë se Shqipëria do të përballet me rritjen e temperaturave mesatare, që rrjedhimisht do të ndikojnë në rritjen e ngjarjeve ekstreme të motit si përmbytjet, thatësitrat, valët e të nxehtit e zjarret në pyje duke ushtruar presion mbi habitatet dhe biodiversitetin, habitatet lagunore e bregdetare por edhe të popullsisë e cila jeton në Ulëtisrën Perëndimore të vendit. Një nga problematikat kryesore të viteve të fundit janë edhe përmbytjet e shkaktuara nga shirat dhe prurjet e larta të lumenjve në disa periudha të vitit. Më poshtë paraqitet harta e rrezikut të përmbytjeve e marrë nga "Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015 – 2030", ku vërehet se rajoni qendror është një nga zonat me rrezik të lartë të përmbytjeve. Përmbytjet ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në mirëqenien e popullatës, pasi gjatë viteve, ka pasur humbje të jetës, të gjësë së gjallë, dëmtime të pronës, infrastrukturës rrugore, e bujqësore (kanalet kulluese e vaditëse), furnizimin me ujë të pijshëm etj.

<sup>25</sup> Më shumë informacion gjeni në linkun: <https://www.desinventar.net/index.html>

Është e rëndësishme që të merren masa për të parandaluar e për të zvogëluar ndikimin e këtyre fenomeneve nëpërmjet hartimit të “Planeve vendore të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore”, të cilat do të ndihmonin jo vetëm autoritetet në nivel vendor e kombëtar, por edhe komunitetin për rritjen e ndërgjegjësimit dhe marrjen e masave paraprake në rast fatkeqësie.

Figura 23: Harta e vërshimit të ujit dhe përmytjeve në Shqipëri



Burimi: Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015 – 2030

## Energjia

Shqipëria është një vend i cili pjesën më të madhe të energjisë elektrike e krijon nga burimet hidrike, hidrocentralet si dhe në muaj të caktuar të vitit, importon një pjesë të energjisë që i nevojitet. Duke parë zhvillimet e fundit në tregun e energjisë dhe hidrokarbureve për shkak të luftës në Ukrainë, çmimet e energjisë pësuan një rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2021 – 2022 dhe kosto e blerjes së saj në treg u bë gati e papërballueshme, duke detyruar shumë vende të Europës, përfshi edhe Shqipërinë, të marrin masa shtrënguese për konsumin e energjisë elektrike.

Me ndryshimet e temperaturave mesatare, shpeshia e ditëve me thatësira ose reshje intensive do të vijë duke u rritur, duke ndikuar kështu edhe energjinë nga burimet hidrike. Rjedhimisht, sektori energjik i vendit do të jetë vulnerabël ndaj krizës klimaterike.

Nga ana tjetër Shqipëria është nënshkruese e marrëveshjes së Parisit dhe vend kandidat për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian e si i tillë ka për detyrim arritjen e objektivave të vendosur nga vendet anëtarë të BE për reduktimin e gazeve serë, uljen e konsumit të energjisë dhe arritjen e sigurisë energjetike. Për të drejtuar vendet europiane drejt këtyre objektivave, në vitin 2020, **BE miratoi "Axhendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor"** me anë të së cilës orienton vendet e Ballkanit Perëndimor drejt dekarbonizimit të sektorëve të ndryshëm duke i dhënë prioritet klimës, energjisë dhe lëvizshmërisë. Për të arritur neutralitetin e klimës deri në 2050, vendet e BP duhet të angazhohen duke ndërmarrë politika e masa mbi qeverisjen me synim përdorimin më të mirë të burimeve dhe promovimin e alternativave të qëndrueshme.

Departamenti Meteorologjisë në Institutin e Gjeoshkencave raporton se ka identifikuar një **ndryshim të theksuar të regjimit të reshjeve në rang vendi**, kjo e krahasuar me mesataret vjetore përgjatë 5 dekadave të kaluara. Ky ndryshim në rrëgjimin e reshjeve reflektohet sigurisht edhe në **reduktimin e totalit vjetor të energjisë së HEC-eve private e publike në vend**. Ndër faktorët e tjerë, të cilët gjerësisht referohen e maten, është e nevojshme të kuptohet sa % e energjisë së importuar në 7 vitet e fundit vjen si rezultat ti pamundësisë për të menaxhuar ujërat e shiut në basenet e këtyre HEC-eve.

Ashtu si të gjithë vendet e BP, Shqipëria duhet të marrë masa për të diversifikuar burimet e energjisë dhe të risi promovimin e përdorimit efikas të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë energjetike. Për të arritur objektivat e klimës dhe energjisë në dhjetor 2021, Qeveria Shqiptare ka miratuar "Planin kombëtar për energjinë dhe klimën 2020 – 2030", i cili parashikon marrjen e masave për a) dekarbonizimin, uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serë (GES); b) rritjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë; c) rritjen e efikasitetit të energjisë, duke ulur konsumin në banesa, shërbime, industri, transport etj.

Masa për efikasitetin e energjisë janë parashikuar edhe në ligjin nr. 124/2015 "Për eficientësinë e energjisë", të ndryshuar, i cili ka për qëllim:

- hartimin e rregullave dhe politikave kombëtare për nxitjen, promovimin e përmirësimin e përdorimit efikas të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe heqjen e pengesave në tregun e energjisë;
- vendosjen e objektivave kombëtarë të efikasitetit të energjisë (EE);
- rritjen e konkurrencës së operatorëve. Ligji i hap rrugë gjithashtu marrjes së masave nga entitetet private biznese/njësi banimi për të ndërmarrë aktivitete të cilat rrisin EE-në në godina apo procese që ato aplikojnë.

Një rast i mirë i aplikimit të masave të parashikuar në legjislacion e plane do të ishte programi rindërtimit dhe programi EU4Schools, të cilat u përjashtuan nga masat e parashikuara në ligjin e EE, duke qenë se ndikonin në rritjen e kostove të investimit. Në këtë drejtim mund të thuhet se ky ishte një rast i humbur për të vendosur një standard në

niveli vendi për ndërhyrje të kryera me financim të Qeverisë Shqiptare apo donatorëve, ku zbatohen masa për EE të parashikuara në legjislacion<sup>26</sup>.

Një nismë tjetër e rëndësishme në nivel vendor është nisma për diversifikimin e burimeve të ripërtëritshme (eolike, diellore), e cila ka mundur marrjen e lejeve për zbatim të infrastrukturës që shfrytëzon energji diellore me kapacitet deri në 1 GW (për referencë, investimet praktike janë në rangun 10 – 25 MW). Aktualisht, investimet për energjinë eolike janë në fazë studimi.

Investime konkrete të Qeverisë Shqiptare në sektorin e energjisë përfshijnë TEC-in lundrues, i marrë me qira dhe i vendosur në Vlorë, si dhe projekti për TEC-in me gaz/ avull në qytetin e Korçës. Të dy këto investime mund të thuhet se janë në konflikt me objektivat për reduktimin e emetimeve dhe dekarbonizimin e sektorit duke qenë se të dy instalimet e bazojnë prodhimin e energjisë nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse fosile.

Duhet theksuar gjithashtu se një nga parakushtet e mbështetjes së Institutit të Kredive për Rindërtim (*KfW Development Bank*) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit për reformën në sektorin e energjisë në Shqipëri ka qenë adresimi ligjor dhe praktik i çështjes së varfërisë energjetike. Përpjekjet për këtë aspekt kanë nisur në 2018 e nuk kanë gjetur ende hapësirë për një zgjidhje të mirëfilltë. OSHC-të rrëfejnë se mbështetja që japin institucionet në vend nuk bazohet mbi konceptin teknik të varfërisë energjetike, por është e lidhur vetëm me statusin socio-ekonomik (vetëm shtresat në nevojë dhe ato në asistencë sociale e përftojnë mbështetjen për subvencionim të konsumit të energjisë elektrike). Nga ana tjetër, varfëria energjetike nënkupton këdo që ka pamundësi për të arritur përmbushjen e nevojave bazike për arsye ekonomike sikundër edhe për arsye teknike si efikasiteti i pajisjeve, komforti termik i godinës etj. Nëse këto të fundit do të aplikoheshin sipas standardeve të këtij koncepti (i cili aplikohet në të gjitha vendet e BE) atëherë vlerësohet se mbi 77% e familjeve në Shqipëri do të përfitonin statusin “varfëri energjetike”.

Plani strategjik parashikon përfshirje më aktive të bashkive në proceset e përgatitjes së “Planeve vendore të efikasitetit të energjisë”, në përputhje me planin kombëtar të EE-së si dhe monitorimin e zbatimit të këtyre planeve. Në këtë drejtim, lipset bashkëpunim i mirë ndërmjet bashkive, operatorëve ekonomik dhe komunitetit për të hartuar e zbatuar plane të cilat parashikojnë marrjen e masave të arritshme për të gjithë palët e përfshira.

Për të adresuar kërkesat e legjislacionit dhe “Planit kombëtar për energjinë dhe klimën” duhet të hartohen plane lokale veprimi e të merren masa për: diversifikimin e burimeve të energjisë, uljen e shkarkimeve GES (dekarbonizimin), rritjen e masave të EE-së, fushata për rritjen ndërgjegjësimit të komunitetit lidhur me përfitimin e EE, promovimi i masave të cilat nxisin investimet të cilat aplikojnë praktika të EE etj.

---

<sup>26</sup> Në të njëjtën vazhdë, institucionet e qeverisjes në nivelin kombëtar e vendor duhet të përfshijnë masa të parashikuara në proceset e planifikimit dhe dhënies së lejeve të shfrytëzimit të burimeve natyrore, për të rregulluar përgatitjen dhe reziliencën kundrejt ndryshimit klimatik.

## 2. GRUPE INTERESI TË PËRFSHIRË

Në projektin Green-AL janë shpallur dy skema grantesh, të cilat kanë pasur në fokus përfshirjen e organizatave mjedisore në vend në nivele të ndryshme, duke u fokusuar tek organizatat e konsoliduara kombëtare e deri tek ato organizata të vogla vendore të cilat operojnë në zona rurale e me komunitete të margjinalizuara si dhe është nxitur bashkëpunimi me OSHC të tjera, institucione qeveritare në nivel lokal e kombëtar, media, institucione arsimore e biznese me qëllim rritjen e gjithëpërfshirjes.

Thirrja e parë për grante është hapur në korrik të 2021 dhe nëpërmjet:

- **Granteve të Inicativës** ka pasur qëllim të përfshijë organizata mjedisore me minimumi një vit përvojë të cilat përfaqësonin problematikat mjedisore të komuniteteve lokale;
- **Granteve të Partneritetit**, ka pasur qëllim të përfshijë organizata mjedisore më të konsoliduara me një minimum prej 3 vitesh përvojë të cilat do të ngrinin problematika mjedisore në nivel bashkie si dhe ato të kishin mundësi të krijojnë partneritet me njësitë e qeverisjes vendore, biznese apo institucione arsimore.

Në thirrjen e parë janë shpallur fitues 21 aplikime (projekte), 17 kanë qenë grante të Inicativës dhe 5 të Partneritetit. Në rajonin qendror janë zbatuar 6 grante të Inicativës e 2 të Partneritetit.

Thirrja e dytë për grante është hapur në dhjetor 2021, e ka pasur në fokus rijetëzimin, advokimin dhe ndikimin në politikë-bërje dhe ka qenë e organizuar në dy nivele:

- **Rrjetet rajonale**, të cilat kanë pasur në fokus çështje mjedisore me interes rajonal (ndërbashkiak/në nivel qarku);
- **Rrjetet kombëtare**, të cilat kanë pasur në fokus çështje mjedisore me interes kombëtar.

Synimi për të dy nivelet e rrjeteve ka qenë që organizatat partnere të projekteve fituese të përfshiheshin në procesin dhe dialogun me politikë-bërësit lokal/rajonal/kombëtar duke advokuar për një mjedis të shëndetshëm dhe në mbrojtje të habitatit.

Pjesë e këtij dokumenti do të jetë një shpjegim më i zgjeruar lidhur me projektet e zbatuara në kuadër të granteve të Inicativës dhe Partneritetit.

Tabela 9. Projekte të zbatuara në rajonin qendror

Skema e Granteve	Organizata	Partnerë	Titulli i Projektit	Vendi/Bashkia në të cilën është zbatuar projekti
Partneriteti	1) Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit – IMMT	1) Bashkia Kavajë; 2) Bashkia Roskovec; 3) Bashkia Divjakë	Monitorimi i performancës mjedisore nëpërmjet dixhitalizimit të të dhënave.	Bashkia Kavajë, Roskovec dhe Divjakë
	2) <i>Eco Partners for Sustainable Development</i>	1) Qendra Epoka e Re; 2) Bashkia Patos; 3) Bashkia Roskovec	Fuqizimi i zërit të shoqërisë civile dhe komunitetit për një mjedis më të shëndetshëm në Patos dhe Marinëz.	Bashkia Patos dhe Roskovec
Iniciativa	1) Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore – Agri En	-	Mbrojtja e bimëve medicinale dhe aromatike.	Bashkia Librazhd
	2) <i>H2H Foundation</i>	-	Uji aktiv (origjinali në anglisht: <i>Active Water</i> ).	Bashkia Tiranë
	3) <i>North Green Association</i>	-	Erzeni thërret!	Qarku Durrës dhe Tiranë
	4) Instituti i Politikave Mjedisore – IPM	-	Ekonomi qarkulluese nëpërmjet kompostimit të mbetjeve organike në Baldushk.	Njësia Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë
	5) MENV Group	-	Trajtimi i integruar i ujërave të përdorur prej kompanive turistike, në dobi të mjedisit dhe turizmit, në plazhin Spille, Kavajë.	Spille, bashkia Rrogozhinë
	6) Fondacioni EDS	-	Tirana qytet xhungël (origjinali në anglisht: <i>Tirana jungle city</i> ).	Bashkia Tiranë
Rrjetëzimi, advokimi dhe ndikimit në politikë-bërje	1) Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri – INCA	1) Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore – Agri En; 2) Flag Pine; 3) Federata e Pyjeve Shkodër	Fuqizimi i OJQ-ve Shqiptare për të mbështetur krijimin dhe menaxhimin e rrejtit Natura 2000 në Shqipëri / Mbrojtja e biodiversitetit.	Bashkia Tiranë, Shkodër, Librazhd, Vlorë
	2) Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë – AOS	1) Qendra për Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore në	OJQ-të për ruajtjen e biodiversitetit (në anglisht: <i>NGOs for</i>	Shqipëri

		Shqipëri – <i>EcoAlbania</i> ; 2) <i>Res Publica</i> ;	<i>biodiversity conservation</i> ).	
	3) Forumi i Mendimit të Lirë – FML	1) Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile – Durrës; 2) Qendra “ <i>All Minds Empowered</i> ” 3) Vizioni i Gjellbërt; 4) <i>Hand to Hand Against National Apathy – HANA</i>	Përshtatja e bujqësisë, si sfidë përballë ndryshimeve klimatike.	Shqipëri
	4) <i>Millieukontakt</i> Shqipëri	1) Shoqata <i>Together for Life</i> ; 2) Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim – <i>EPER Center</i>	Ajër i pastër, jetë e shëndetshme!	Bashkia Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë
	5) Qendra e Burimore e Mjedisit në Shqipëri – <i>REC Albania</i>	1) Shoqata “Unë, Gruaja”; 2) rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri – <i>BIRN Albania</i> ; 3) Shoqata “Udhëtim i lirë”	N'kuvend: për alternativa mjedisore të zhvillimit.	Bashkia Shkodër, Durrës, Pogradec, Vlorë

Burimi: *Green-AL*

Gjatë zbatimit të projekteve, përfituesit e skemave të granteve në *Green-AL* kanë zbatuar një seri aktivitesh me natyrë të ndryshme e kanë përfshirë një numër aktorësh e grupesh interesi në varësi të tematikës e zonës në të cilën kanë aplikuar projektin.

Në të dhënat e paraqitura më poshtë përfshihen edhe aktivitete e zhvilluara nga “Rrjetet kombëtare e rajonale”.

Janë zbatuar rreth **77 aktivitete rrjetëzimi/bashkëpunimi** të cilat kanë pasur për qëllim diskutimin e çështjeve të trajtuara nga projektet e zbatuara qofshin ato teknike, legjislative apo ndërgjegjësuere të cilat kanë synuar të bëjnë bashkë grupe të ndryshme interesi. Në këto takime, kanë marrë pjesë përfaqësues të OSHC-ve të cilat operojnë në rajonin qendror por edhe më gjerë, komunitete lokale dhe përfaqësues të institucioneve të tilla si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Kombëtar i Territorit, Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor; në nivel


vendor ishin të pranishëm përfaqësues nga bashkitë Divjakë, Kavajë, Rogozhinë, Patos, Librazhd, Roskovec, Tiranë etj. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë rreth 1,820 persona.

Green-AL e konsideron mjaft të rëndësishme përfshirjen e institucioneve arsimore në të gjitha nivelet, që nga cikli i ulët (kopshtet) deri tek i larti (universitetet), pasi këto institucione luajnë një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e përgjithshëm e atë mjedisor të brezave të ardhshëm në mënyrë të fillë për të rritur vetëdijen qytetare e këtij grupi interesi por jo vetëm. Në këtë drejtim, Green-AL ka nxitur aplikantët në skemat e granteve të bashkëpunojnë me institucionet arsimore dhe të përfshijnë në mënyrë aktive mësuesit/pedagogët dhe nxënësit/studentët në aktivitete të cilat i kanë zbatuar gjatë aplikimit të projektit të tyre.

Në tërësi, janë zhvilluar 23 aktivitete edukuese/trajnime/punëtori në të cilat janë përfshirë rreth 646 të rinj, të reja dhe mësues të shkollave fillore e të mesme dhe universiteteve. Gjithashtu organizatat përfituese të skemës së granteve në Green-AL kanë organizuar apo publikuar:

- **5 fushata advokimi** mbi tematika dhe çështje mjedisore;
- **2 aktivitete** të cilat kanë pasur në fokus **shkëmbimin e eksperiencave**, me organizata të tjera mjedisore nga rajoni apo edhe jashtë kufijve, për iniciativa të ngjashme të projekteve mjedisore;
- **19 publikime** në median lokale dhe kombëtare, për promovimin e projektit, ndërgjegjësimin dhe diskutimin mbi problematikat mjedisore;
- **11 dokumente** të cilat përfshijnë raporte, plane, projekte apo letra pozicionimi të cilat evidentojnë e adresojnë problematikat mjedisore të trajtuara në projektet e zbatuara nga OSHC-të.

Grafiku 5: Gjinia e pjesëmarrësve në aktivitetet e zhvilluara nga OSHC-të



Në total, në aktivitetet e zhvilluara nga organizatat përfituese të granteve të "Iniciativës dhe partneritetit" dhe "Rrjetet kombëtare e rajonale", deri në dhjetor 2022 janë përfshirë në mënyrë aktive rreth 2,653 persona nga të cilët 1,068 kanë qenë gra ose vajza (ose rreth 40% e totalit), duke sugjeruar një përfshirje të mirë të tyre në aktivitete ku pjesëmarrja e tyre ka qenë ndjeshëm më e lartë në aktivitet edukuese.



## Komunikimi


Duke qenë se komunikimi ka një rol të rëndësishëm në zbatimin e projekteve të zbatuara nga OSHC-të për të shpërndarë arritjet e për të ndërgjegjësuar grupet e interesit, organizatat fituese të granteve në Green-AL kanë përdorur mjete të ndryshme komunikimi, si fletëpalosje me mesazhe ndërgjegjësuese apo informacion teknik, postera statik, e publikime në rrjete sociale, si një nga mënyrat më të përdorura për shpërndarjen e informacionit në kohët e sotme. Në këtë drejtim, organizatat kanë kryer rreth 300 postime në rrjetet *Facebook* (Meta) dhe *Instagram*, duke arritur një shikueshmëri për rreth 33,000 personash.

Nga ana tjetër edhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të projekteve në rajonin qendror dhe ato të rrjeteve kombëtare, ka punuar kryesisht në kanalet e medias *online* me postime në platforma si: *Facebook*, *Instagram*, *LinkedIn* dhe *Twitter*, me qëllim informimin e grupeve të interesit lidhur me aktivitetet e zhvilluara në këto projekte, duke stimuluar prezencën e inputin e tyre në aktivitete të ndryshme. Në këtë drejtim në platformat sociale të Co-PLAN janë publikuar gjithsej 107 postime gjatë vitit 2022 ku vetëm në *Facebook*, u arritën 184,935 përshtypje, 153 raste ndarjeje, 3,211 pëlqime dhe 9,794 klikime.

## Procesi i inkubimit

Për të rritur kapacitetet dhe njohuritë e OSHC-ve, ekspertëve dhe aktivistëve në fushat që lidhen me mjedisin, partnerët e projektit Green-AL kanë zhvilluar një sërë trajnimesh tematike të fokusuara në çështjet mjedisore, por edhe administrative, nën ombrellën e konceptit të “Procesit të inkubimit”. Gjatë zbatimit të projektit Green-AL në rajonin qendror, janë zhvilluar 10 trajnime të cilat kanë trajtuar tema si menaxhimi teknik e financiar i projekteve, çështjet gjigëz dhe lidhja e tyre me sektorin e mjedisit, si dhe tema aktuale mjedisore si: edukimi mjedisor, ekonomia qarkulluese dhe turizmi i qëndrueshëm, menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave, menaxhimi i riskut natyror dhe masat për reduktimin e tyre etj.

Grafiku 6: Gjinia e pjesëmarrësve në trajnimet e “Procesit të inkubimit”



Në këto trajnime, ka pasur një prani të relativisht të kënaqshme — në total ka pasur 162 pjesëmarrës, nga të cilët 95 kanë qenë gra dhe vajza (rreth 59% i totalit). Në raport me përfshirjen e grave dhe vajzave në aktivitetet e zhvilluara nga organizatat, vërejmë një pjesëmarrje më të lartë në trajnimet e zhvilluara në Green-AL, që sugjeron se ka një interes të shtuar prej tyre rreth ndërveprimit të çështjeve mjedisore me ato gjinore.

Në trajnime kanë qenë pjesëmarrës 40 organizata të shoqërisë civile, 2 përfaqësues nga institucionet vendore (Bashkia e Tiranës dhe Bashkia e Lushnjës), rreth 20 konsulent të pavarur dhe 2 institucione arsimore, së bashku me studentët e tyre (Universiteti Polis e Universiteti Bujqësor i Tiranës).

Burimi: Green - AL

## 3.PROJEKTE TE ZBATUARA

### 3.1 PROJEKTI: “MBROJTJA E BIMËVE MEDICINALE DHE AROMATIKE”

**Organizata zbatuese:** [Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore Agri-En](#)

**Vendi e zbatimit:** Bashkia Librazhd

#### 3.1.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS

Bashkia e Librazhdit bën pjesë në qarkun e Elbasanit dhe shtrihet në lindje të Shqipërisë në një terren kodrinoro-malor, në një sipërfaqe prej 793.36 km<sup>2</sup>; pjesa më e madhe e territorit të saj është pyjor dhe bimor (më shumë se 65%). Në territorin e bashkisë së Librazhdit, ka burime të shumta ujore të cilat i shërbejnë banorëve të saj për ta përdorur për nevoja personale e për vaditjen e tokave bujqësore. Në këtë bashki, janë rreth 44,000 banorë, e pjesa më e madhe e tyre jeton në zonat rurale. Bashkia e Librazhdit është e organizuar në shtatë njësi administrative të cilat janë: Librazhd, Librazhd Qendër, Stëblevë, Orenjë, Lumik, Polis dhe Hotolisht. Duke qenë se Bashkia e Librazhdit është kryesisht një zonë rurale me një strukturë agrare, burimi kryesor i të ardhurave për banorët është vetëpunësimi në bujqësi.

Figura 24: Harta e bashkisë Librazhd



Burimi: Përpunuar nga autorët

Në zonën e Librazhdit, gjenden 1,857 lloje bimësh spontane dhe enëzore, të cilat përfaqësojnë 58% të florës së Shqipërisë ose 16% të florës së Europës. Kjo vendos Librazhdin në një pozitë të pasur me bimë të llojeve të ndryshme në krahasim me zonat e tjera të vendit. Të gjitha kategoritë dhe mbulesa bimore janë të pranishme dhe zënë rreth 72% të territorit të Librazhdit. Zona e Librazhdit është strehë edhe për një numër të madh specieve të faunës së egër, si ariu kaf, rrëqebulli, ujku, derri i egër, dhia e egër, trofta e egër etj. Në një pjesë të territorit të bashkisë Librazhd shtrihet Parku Kombëtar i Shebenikut me një sipërfaqe prej 34,000 ha, që përbën një nga pasuritë e rralla natyrore dhe me biodiversitet të larmishëm në këtë zonë.


Parku Kombëtar Shebenik ndodhet në një zonë ndërkufitare me vlera të larta gjeodiversiteti dhe biodiversiteti. Duke qenë pjesë e Brezit të Gjellbër Evropian, është një vijueshmëri e natyrës nga veriu i Evropës deri në Ballkan, që shërben si një kurriz lidhës natyror dhe ekologjik mes 24 vendeve të Evropës. Parku Kombëtar Shebenik shtrihet në malet e Shebenikut dhe të Jabllanicës, i cili fillon nga 700 m lartësi mbi nivelin e detit e deri në 2,262 m, në të cilën ndodhet dhe maja më e lartë e masivit të Shebenikut.

Në Parkun Kombëtar Shebenik gjendet rreth 32% e florës së Shqipërisë, rreth 82% e llojeve të bimëve aromatike dhe mjekësore, si dhe rreth 178 lloje të bimëve mjekësore. Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë është një territor shumë i pasur në florë dhe faunë, duke shfaqur vlera shumë të larta të biodiversitetit, të cilat i japin rëndësi të veçantë zhvillimit të turizmit natyror. Bukuritë e peizazhit të parkut janë si rrjedhojë e ndërthurjes së shumë elementëve natyrore, si: format e larmishme të relievit, pasuritë ujore, flora dhe fauna.

Potencialet natyrore në këtë hapësirë gjeografike janë të shumta — numërohen 10 monumente natyrore, e 14 liqene akullnajore (liqeni i Shebenikut, liqenet e Racjës, etj). Zona e Rrajcës është pasuri natyrore e mbrojtur nga UNESCO.

Bimët medicinale aromatike (BMA) janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për familjet në zonat malore. BMA-të kanë qenë tradicionalisht një nga kategoritë kryesore të produkteve agro-ushqimore të eksportuara (aktualisht të dytat pas perimeve). Sipas një studimi të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, AIDA, qarku i Elbasanit është i dyti pas Shkodrës në eksportin e BMA-ve në Shqipëri. Librazhdi është Bashkia e parë brenda qarkut për sipërfaqen më të madhe me bimësi, për numrin dhe llojet e BMA-ve si dhe për numrin e personave që i mbledhin në natyrë. Kjo ka sjellë që fondi i bimëve medicinale dhe aromatike, duke përfshirë specie endemike, veçanërisht në zonat malore, është nën një presion të vazhdueshëm dhe po degradon me shpejtësi për shkak të praktikave të paqëndrueshme, të pakontrolluara dhe të papërshtatshme të korrjes. Si rrjedhojë, ka pasur një rënie drastike të shumë specieveve, të cilat tashmë janë shumë të rrezikuara, si: aguliçja (*Primula veris* L), sanëza (*Gentiana lutea*), salepi (*Orehis mascula* L), trëndafili i egër (*Rosa canina*), sherbela (*Salvia officinalis*), etj.

Figura 25: Bimët medicinale aromatike



Burimi: Agri-EN

Problemi kryesor me BMA-të në bashkinë Librazhd është mungesa e informacionit në komunitet (fermerë, prodhues, mbledhës dhe tregtarë) mbi teknikat e përdorimit të

burimeve bimore. Mungesa e një plani dhe një udhëzuesi i cili t'i trajnojë ata mbi praktikën e vjeljes, trajtimit dhe përpunimit të bimëve medicinale dhe aromatike, ka sjellë një situatë jo të mirë në menaxhimin e efikas të fondit të këtyre bimëve. Gjithashtu, strukturat përkatëse (si shërbimi pyjor) nuk po luajnë rolin e kontrollit të plotë mbi mbrojtjen dhe menaxhimin e bimëve mjekësore, sidomos për mbrojtjen e bimëve të rrezikuara të cilat janë pjesë e listës së kuqe (CR). Disa probleme të tjera të hasura janë dhe mbi-kullotja, zjarrvëniet intensive për hapjen e kullotave dhe shkulla e bimëve me rrënjë, të cilat po çojnë në degradim dhe zhdukjen e shumë specieve. Problemet e lartë përmendura, për mbrojtjen e specieve dhe metodave të kultivimit të BMA-ve, kërkojnë forcimin e kapaciteteve të komunitetit dhe fermerëve në zonën e përcaktuar e cila mbledh dhe tregton BMA-të, investime në parcela model dhe aktivitete për shkëmbimin e përvojave bujqësore me fermerë të tjerë të përfshirë në kultivimin e tyre. Rrjedhimisht, kjo do të sillte një menaxhim të qëndrueshëm të bimëve medicinale si dhe rritje të ndërgjegjësimit të komunitetit të vjelësve lidhur me praktikën e qëndrueshme të kultivimit të BMA-ve.

### 3.1.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Bimët medicinale dhe aromatike, duke përfshirë specie endemike veçanërisht në zonat malore të bashkisë Librazhd, janë në një presion të vazhdueshëm dhe shumë të rrezikuara për shkak të praktikave të paqëndrueshme dhe të papërshtatshme të korrjes. Kjo ka rezultuar në një rënie drastike të shumë specieve, të cilat tashmë janë në "listën e kuqe". Duke parë këto problematika, Agri – En, gjatë periudhës nëntor 2021 – qershor 2022 zbatoi projektin "Mbrojtja e bimëve medicinale dhe aromatike" me objektiv të përgjithshëm: "Të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore duke ndërgjegjësuar komunitetin dhe duke trajnuar palët e interesit (fermerët) për të promovuar teknika të reja të mbledhjes dhe kultivimit në mënyrë që të zvogëlojë presionin mbi speciet e egra". Gjithashtu, rritja e kapaciteteve të punonjësve të administratës lokale për të siguruar zbatimin e legjislacionit do të ofronte një tjetër masë për mbrojtjen e natyrës si dhe për të rritur të ardhurat e banorëve të zonës.

Projekti u konceptua për të arritur rezultate të prekshme, duke ndërthurur rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe administratës si dhe demonstrimin përmes mbjelljes së 200 fidanëve aronia në një sipërfaqe prej 1,100 m<sup>2</sup> në fshatin Mirakë për të ilustruar te banorët vlerat e BMA-ve si një kontribut konkret i projektit për të promovuar një praktikë të mirë e të vyeshme për komunitetin vendas.

Në fazën e parë, projekti u përqendrua në zhvillimin e takimeve informuese në njësi të ndryshme administrative. U zhvilluan 3 takime me pjesëmarrjen e 48 qytetarëve, të cilët u informuan për rëndësinë dhe vlerat e kultivimit të BMA-ve dhe përfitimet ekonomike që mund të sjellë kultivimi i tyre për komunitetin si dhe për aktivitetet e projektit në mënyrë që të mund të përfshiheshin në mënyrë aktive.

Pas informimit të grupeve të interesit ku në fokus ishin vjelësit e BMA-ve dhe administrata lokale, zbatuesit e projektit u përqendruan në zbatimin e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit të brezave të rinj lidhur me praktikën e mira në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në kuadër të këtij aktiviteti u zhvilluan rreth 6 orë

mësimore, në të cilat morën pjesë rreth 75 nxënës dhe mësues nga shkollat e mesme të bashkuara në njësitë administrative Polis dhe Orenje.

Figura 26: Orët mësimore në shkollat e mesme të bashkuara Librazhd



Burimi: Agri-EN

Në vijim, zbatuesit e projektit u fokusuan në aktivitetin për promovimin e kultivimin e qëndrueshëm të BMA-ve. Në këtë rast, rasti studimor ishte bima e aronias, e cila prodhon frute shumë të dobishme për shëndetin e njeriut dhe ka përdorim shumë të lartë, veçanërisht në industrinë farmaceutike, për përgatitjen e preparateve për trajtimin e presionit të lartë të gjakut, sëmundjeve neurologjike si dhe në përmirësimin e kujtesës.

Një përparësi që ka kjo bimë është se nuk kërkon kujdes të veçantë - duke pasur parasysh se numri i sëmundjeve dhe dëmtuesve që e sulmojnë atë është shumë i vogël, ajo mund të rritet pa përdorimin e pesticideve.

Figura 27: Mbjellja e fidanëve të aronias në bashkinë Librazhd



Rreth 200 bimë aronia u mbollën në një sipërfaqe të braktisur, prej 1,100 m<sup>2</sup>, e cila ishte në pronësi të bashkisë Librazhd e administruar nga Njësia Administrative Polis. Kjo sipërfaqe provë do të shërbejë për të promovuar kultivimin e qëndrueshëm të BMA-ve si dhe do të promovojë:

- ndërgjegjësimin e komunitetit për shtimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë medicinale për uljen e ndikimit të shfrytëzimit të këtyre bimëve në natyrë;
- shfrytëzimin e tokave të braktisura, mbrojtjen e tokës nga erozioni, përmirësimin e peizazhit dhe në shtimin e ushqimit për faunën e egër;
- praktika të mira për rritjen e të ardhurave të banorëve të zonave rurale dhe uljen e papunësisë.

Në fazën e fundit të projektit, u realizua trajnimi i kultivuesve të BMA-ve në bashkinë Librazhd mbi teknikat e vjeljes, grumbullimit si dhe rregullat bazë që duhen zbatuar për grumbullim të qëndrueshëm. Gjithashtu, fermerët e përzgjedhur nga zbatuesit e projektit, u trajnuan dhe për grumbullim, paketim, ruajtje, transport dhe dokumentim të korrjes së këtyre bimëve në mënyrë që në të ardhmen të kryejnë procesin në tërësi. Në trajnim morën pjesë 43 fermerë nga zonat rurale të bashkisë Librazhd, të cilët do të shërbejnë për të promovuar praktikën e qëndrueshme të kultivimit të BMA-ve, mbrojtjen e biodiversitetit si dhe baza të forta për përsëritjen me sukses të projektit edhe në zona të tjera të bashkisë, duke përfshirë edhe një numër më të madh banorësh e fermerësh.

Figura 28: Trajnimi i kultivuesit të BMA-ve



Burimi: Agri-EN

Për të mundësuar mësim praktik dhe shkëmbim njohurish të punonjësve të grupeve të interesit të përfshirë në projekt, zbatuesit e projektit mundësuan një vizitë studimore në një fermë të njohur për kultivimin e BMA-ve në qytetin e Strugës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo vizitë i shërbeu të pranishmëve për të parë nga afër se si mund të organizohet dhe të funksionojnë fermat e kultivimit të BMA-ve dhe përfitimet që mund të ketë komuniteti. Në këtë vizitë morën pjesë 20 persona nga administrata e bashkisë së Librazhdit, njësisive administrative Polis dhe Orenje, kryetarë fshatrash, OSHC lokale dhe fermerë.

Figura 29: Vizita studimore në Strugë



Burimi: Agri-EN



### 3.1.3 SUGJERIME

Disa nga sugjerimet e nxjerra nga zbatimi i këtij projekti janë:

- Mbështetje financiare për kryerjen e një studimi mbi gjendjen e bimëve të rrezikuara dhe monitorimi gjendjes aktuale të tyre për të përcaktuar faktorët që ndikojnë në degradimin e këtyre bimëve;
- Trajnimi i banorëve që korrin bimët e egra në natyrë, mënyra e mbledhjes, koha, vendi dhe çfarë duhet të marrin në konsideratë që këto bimë të mos zhduken, mirë menaxhimi i tyre, etj.;
- Mbështetje për mbjelljet e reja të BMA-ve;
- Mbështetje në makineri bujqësore nga subvencionet e grantet (traktorë, makineri për nivelimin e dheut etj.);
- Mbështetje financiare për ndërtimin e mjediseve për tharjen e BMA-ve përpunimit të tyre për ekstraktimin e vajit esencial si dhe linja të thjeshta përpunimi në mënyrë që të rritet vlera e produktit;
- Sektori i BMA-ve duket të përfitojë nga skemat e mbështetjes kombëtare nëpërmjet formës së granteve apo formave të tjera të financimit.

### 3.2 PROJEKTI: ERZENI THËRRET

**Organizata zbatuese:** [North Green Association](#)

**Vendi i zbatimit:** Qarku i Tiranës dhe Durrësit

#### 3.2.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS


Lumi Erzen bën pjesë në lumenjtë e vegjël të vendit. Ai ka një pellg ujëmbledhës prej 760 km<sup>2</sup>, lartësi mesatare 435 m mbi nivelin e detit dhe një pjerrësi prej 6%. Erzeni buron në afërsi të qafës së Rinasit në Malësinë e Shëngjinit, në kuotën 1,350 m mbi nivelin e detit. Para se të futet në grykën e Skoranës, Erzenit i bashkohen disa burime që janë 'ushqyeset' kryesore të tij, sidomos në periudhën më të thatë të vitit. Në vazhdim të rrjedhës, pjerrësia e shtratit zvogëlohet dhe lugina fillon të zgjerohet nga fshati Pjeshkaj e deri në grykëderdhje në detin Adriatik, në Gjirin e Lalzit.

Prurja mesatare shumë-vjeçare e Erzenit në grykëderdhje është 18 m<sup>3</sup>/s, kurse koeficienti i rrjedhjes për të gjithë pellgun e Erzenit është 0,51. Ujërat sipërfaqësore të Erzenit përfaqësojnë 69% të rrjedhës ujore vjetore, ndërsa ujërat nëntokësorë 31%. Erzeni dallohet për erozion dhe prurje në sasi të madhe të lëndës të ngurtë, rreth 102 kg/sek, prandaj ai është një lumë i turbullt (5640 gr/m<sup>3</sup>), i cili sjell shkarkime të mëdha të aluvioneve pezull (4180 ton/km<sup>2</sup>/vit).

Ujërat e Erzenit përdoren gjerësisht për ujitje. Në pjesën e poshtme të tij në NJA Ndroq është ndërtuar kanali ujitës (Ndroq – Çollak – Shijak) i rëndësishëm për të gjithë sipërfaqet bujqësore të kësaj zone (Cullaj, et al 2005).<sup>27</sup>

Të dhënat nga “Raporti i gjendjes në Mjedis 2021” evidentojnë se baseni Ishëm-Erzen është një ndër basenet më të ndotura, sidomos në zonat urbane (ku faktor kryesor për ndotjen e tij mendohet të jenë komuniteti dhe bizneset). Ky basen është burimi jetik për zhvillimin e dy qarqeve si Tirana dhe Durrësi, në degë të shumta të ekonomisë si blegtoria, bujqësia, turizmi etj. Nga viti në vit vihet re një përkeqësim i situatës — për këtë arsye, *North Green Association* me projektin “Erzeni Thërret” ka synuar ndërgjegjësimin mjedisor të të gjithë aktorëve.

Figura 30: Harta e rrethës së lumit Erzen



Burimi: Përpunim nga autorët

<sup>27</sup> Nuro A., Marku E., Murataj B.: Prania e disa ndotësve organikë në mostrat e ujit të lumit Erzen, f. 138

Dokumentet zyrtare tregojnë se situata po shkon gjithmonë drejt përkeqësimit: sipas AKM-së, në vlerësimin e bërë për vitin 2022, gjendja e basenit të lumit Erzen është e kategorisë IV, pra e keqe dhe nuk ka përmirësime. Institucionet shtetërore nuk marrin masa për ndotësit, të cilët si fillim duhet të edukohen, ndërgjegjësohen dhe të penalizohen në rast shkelje. Në të gjithë monitorimin dhe evidentimin e bërë në terren, brigjet e lumit janë kthyer në vend-depozitim të mbetjeve urbane, inerte, derdhje të ujërave të ndotura, industriale dhe të kimikateve të ndryshme e deri tek mbetje spitalore.

Referuar të dhënave të publikuara nga projekti “Uji Aktiv”/“Active Water” — projekt i zbatuar nga organizata H2H Foundation me mbështetjen e Green-AL, me në fokus monitorimin e cilësisë së ujërave që përdoren për ujitje —ndotja bakteriale e lumit Erzen është disa herë më e lartë se normat e lejuara. Nga analizat e kryera, rezulton se lumi është i ndotur nga bakteret e *Escherichia coli* dhe nuk këshillohet aspak përdorimi për qëllime vaditje apo rekreacioni në disa pjesë të tij.

### 3.2.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

North Green Association është përkushtuar ndër vite në shumë tematika të çështjeve mjedisore në Shqipëri, ku një ndër to është monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së ndotjes së lumenjve. Në vitet e tranzicionit, ndotja industriale është shoqëruar edhe me ndotjen nga mbetje urbane të të gjitha llojeve. Në mënyrë të veçantë, North Green Association është fokusuar në nxjerrjen në pah të problematikave që shoqërojnë ndotjen e basenit të Lumit Erzeni, ndër basenet më të ndotura në Shqipëri sipas raportimeve edhe të vetë institucioneve shtetërore. Kjo situatë është shqetësuese për banorët që jetojnë në zonat në afërsi të basenit ujqor, të cilët përdorin ujin e rrjedhës së Erzenit për nevojat e tyre. Shqetësimi i tyre është dërguar edhe pranë institucioneve kompetentë, por nuk është marrë në konsideratë. Ndërkohë që gjendja e menaxhimit të burimeve ujqorë mbetet njëlloj, situata përkeqësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Projekti “Erzeni Thërret” synon ndërgjegjësimin mjedisor që nuk arrin të realizohet nga institucionet shtetërore, qoftë qendrore apo vendore.

Zbatuesit e kësaj nisme e kanë konceptuar zbatimin e saj në katër këndvështrime kryesore, kjo për të qenë më e prekshme, më e matshme dhe më e arritshme nga të gjithë qytetarët dhe për të pasur më shumë ndikim në ndryshimin e situatës aktuale në nivel vendor në kuadër të ndërgjegjësimin mjedisor. Katër këndvështrimet mbi të cilat është zbatuar projekti janë si më poshtë:

- Këndvështrimi teorik — praktik;
- Këndvështrimi vlerësues dhe ndërgjegjëses;
- Këndvështrimi për rritjen e kapaciteteve;
- Këndvështrimi mediatik.


Hapat e parë janë fokusuar në monitorimin e lumit Erzen nga burimi e deri në grykëderdhje në detin Adriatik. Segmente të caktuara gjatë monitorimeve në terren,

evidentohen të jenë mjaft të ndotur. Nga të dhënat e mbledhura me anë të pajisjeve dron është bërë kategorizimi i ndotjeve si në vijim:

- Ndotje nga mbeturina të ngurta urbane;
- Inerte apo shfrytëzim nga guroret e instaluara pranë basenit;
- Ndotje nga të ndotura urbane;
- Ndotje nga shkarkimet e ujërave industriale të pa-trajtuara, kryesisht nga bizneset që operojnë në zonë;
- Ndotje nga kimikate të ndryshme blegtorale, shtazore dhe bujqësore;
- Ndotje nga mbetje spitalore.

Niveli më i lartë i ndotjes është evidentuar pikërisht në zonat urbane. Sipas të dhënave të mbledhura në terren, të ilustruara në grafikun më poshtë, janë verifikuar mbi 108 pika të nxehta me tipologji të ndryshme ndotjeje, duke filluar nga depozitimi i mbetjeve inerte dhe urbane e deri tek depozitimi i mbetjeve spitalore apo shkarkimi i ujërave industriale të pa-trajtuara. Grafiku i mëposhtëm ilustron segmentin më të ndotur, “Burimi i lumit Erzen-Ura e Beshirit”, që shkaktohet nga depozitimet e mbetjeve inerte dhe urbane, si dhe shkarkimet e ujërave të ndotura.

Grafiku 7: Ndotja në segmentin “Burimi i lumit Erzen-Ura e Beshirit”



Burimi: North Green Association

North Green Association, përgjatë zbatimit të projektit, ka përpiluar mbi 30 foto-infografika ndërgjegjësuese të cilat më pas janë publikuar në rrjetet sociale dhe multimediale.

Figura 31: Infografikat ndërgjegjësuese



Burimi: North Green Association

Informacioni bazë i shpërndarë lidhet me shqetësimin e organizatave mjedisore për situatën e ndotjes që shkaktohet në lumin Erzen, kryesisht përgjatë zonave urbane. Derdhja e vazhdueshme e lëndëve kimike, materialeve të ngurta, ujërave të ndotura e industriale është kthyer në një praktikë të vazhdueshme. Ndër aktivitetet kryesore të projektit janë vizitat në terren, për të monitoruar nga afër situatën dhe për ta pasqyruar atë. Gjatë aktivitetit, është monitoruar nga ajri e gjithë rrjedha lumore, nga burimi deri në grykëderdhje në detin Adriatik. Në të gjithë vijën, pasqyrohet qartë e gjithë problematika e ndotjes. Më qartë mund të vihet re në figurën e mëposhtme, realizuar nga monitorimet e bëra nga ajri me aparataturat dron.

Përfaqësuesit e organizatës kanë kryer vizita në terren, për të evidentuar me saktësi ndotjen e lumit nga ana sipërfaqësore dhe kategorizimin e kësaj ndotje. Ndotja kryesisht shkaktohet nga depozitimi i mbetjeve urbane, derdhja e ujërave të ndotura e industriale dhe derdhja e ujërave nga gropat septike. Gjetjet e projektit janë përfshirë në një raport të hartuar i cili ilustron me fotografi dhe koordinata të sakta vendin dhe llojin e ndotjes së shkaktuar.


Ky informacion, së bashku me materialet filmike, i është dorëzuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, për t'i vënë në dijeni të situatës së vëzhguar në terren, për të mundësuar inspektimin apo ndërhyrjen me marrjen e masave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, ku është e nevojshme.

Figura 32: Ndotja në lumin Erzen



Burimi: North Green Association

Figura 33: Pikat e monitorimit





Burimi: North Green Association

Një prej aktiviteteve të projektit ishte hartimi i një analizë ligjore lidhur me kompetencat e institucioneve në nivel vendor, rajonal e kombëtar për monitorimin e baseneve ujore dhe shkaktarëve të ndotjes. Kjo analizë është një kontribut modest i zbatuesve të këtij projekti për të dhënë sugjerime mbi institucionet të cilat janë ngarkuar me ligji për monitorimin e ndotjes së baseneve ujore, megjithatë del qartë se ka mbivendosje kompetencash ndërmjet institucioneve si dhe ka hapësirë për interpretimin e ligjit.

Përtej monitorimeve në terren dhe analizës së legjislacionit, në kuadër të zbatimit të këtij projekti janë zhvilluar edhe dy tryeza të rumbullakëta me qëllim ndarjen e gjetjeve si dhe sjelljen në vëmendjen e institucioneve të kësaj problematike. Në këto tryeza të rumbullakëta morën pjesë institucionet në nivel kombëtar e vendor si, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit Tiranë (AKMT) si dhe përfaqësues të OSHC-ve, aktivistë, e përfaqësues të komunitetit, të cilët janë shprehur rreth problematikave të prezantuara.


Figura 34: Organizimi i tryezave të rumbullakëta, projekti "Erzeni Thërret"



Burimi: North Green Association

Komunikimi dhe publikimi i gjetjeve dhe aktiviteteve ka qenë edhe një ndër pikat e forta të projektit "Erzeni Thërret", pasi përfaqësuesit e organizatës kryen fushatë sensibilizuese në rrjetet sociale, duke publikuar fotografi, video, e gjetje që ilustronin ndotjen e këtij baseni uhor. Një ndër elementët e promovimit ka qenë edhe zhvillimi e publikimi i intervistave me ekspertë të fushës, të cilët janë shprehur rreth shkaqeve të ndotjes dhe pasojat që ka për biodiversitetin e lumit dhe banorët e zonës. Kjo fushatë advokimi në rrjetet sociale ka ndikuar në ndërgjegjësimin e banorëve të zonës, si dhe institucioneve në nivel vendor e kombëtar, për të marrë masa konkrete për reduktimin e ndotjes në këtë basen uhor kaq të rëndësishëm për banorët e zonave rurale

Figura 35: Intervista me ekspertë mjedisi të zhvilluara nga North Green Association



Burimi: North Green Association



### 3.2.3 SUGJERIME

Zbatuesit e projektit kanë hartuar disa sugjerime që adresojnë problematikat e shkaktuara nga ndotja e lumit Erzen, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Shtirja e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale;
- Rritja e numrit të pikave të grumbullimit e koshave për mbledhjen e mbetjeve, kryesisht në zonat rurale;
- Kontrolli i vazhdueshëm i subjekteve që operojnë përgjatë rrjedhës së lumit në mënyrë që të identifikohen kundërvajtjet mjedisore;
- Menaxhimin më i mirë i ujërave të ndotura urbane;
- Marrja e masave administrative për subjektet që ndotin;
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për të shmangur depozitimin e mbetjeve urbane e inerte përgjatë rrjedhës së lumit;
- Kuadri legjislativ duhet të përmirësohet dhe të ndahen përgjegjësitë e institucioneve ligj-zbatuese për marrjen e masave dhe mirëmenaxhimin e burimeve ujore. Aktualisht, kuadri legjislativ nuk përcakton qartë institucionet për evidentimin, monitorimin dhe inspektimin e kundërvajtjeve.
- Planet për menaxhimin e burimeve ujore duhet të përfshijnë që në fazat e para të hartimit grupet e interesit, në mënyrë që të jetë një proces gjithëpërfshirës.
- Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotur urban si dhe përfshirja e zonave rurale në sistemin e kanalizimit të ujërave të ndotur urban;
- Aplikimi i parimit ndotësi paguan dhe i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

### 3.3 PROJEKTI: ACTIVE WATER

**Organizata zbatuese:** [H2H Foundation](#)

**Vendi i zbatimit:** Njësitë administrative Bërzhitë, Petrelë dhe Vaqarr, Bashkia Tiranë

#### 3.3.1 SFONDI/PREZANTIMI I ÇËSHTJES

Referuar "Strategjisë Kombëtare të Ujitjes dhe Kullimit 2019 – 2031" dhe planeve të veprimit, sistemet e ujitjes dhe kullimit janë përkeqësuar ndër vite, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes dhe riparimeve. Ndryshimet e nevojshme që po ndodhin në strukturën e kulturave bujqësore dhe metodat e përdorimit të ujit, si dhe ndryshimet klimatike, kërkojnë modernizimin e sistemeve për të rritur efikasitetin e përdorimit të ujit, menaxhim më intensiv dhe procedura financiare më të besueshme. Digat kanë rreth 45% të kapacitetit të projektuar për arsye të mbushjes me aluvione. Rritja e frekuencës dhe vendndodhjes së përmbytjeve kërkon ndryshime në infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytjet, sistemet e paralajmërimit dhe reagimit.

Aktualisht në Shqipëri, sipërfaqja që mund të ujitet vlerësohet në rreth 360,000 ha. Në vitin 2014, zona për ujitje shtrihej në një sipërfaqe prej 120,000 ha ose rreth 30% të sipërfaqes

potencialisht të ujitshme. Skemat ujitëse janë projektuar me një hidromodul 0.8 – 1.2 litër/sekondë/ha, me një normë të ujitjes 2,000 – 7,000 m<sup>3</sup>/ha. Megjithëse skemat me gravitet janë projektuar me efikasitet prej 70% (30% humbje), efikasiteti aktualë varion nga 30 – 60%. Gjatësia totale e kanaleve ujitëse është 25,000 km, nga të cilat 2,000 km kanale kryesorë, 6,200 km kanale sekondarë dhe 16,800 km kanale terciarë.

Një pjesë e kanaleve ujitëse, kryesisht për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ciklike nuk funksionojnë: nga 360,000 ha sipërfaqe potencialisht të ujitshme, kanë nevojë për rehabilitim të plotë rreth 140,000 ha ku nuk realizohet ujitja (përfshi dhe ujitjen me ngritje mekanike me stacione pompimi që zë rreth 60%), ndërsa në sipërfaqen tjetër prej rreth 225,000 ha, për të siguruar ujitje të qëndrueshme, nevojiten rehabilitime të pjesshme dhe mirëmbajtje vjetore. Vënia në punë e stacioneve mund të bëhet e mundur nëse do të subvencionohet kostoja e energjisë, të paktën në fazat e para. Kjo do të vinte në kushte të barabarta të gjithë fermerët që kanë nevojë për ujë për ujitje, pavarësisht skemës ujitëse me gravitet apo me stacion pompimi.

Menaxhimi i ujitjes përballet me një numër problematikash, të tilla si:

- Vështirësia që fermerët kanë për të punuar së bashku;
- Cilësia e ulët e shërbimit të ujitjes;
- Mirëmbajtje e pamjaftueshme e sistemit vaditës/kullues;
- Infrastrukturë ujitëse jo funksionale;
- Nivel i ulët i pagesës për tarifën e shërbimit të ujitjes (sipas një vlerësimi të Bankës Botërore më pak se 5% e vlerës bruto të prodhimit);
- Menaxhim financiar i dobët apo jo transparent;
- Pasiviteti i Organizatave të Përdoruesve të Ujit (OPU), monitorim i dobët i performancës menaxheriale;
- Nivel i ulët konsultimi apo i pranisë së ekspertëve në OPU, dhe nivel i pamjaftueshëm i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes nga OPU-të.

Veç këtyre, edhe ndryshimet e shpeshta në ekonomi, urbanizim dhe plakja e popullsisë rurale, kanë ndikuar në përkeqësimin e performancës të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke ndikuar edhe në zvogëlimin e sipërfaqes së ujitur. Ujitja përdor vetëm rreth 1 miliard m<sup>3</sup> ujë në vit. Për shkak se vetëm 20% e sasisë vjetore të reshjeve ndodhin në muajt e verës, ujitja është e paevitueshme. Kullimi dhe mbrojtja nga përmytjet bëhen të paevitueshme në muajt e tjerë të vitit, sidomos në periudhën fund vjeshte-fillim dimri dhe fund dimri-pranverë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe ish-bordet e kullimit nuk kanë pasur mundësinë të monitorojnë dhe të rrisin kapacitetet brenda OPU-ve. Kjo ka bërë të dukshme nevojën e ngritjes së një strukture në nivel të mesëm ndërmjet qeverisë qendrore dhe OPU-ve, e cila do të ketë përgjegjësinë për administrimin e kanaleve të dyta të skemave ujitëse të mëdha, kanalet kryesorë e dytësorë, si dhe veprat e marrjes për skemat e mesme të ujitjes. Në mënyrë që skemat ujitëse të jenë më produktive dhe të qëndrueshme, duhet që strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në varësi të MBZHR-së dhe bashkitë të punojnë së bashku në partneritet edhe me OPU-të si dhe të rrisin kapacitetet e tyre. Qeveria tashmë i ka kaluar këto funksione te 61 bashkitë, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe VKM nr. 1108, datë

30.12.2015 "Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe burimeve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve të kullimit". Në mbështetje të procesit të decentralizimit të përgjegjësive të ujitjes midis qeverisë qendrore dhe bashkive/OPU, është miratuar ligji nr. 24/2017 "Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit".

Në Shqipëri për ujitjen e kulturave bujqësore përdoren ujëra me prejardhje të ndryshme siç janë lumenjtë, përrenjtë, rezervuarët e ujitjes por edhe kanalet e kullimit. Këto burime janë të rëndësishëm për ujitjen si dhe arritjen e një rendimenti të kënaqshëm në kulturat bujqësore. Për ujitjen e tokave bujqësore nuk ndikon vetëm sasia e ujit të përdorur por dhe cilësia e tij. Uji për qëllim ujitje, qoftë i devijuar nga përrenj, lumenj apo i pompuar nga puset e napës freatike, përmban sasi të konsiderueshme substancash të dëmshme në tretësirë, të cilat mund të ulin rendimentin e të korrave dhe të përkeqësojnë pjellorinë e tokës. Karakteristikat kryesore për të vlerësuar cilësinë e ujit të ujitjes sipas FAO dhe Direktivës Kuadër të Ujit DKU (75/440/EEC) të BE-së janë: temperatura, pH, përçueshmëria elektrike (EC), lëndët totale të tretura (TDS), lënda totale pezull (TSS), turbullira, ngjyra, nevoja biokimike për oksigjen (NBO5/BOD5), kalcium, magnez, kalium, natrium, fortësia totale, kloruret, azoti total si jone nitrate (N/NO<sub>3</sub><sup>-</sup>), azot total si jone amoniakë (N/NH<sub>4</sub><sup>+</sup>), fosfori total si ortofosfate (P/PO<sub>4</sub><sup>-</sup>), koliforme totale, enterokoke intestinale, *escherichia coli*, kadmium, kobalt, plumb, bor, etj. Uji i një cilësie të mirë ka kapacitet potencial që të lejojë një rendiment maksimal të kulturave. Nga ana tjetër ujërat me cilësi jo të mirë, mund të jenë shkak i problemeve në tokë dhe bimë duke ndikuar në rendimentin e tyre. Kanalet ujitëse shpeshherë janë receptorë të ujërave të ndotur urbane dhe depozitimit të mbetjeve organike.

Referuar dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar, problemi më kritik aktual në lidhje me cilësinë e ujërave është ndotja e ujërave sipërfaqësore që shkaktohet nga shkarkimi i ujërave të mbetura të pa-trajtuar. Gjatë viteve të fundit janë hartuar politika për mirëmenaxhimin e burimeve ujore nëpërmjet vendosjes së një kuadri monitorimi dhe kontrolli, për të reduktuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga aktivitetet e veprimtarive industriale, bujqësore dhe aktiviteteteve të popullsisë në zonat rurale dhe urbane që shkaktojnë dëmtim të ekosistemeve ujore. Gjithashtu janë hartuar politika e janë parashikuar masa për monitorimin dhe mbrojtjen e lumenjve nga shfrytëzimi pa kriter, mbrojtjen e ujërave detare, menaxhimin e ujërave ndërkuftare si dhe zvogëlimin e efekteve nga përmbytja dhe thatësira.

Pavarësisht këtyre politikave të cilat janë hartuar për mbrojtjen e monitorimin e burimeve ujore, në programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2022 i zbatuar nga AKM, nuk është i përfshirë monitorimi i cilësisë së ujërave që përdoren për ujitje, duke neglizhuar kështu një aspekt tepër të rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien e banorëve të zonave rurale dhe sigurinë ushqimore.

### 3.3.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Projekti "Active Water" u zbatua nga H2H Foundation në Bërzhitë, Petrelë dhe Vaqarr e ka pasur si qëllim monitorimin e cilësisë së ujërave që përdoren për ujitje në tokat

bujqësore dhe nxitjen e diskutimit mes aktorëve, përdorues dhe menaxhuesve të burimeve ujore. Zona e studimit u përcaktua “Skema ujitëse Arbanë” për shkak të afërsisë me qytetin e Tiranës, potencialin e lartë që ka zona për zhvillimin e bujqësisë dhe për shkak se vepra e marrjes së ujit është në lumin Erzen , i cili ka një rëndësi jo vetëm për mjedisin por edhe mirëqenien socio-ekonomike të banorëve. Zona ka një përdorim bujqësor, rezidencial dhe industrial, në të dy krahët e lumit Erzen, i cili është burimi kryesor i ujit për skemën ujitëse të Arbanës.

Kjo zonë ofron potencial të lartë të zhvillimit të bujqësisë për shkak të terrenit të favorshëm, infrastrukturës rrugore dhe afërsinë me qytetin e Tiranës, tregu kryesor i produkteve bujqësore për qarkun e Tiranës. Në të njëjtën kohë, kjo zonë është nën presionin e urbanizimit me qëllim rezidencial, nga kërkesa e lartë vitet e fundit për shkak të afërsisë me tregun e punës në kryeqytet. Nga ana tjetër, zhvillimi i shpejtë urban i Tiranës ka rritur kërkesën për produkte bujqësore e cila ka sjellë një rritje të fermave të vogla dhe të mesme me qëllim zhvillimin e agro-turizmit si dhe kultivimin nëpërmjet serave apo të pemëtarisë. Në këtë mënyrë, fermerët instinktivisht reduktojnë sipërfaqen në rrezik nga zhvillim urban. Kjo skemë funksionimi e prodhimtarisë bujqësore në zonë, e fokusuar tek bujqësia intensive në sipërfaqe të limituara të tokës bujqësore, sjell edhe një përkujdesje më të madhe për lëndën e parë bujqësore, pasi cenimi i cilësisë apo sasisë së tyre sjell direkt ndikim në përfitueshmërinë e fermës.

Figura 36: Skema ujitëse Arbanë



Burimi: H2H Foundation

Ashtu dhe zona të tjera të tjera të Tiranës apo vendit, kjo zonë përballlet me probleme me ujitjen e tokave bujqësore të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë tek fermerët dhe prodhimi bujqësor, duke rritur pasiguritë e lidhura me proceset e mbjelljes së kulturave bujqësore. Fermerët në zonë përballen me sfida të cilat janë të lidhura me mungesën e mirëmbajtjes së infrastrukturës së kanaleve vaditëse e kulluese si dhe ndotjen e tyre nga veprimtaritë njerëzore. Zhvillimi i zonës dhe afërsia me Tiranën ka tërhequr edhe investime për zhvillimin e restorimit e rekreacionit (hotele, bare, restorante, pishina), biznese të cilat merren me përpunimin e vajit të ullirit e frutave, hapjen e tregjeve për tregtimin e kafshëve të cilat depozitojnë mbetjet dhe shkarkojnë ujërat e përdorur në mënyrë të pakontrolluar në skemën ujitëse të Arbanës, lumin Erzen apo tributarët e tij, duke ndikuar në ndotjen e ujërave të këtyre burimeve ujore.

Kjo situatë është krijuar për shkak të mungesës së zbatimit të masave për menaxhimin e mirë të mbetjeve të ujërave të ndotura urbane, si dhe zbatimit të kuadrit ligjor mjedisor.

Menaxhimi i qëndrueshëm dhe optimizimi i infrastrukturës vaditëse e kulluese ndikon në përmbushjen e nevojave për ujitje të tokave bujqësore, rrit cilësinë e ujërave duke ndikuar në një prodhimtari më të lartë të kulturave bujqësore, si dhe ndikon në reduktimin e rreziqeve të përmytjes së tokave bujqësore. Këto përmirësime kanë nevojë për financime në mënyrë të vazhdueshme për të mbuluar kostot fikse dhe variabël të menaxhimit të sistemit ujitës i cili do të ndikonte që degradimi i kanaleve dhe veprave të tjera të ulen në minimumin e mundshëm, duke rritur kështu sigurinë tek fermerët për investime të qëndrueshme e afatgjata.

Figura 37: Ndotja në kanal in ujitës të Arbanës



Burimi: H2H Foundation

Përdorimi i ujërave të ndotur për ujitjen e tokave bujqësore mund të shkaktojë pasoja si:

- Dëme në shëndetin e fermerëve të cilët merren me ujitjen e tokave bujqësore dhe tek konsumatori fundor nëpërmjet zinxhirit ushqimor;
- Ndotje e tokës;
- Rënie e produktivitetit të kulturave si rrjedhojë e grumbullimit në sasi të konsiderueshme të ndotësve të ndryshëm;

Gjatë zbatimit të projektit, përfaqësuesit e *H2H Foundation* kanë zhvilluar dy takime, në të cilat ishin prezent përfaqësues të MBZHR-së, bashkisë Tiranë, Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore të cilat kanë shërbyer për të ndarë gjetjet nga monitorimi i cilësisë së ujërave, rezultatet e analizave laboratorike, mendimet e komunitetit të zonës së marrë në studim dhe ofrimit të alternativave teknike për të përmirësuar situatën.


Përfaqësuesit e organizatës kanë zhvilluar leksione të hapura në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin Polis si dy institucione arsimore të cilat trajtojnë në kurikulat e tyre ndotjen mjedisore në disa nivele, me qëllim nxitjen e mendimit kritik e të bazuar në fakte lidhur me çështjet mjedisore. Studentë të UBT janë përfshirë edhe në mënyrë aktive në projekt duke asistuar zbatuesit e projektit gjatë marrjes së mostrave të ujit në pika të ndryshme kontrolli përgjatë skemës ujitëse.

Një element tepër i rëndësishëm i këtij projekti kanë qenë edhe takimet me banorët e fermerë të zonës të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me ndotjen e burimeve ujore, kryesisht lumin Erzen i cili është burimi kryesor i ujit për vaditje për tokat bujqësore të zonës. Banorët shprehën edhe shqetësimin lidhur me pasigurinë prej mungesës së një kalendarit të përcaktuar në të cilën fillon të funksionojë skema vaditëse e cila më pas ndikon sezonin e mbjelljes dhe ecurinë natyrale të rritjes së kulturave bujqësore.

Përtej takimeve me grupet e interesit, një ndër aktivitetet kryesore të projektit *Active Water* ka qenë edhe monitorimi i cilësisë së ujërave të skemës vaditëse, duke nisur që nga vera e marrjes së ujit në lumin Erzen, Nj.A. Bërzhitë duke ndjekur rrjedhën e tij deri në Nj.A Vaqarr. Monitorimi i cilësisë së ujërave është kryer në tre periudha të ndryshme, me qëllim evidentimin e periudhave në të cilat cilësia e ujit për vaditje është më e ulët, duke i krahasuar gjetjet me vlerat e paraqitura udhëzimet e FAO-s dhe Direktivës Kuadër të Ujit (75/440/EEC). Në përfundim të monitorimit të cilësisë së ujit të përdorur për vaditje, më poshtë renditen disa nga gjetje për komponentë kryesorë të cilësisë së ujit.

**Parametrat e makro-elementeve dhe të kriptomërisë së ujit** nuk përbëjnë rrezik për mos përdorimin e këtij uji për ujitje në këtë zonë. Nga rezultatet e analizave të kryera përgjatë muajve mars, qershor, korrik 2022, vihet re se të gjithë parametrat janë brenda normës së lejuar (E mirë > 3, E moderuar = 3, E keqe < 3).

Grafiku 8: Parametrat e makro-elementëve dhe të kripshmërisë së ujit




Burimi: H2H Foundation

### Parametrat e toksicitetit


Nga pikëpamja e parametrave të toksicitetit (ku përfshihen metalet e rënda si Bori, Kadmiumi, Plumbi, Magnezi) uji nuk përbën rrezik edhe në këtë gjendje të vlerësuar nga ana e këtij projekti për qëllim përdorimin për ujitje. Në grafikët e mëposhtëm vihet re se gjatë 3 kampionimeve të kryera nuk janë gjetur metale të rënda në të gjitha pikat e marrjes së mostrës.

Grafiku 9: Parametrat e toksicitetit, Bori mg/l



Burimi: H2H Foundation

Grafiku 10: Parametrat e toksicitetit, Kobalt Mg/l



Burimi: H2H Foundation

Gjatë analizave të kryera, janë analizuar 4 parametra toksiciteti si bori, kadium, kobalti dhe plumbi. Sikurse vihet re në grafikët e mësipërm, bori dhe kobalti nuk e kanë kaluar pragun e vlerave të lejuara. Për sa i përket metaleve të tjera të rënda (kadium dhe plumbi), gjatë 3 analizave të kryera ato nuk janë dedektuar. Cilësia e ujit në lumin e Erzen dhe përroi i Zhullimës ka dalë brenda parametrave dhe nuk përbën rrezik për përdorim për ujitje. Pra mund të themi që, me disa përjashtime, cilësia e ujit për ujitje plotëson kriteret e FAO në këto komponentë.


### Parametrat biologjikë

Gjatë diskutimeve me aktorët kryesorë është vënë re se në Shqipëri nuk ka një standard të miratuar specifik për ujitje për krahasimin e parametrave të ujit për ujitje dhe organizata i është referuar standardit të FAO (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi). Megjithatë, në standardet e FAO nuk ka referenca krahasuese për parametra biologjike ose bakteriologjikë, pasi në ujërat ujitës nuk duhet të ketë prezencë të këtyre organizmave - për këtë arsye u mor për bazë Direktiva Kuadër e Ujit.

Problemi kryesor i evidentuar vetëm në kanal kryesor ujitës qëndron në grupin e fundit të parametrave biologjike si nevoja biokimike për oksigjen, *Escherichia coli*, *total coliforms*, *Intestinal eterococci*, të cilat kanë dalë mbi normat e lejuar të përcaktuar nga Direktiva Kuadër e Ujit nga Bashkimi Evropian, si pasojë e shkarkimeve urbane të pamëshuar në këtë kanal.




Grafiku 11: Parametrat biologjikë, BOD Mg/L




Burimi: H2H Foundation

Grafiku 12: Parametrat biologjikë, E.coli CFU / 100 ML




Burimi: H2H Foundation

Grafiku 13: Parametrat biologjikë, Koliforet totale CFU/100 ML



Burimi: H2H Foundation

Grafiku 14: Parametrat biologjikë, Intestinal enterococci, Cfu/100 ml



Burimi: H2H Foundation

Ndotja nga patogjenët e vlerësuar nëpërmjet zinxhirit ushqimor rrit shkallën e sëmundjeve tek popullsia (që konsumon produktet e vaditura me këtë ujë), por dhe në sektorin e blegtorisë dhe mbarështimit të peshkut, duke kërcënuar shëndetin e kafshëve. Ky ujë ndot edhe lumin Erzen në rrjedhjen e mëposhtme nëpërmjet kullimit, duke rrezikuar jetën e peshkut apo gjallesave ujore.

Figura 38: Ndotja e lumit



Burimi: H2H Foundation

Projekti ka evidentuar probleme në lidhje me ujitjen e tokave bujqësore dhe cilësinë e ujit që përdoret për ujitje dhe propozon masa për përmirësimin e situatës, në mënyrë që tokat bujqësore të kenë një ujitje sa më të mirë. Këto masa synojnë të rrisin cilësinë e tokës dhe produktivitetin e saj, duke sjellë fitime dhe qëndrueshmëri jo vetëm për fermerët dhe konsumatorët por edhe për mbrojtjen e mjedisit dhe ekosistemeve ujore. Duke qenë se kjo është një temë me ndikim të gjerë në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, që nuk është trajtuar më parë nga institucionet apo organizatat e shoqërisë civile, lind nevoja për të monitoruar cilësinë e ujit për ujitje në tokat bujqësore, por dhe si burim pije për blegtorinë.

### 3.3.3 SUGJERIME

Aktorët e përfshirë në zinxhirin e ndotjes së ujit janë të shumtë dhe masat dhe sugjerimet që duhen ndërmarrë janë si më poshtë:

#### **Banorët/Bizneset**

- Ndalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe të ndotura në kanalet vaditëse;
- Ndalimi i hedhjes së mbeturinave urbane, organike dhe industriale në kanalet vaditëse;
- Trajtimi i ujërave të ndotura nga bizneset dhe përdorimi i gropave septike nga banorët.

### Institucionet lokale dhe qendrore

- Ndërmarrja e fushatave të sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit në nivel lokal dhe kombëtar për ndikimin që ka ndotja e ujërave ujitës në shëndetin e njeriut dhe në sistemet ujore dhe natyrore;
- Ngritja e një programi të vlerësimit periodik të cilësisë së ujërave që përdoren për ujitje;
- Përfshirja e monitorimit të cilësisë së ujërave që përdoren për ujitje në programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitet në vijim;
- Nxitja e përdorimit të gropave septike nga banorët dhe bizneset nëpërmjet mbështetjes financiare dhe lehtësimit të procedurave për marrjen e lejes përkatëse;
- Minimizimi i rrezikut të përditshëm për konsumatorët dhe potencialit të epidemive, nëpërmjet ndërgjegjësimit për larjen dhe higjienën e duhur të perimeve;
- Krijimi i një standardi për vlerësimin e cilësisë së ujërave që përdoren për ujitje dhe për minimizimin e rrezikut ndaj patogjenëve.

### Fermerët

- Përdorimi me kujdes i plehrave kimik dhe organike, në sasinë e duhur, kohën e duhur dhe metodën e duhur;
- Përdorimi i metodave më praktike dhe moderne për ujitjen e tokave bujqësore;
- Riciklimi dhe përdorimi i ujërave të trajtuar për ujitjen e tokave.

### Donatorët

- Rritja e fondeve nga donatorët për të mbështetur higjienën e duhur dhe për të prezantuar modelet e aplikuara për ndarjen e kostos për trajtimin e ujërave të ndotur.

## 3.4 PROJEKTI: "TRAJTIMI I INTEGRUAR I UJËRAVE TË PËRDORUR PREJ KOMPANIVE TURISTIKE, NË DOBI TË MJEDISIT DHE TURIZMIT, NË PLAZHIN SPILLE, RROGOZHINË"

**Organizata zbatuese:** [Shoqata "Vlerësim Mjedisit, Energji, Natyre" – MENV group](#)

**Vendi i zbatimit:** Bashkia Rrogozhinë, Plazhi Spille

### 3.4.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES

Zhvillimi i industrisë së turizmit përbën një hap konkret drejt zhvillimit socio-ekonomik rajonal, për shkak se gjeneron të ardhura të larta, kontribuon në zgjerimin e tregut të punës dhe në parandalimin e varfërisë dhe pabarazive sociale.

Zhvillimi i aktiviteteve turistike paraqitet si një mundësi e mirë për zhvillimin socio-ekonomik të zonës së Spillesë, një qendër lokale me potencial të lartë të zhvillimit turistik, e favorizuar nga pozita gjeografike dhe vija e gjerë bregdetare. Zona paraqet flukse të larta turistësh në sezonin veror, për shkak edhe të afërsisë me qendrat urbane të vendit.

Figura 39: Vija bregdetare, Spille



Burimi: Studio Caush Xeka

Tipologjitë hapësinore kryesore të pranishme në zonë, janë strukturat individuale (vila të grupuara) dhe hotele me standarde mesatare, të cilat po zhvillohen në vitet e fundit pas pyllit të pishave. Zona kryesisht ka ndërtime të reja pas vitit 2000, në gjendje të mirë strukturore. Më së shumti këto ndërtime janë hotele dhe shtëpi të cilat lëshohen me qera për sezonin e verës ku disa prej tyre përveç qëndrimit ofrojnë dhe shërbimet të tjera rekreacionale e pushuese. Strukturat kanë një pamje standarde arkitektonike ku gjenden në dy forma, të grupuara (1 deri në 2 kate) ose individuale (hotele 4 kate). Shërbimet e nevojshme publike në plazhin e Spilles nuk ofrojnë standard të lartë turistik për të krijuar një lokalitet konkurrues në rajon, prej probleme mjedisore të cilat paraqiten më poshtë.

- Ujërat e ndotura urbane janë të pa-menaxhuara e pjesërisht shkarkohen në kanalet vaditëse të cilat më pas derdhen në det;
- Gropa septike individuale pa standard, pa shtresë izoluese dhe pa veshje me beton;
- Mungesa e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza;
- Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë sh.a. nuk disponon harta të rjetit të kanalizimeve dhe ka mungesë totale të informacionit;
- Shkarkimi i ujërave të ndotur urban kryesisht nga njësitë individuale të banimit në fshatin Spille dhe Greth, bizneset kryesisht kanë gropa septike të cilat mirëmbahen;
- Shkarkimi i ujërave të ndotura urbane në kanalet e hapura vaditëse shkakton problematika për promovimin e turizmit për shkak të pamjes dhe erës jo të këndshme, kryesisht përgjatë muajit korrik dhe gusht, që përkon dhe me rritjen e numrit të turistëve.

Figura 40: Pamje e kanalit vaditës i ndotur nga shkarkimet e ujërave të zeza të fshatit Spille



Burimi: Menv Group

Nga faktorët kryesorë të ndotjes së ujërave bregdetarë, mbeten shkarkimet e ujërave urbane të pa-trajtuara në trupat ujqorë pritëse në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo.. Funkionimi i sistemeve të kanalizimeve të shkarkimeve urbane dhe përmirësimi i infrastrukturës të impianteve të trajtimit të ujërave urbane janë tregues të reagimit.<sup>28</sup>

### 3.4.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Projekti ka pasur si qëllim rritjen e njohurive të stafit të qeverisjes vendore dhe operatorëve të komplekseve turistike për trajtimin e ujërave të përdorura me metodën e lagunazhit natyror, e cila ka kosto të përmbajtura dhe ofron zgjidhje afatgjata.

Projekti ndër të tjera kërkon të promovojë përdorimin e teknologjive natyrore ose ato që njihen si zgjidhje të bazuara në natyrë (*Nature Based Solutions*) për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, duke u fokusuar në praktikën e lagunazhit me qëllim filtrimin natyror të këtyre ujërave të ndotur. Duke parë karakteristikat e zonës së Spillesë, kjo zgjidhje adreson një problematikë që shqetëson banorët e bizneset, e është miqësore me mjedisin.

Praktikat e lagunazhit natyror janë gjerësisht të përdorura në vendet e BE dhe BP dhe gjejnë zbatim në zonat rurale (siç është edhe zona e Spillesë), duke qenë se kosto e ndërtimit të infrastrukturës për grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotur urbanë është

28. Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2021, Agjencia Kombëtare e Mjedisit

relativisht e lartë. Më poshtë paraqiten shembuj të lagunazhit natyror në Republikën e Francës dhe Maqedonisë së Veriut.

Figura 41: Lagunazhi Natyror në Francë dhe Maqedoninë e Veriut



Burimi: Menv Group

Teknologjitë natyrore të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, përdorin trajtim natyror me proceset të zakonshme që ndodhin në tokë, ujë dhe mjedisin ligatinor. Bimësia është e përfshirë drejtpërdrejtë në procesin e trajtimit, veçanërisht nga formimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e mikroorganizmave të përfshirë në procesin e trajtimit të lëndës së ujërave të ndotur, e cila më pas shërben si lëndë ushqyese për bimët e përdorura në lagunazh duke bërë në këtë mënyrë edhe filtrimin e ujit.

### **Ndikimi i shkarkimeve të lëngëta urbane në zonat bregdetare.**

Fshati turistik i Spillesë është rreth 1 orë nga qyteti i Tiranës e rreth 30 minuta nga qyteti i Kavajës e i Rogozhinës, si një destinacion mjaft i qasshëm e tërheqës për turistët vendas e të huaj të cilët vizitojnë vendin. Plazhi i Spillesë ofron kushte shumë të mira për turistët pasi mundëson kombinimin e një plazhi me rërë të bardhë e pyllit të dendur me pisha pas vijës bregdetare, duke i mundësuar atyre ambiente të freskëta gjatë ditëve të nxehta, të cilat ndikohen nga shkarkimi i ujërave të ndotur në kanalën kullues drejt detit. Ky fenomen është kthyer në një shqetësim konstant për banorët e zonës dhe pushuesit.<sup>29</sup>

<sup>29</sup> Nëntor 2020/ Eljona Ballhysa/ Porta Vendore/ Rogozhinë

Figura 42: Pamje e kanalit kullues i cili derdhet në detin Adiatrik



*Burimi: Menv Group*

Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit, operatorëve turistikë në zonë dhe stafit të bashkisë Rogozhinë, përfaqësuesit e organizatës kanë zhvilluar një seri takimesh e trajnimesh me këto grupe interesi të cilat kanë shërbyer për të marrë mendimet e tyre lidhur me problematikën e trajtimit të ujërave të ndotur si dhe për të ilustruar metodën e lagunazhit natyror e cila është një zgjidhje e qëndrueshme dhe e bazuar në natyrë. Gjatë takimeve, grupet e interesit evidentuan se kjo ishte një praktikë më të cilën nuk ishin njohur më parë dhe se ishin në favor të aplikimit të saj në zonë, duke u bazuar edhe tek kostot e investimit. Ndër të tjera, disa prej operatorëve turistikë u shprehën se do të ishin të gatshëm për të kontribuar për zgjidhjen e kësaj problematike shqetësuese.

Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar 11 takime/trajnime me grupet e interesit duke përfshirë 165 persona, pjesa më e madhe e të cilëve ishin përfaqësues të operatorëve turistik.



Figura 43: Foto nga takimet me grupet e interesit, Bashkia Rrogozhinë




*Burimi: Menv Group*

*Menv Group* hartoi një raport i cili paraqet në mënyrë të strukturuar metodologjinë dhe mundësitë për aplikimin e lagunazhit natyror në zonën e Spillesë, si dhe praktika të mira nga vende të BE dhe BP të cilat paraqiten shkurtimisht edhe në vijim.

Lagunazhet natyrore janë sisteme të projektuara për të përmirësuar proceset që gjenden në mjediset natyrore ndaj dhe konsiderohen miqësore me mjedisin dhe të qëndrueshme për trajtimin e ujërave të ndotur urban. Krahasuar me teknologjitë e tjera të trajtimit të ujërave të ndotur urban, lagunazhet e trajtimit kanë kërkesa të ulëta për funksionim dhe mirëmbajtje (F&M) dhe performanca është më pak e ndjeshme ndaj variacioneve të hyrjes. Lagunazhet e trajtimit mund trajtojnë në mënyrë efektive ujërat e zeza të papërpunuara, parësore, dytësore ose terciare dhe shumë lloje të ujërave të zeza bujqësore dhe industriale.

Lagunazhet e trajtimit në varësi të drejtimit të rrjedhës së ujit, ndahen në modelin me rrjedhje sipërfaqësore (RS Figura 43. A) dhe me rrjedhje vertikale (RV Figura 43. B). Dhe përdoren për trajtimin dytësor të ujërave të zeza.

Figura 44 a) Lagunazh me rrjedhje sipërfaqësore (RS)      b) Lagunazh me rrjedhje vertikale (RV)



Burimi: Menv Group

Metoda ekologjike e trajtimit të ujërave të zeza është evidentuar krahasuar me raste të ngjashme për praktikatat më të mira europiane për përfitim të njohurive në fushën e trajtimit të ujërave të ndotura nga modelet e realizuar në rajonin e Ballkanit dhe të Europës, për nxitje dhe realizim me kompanitë e komplekseve turistike, për të bërë të mundur trajtimin e ujërave të përdorura në hotelëritë përkatëse, para se ato të derdhen në det, duke ngritur një sistem lagunazhi natyror, me kosto minimale dhe zgjidhje afatgjatë.


### Lagunazhe artificiale për trajnimin e ujërave të zeza

Çdo proces i pastrimit të ujit kërkon të zvogëlojë nivelin e ndotësve të pranishëm në ujë me anë të agjentëve biologjikë. Proces i ndodh në mënyrë spontane në të gjitha sistemet hidro-natyrale dhe garanton kapacitetin e tyre "vetë-pastrues". Sistemet e pastrimit të ujit natyral të lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza shfrytëzojnë një proces që ndodh në mënyrë spontane në natyrë të optimizuar për të siguruar nivele më të larta pastrimi.

Aplikimi i sistemeve natyrale merr parasysh zgjidhjen e problemeve higjieno-sanitare të mbeturinave, ndërkohë që bën më të lirë përdorimin e ujit. Ka shumë tipe të sistemeve të lagunave artificiale (për vlerësim mjedisi, energji, natyrë e për trajtimin e ujërave të zeza), por ato që janë më gjerësisht të aplikuara në kontekstin europian janë si më poshtë:

- Sisteme rrjedhëse nën sipërfaqësore horizontale (SRrNS-H)
- Sisteme rrjedhëse nën sipërfaqësore vertikale (SRrNS-V)
- Sisteme rrjedhëse sipërfaqësore (SRrS)

Figura 45: Pamje të një impianti natyral lagunor me pjesët përbërëse të tij



Burimi: MENV Group

### Proceset në sistemin e lagunazhit natyror

Sistemet e lagunazheve natyrore (të quajtura edhe pellgje stabilizimi) janë sisteme lagunash në të cilat dy popullata mikroorganizmash shumohen të ndërvarura, përkatësisht: bakteret aerobike dhe algat planktonike (quhen "mikrofite"). Oksigjeni i nevojshëm për zhvillim dhe mbajtjen e biomasës së baktereve aerobe prodhohet natyrshëm nëpërmjet fotosintezës nga biomasa e algave që zhvillohet në shtresën e ujit nga laguna në afërsi të sipërfaqes së lirë (pasqyrës) të ujit, e cila është e ekspozuar ndaj rrezatimit diellor (dritës). Ky proces biologjik zhvillohet duke marrë energji diellore dhe lëndë organike përmes rrjedhës së ujërave të zeza.

Në praktikë, konfigurimi i sistemit të lagunës natyrore që haset më shpesh është ai me 3 pellgje. Në këto sisteme, rolet e secilit prej pellgjeve janë të ndryshme:

- Pellgu I ofron reduktim të ndjeshëm të ngarkesës organike të ujërave të zeza;
- Pellgu II siguron heqjen e azotit dhe fosforit (lëndëve ushqyese);
- Pellgu III përpunon ujërat e zeza në rast të dështimeve të ndodhura në dy pellgjet e para dhe e bën sistemin të sigurt.

### 3.4.3 SUGJERIME

Bazuar nga vizitat dhe materialet e grumbulluara në zonën e realizimit të projektit, në mbështetje të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm si dhe për parandalimin e ndotjes bregdetare është e nevojshme marrja e masave nga ana e institucioneve vendore e qendrore. Disa sugjerime lidhur me masat që mund të merren për adresimin e situatës paraqiten si më poshtë:

- Ndalimi i shkarkimeve të ujërave të ndotur urban nga njësitë e banimit dhe ato turistike;
- Marrja në konsideratë e trajtimit të ujërave të ndotur urban nëpërmjet metodës së lagunazhit natyror;
- Promovimi i praktikave të kompostimit si një alternativë e qëndrueshme e trajtimit të mbetjeve të bio-degradueshme.
- Rritja e standardit të ndërtimit të gropave septike me qëllim uljen e ndikimit mjedisor;
- Monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësor me qëllim vlerësimin e ndotjes së tyre;
- Monitorimi i cilësisë së ujërave për ujitje me qëllim vlerësimin e ndotjes së tyre;
- Hartëzimi e dixhitalizimi i infrastrukturës së kanaleve vaditëse e kulluese në zonën e Spillesë;
- Vlerësimi teknik i gjendjes së kanaleve vaditëse e kulluese me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit si dhe reduktimin e përmytjeve;
- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese me komunitetin e zonës për të shmangur shkarkimin e ujërave të ndotur urban në kanalet vaditëse e kulluese;
- Marrja e masave ndëshkuese për subjektet të cilat nuk respektojnë standardet mjedisore.

### 3.5 PROJEKTI: TIRANA JUNGLE CITY

**Organizata zbatuese:** [EDS Foundation](#)

**Vendi i zbatimit:** Bashkia Tiranë

#### 3.5.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES

Krahas zhvillimit të teknologjisë, shoqëria ka nevojë gjithnjë e më tepër nevojë për natyrën dhe ato çka ajo na ofron. Prania e saj në jetën e njeriut modern është relativisht e ulët. Për të përforcuar lidhjen e njeriut me natyrën vinë në ndihmë mekanizma ose iniciativa me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka natyra dhe ruajtja e mjedisit, si dhe rëndësinë që ka kontributi i gjithsecilit në zhvillimin e një qyteti të qëndrueshëm e miqësor ndaj mjedisit. Me fokus kryesor në këtë qëllim, projekti "Tirana Jungle City" konsistoi në ndërmarrjen e një iniciative në shkollat 9-vjecare të Tiranës. Kjo iniciativë kishte për bazë edukimin e fëmijëve të klasave të para konkretisht të shkollave "Fan Noli" dhe "Skënder Çaçi" në Tiranë, mbi kopshtarinë, produktet dhe të mirat e saj përmes veprimtarive për mbjelljen, rritjen dhe mësimit rreth bimëve të ndryshme dekorative ose për konsum.

Situata aktuale në Tiranë dhe hapësirat e gjelbra ka bërë progres deri në vitin 2018. Sipas të dhënave të bashkisë Tiranë, aktivitetet kryesore kanë qenë mbjellja e fidanëve në zona të ndryshme të qytetit apo shkollave, por asnjëherë nuk është prekur dhe zhvilluar problematika e ndërgjegjësimit mjedisor në mënyrë më efektive.

Arsyetja pse janë përzgjedhur shkollat 9-vjecare dhe sidomos nxënësit e klasave të para, është sepse kjo grup-moshë ndryshe nga kopshtet apo parashkolloret, hyjnë më thellë në lëndët edukative dhe shkencore të cilat lidhen me mjedisin dhe çdo gjë që e rrethon atë. Ndërgjegjësimi mjedisor është fillesa e një shoqërie të shëndetshme e cila ndryshon një kulturë të tërë të keqformuar dhe jo miqësore me natyrën. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna të cilat tregojnë nivelin e ndotjes për disa parametra në qytetin e Tiranës ndër vite.

Tabela 10. Niveli i ndotjes ne Tiranë përgjatë viteve

Niveli i ndotjes në Tiranë përgjatë viteve									
Treguesi	Njësia matëse	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
SO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	6.3		15.52	10.46	13.66	62.49		25.68
NO <sub>2</sub>	µg/m <sup>3</sup>	23.83	27.3	35.01	42.38	47.63	49.32		37.85
O <sub>3</sub>	µg/m <sup>3</sup>	55.79	51.03	32.64	33.34	22.33	9.94		31.7
PM <sub>10</sub>	µg/m <sup>3</sup>	35.44	32.56	54.06	57.34	52.05	26.22		

PM2.5	µg/m <sup>3</sup>	19.24	16.45						
CO	µg/m <sup>3</sup>	0.43		0.85	0.87	0.8	2.56		0.48
Benzen	µg/m <sup>3</sup>	3.95		2.76	2.9	2.7	1.83		

*Burimi: Bashkia Tiranë*

Zhvillimi i shpejtë urban padyshim është rivali më i madh i natyrës dhe na nevojitet që këtë problematikë ta sfidojmë në radhë të parë me ndërgjegjësimin e qytetarëve, një fakt ky që do të ndihmojë në vazhdimësi në uljen sa më të shpejtë të ndotjes dhe jo vetëm.

Në rang plani/programi kombëtar, TJS merr shkas edhe nga ideja e projekt-ligjit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për kthimin e shkollave në qendra komunitare në çdo kohë të vitit. Duke zbatuar projektin "TJC" në 2 shkolla të përzgjedhura, iniciativë që kërkon përkujdesje gjatë gjithë vitit, bëhemi kështu pjesë e një metodologjie për aplikimin e një pjese të vogël të projekt-ligjit duke kërkuar angazhimin dhe vëmendjen e të vegjëlve në çdo stinë (duke qenë se bimët kanë nevojë për kujdes gjatë gjithë vitit).

### 3.5.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Projekti "*Tirana Jungle City*", kishte për qëllim të ndihmonte qytetin e Tiranës të bëhet i qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore, si dhe të përshpejtojë kalimin nga tranzicioni urbanistik drejt një qyteti të pastër, të shëndetshëm dhe aktiv. Pra, të kthejmë gjelbërimin në një pjesë të rëndësishme të strukturës së qytetit. Mënyra më e drejtpërdrejtë dhe më e shpejtë për t'i arritur këto objektiva, është përfshirja e fëmijëve në shkolla, në aktivitetet mjedisore dhe jo vetëm.

Ambientet e gjelbra në shkolla deri më sot kanë luajtur një rol figurativ, pra janë të vendosura vetëm si fasadë e bukur për tu parë. E rëndësishme është ndërveprimi që ne kemi me natyrën, me gjelbërimin. Ende sot nuk e kemi te qarte rëndësinë e sipërfaqeve të gjelbra sidomos në qytete urbane apo metropole të cilat ndikojnë në shumë aspekte dhe sidomos në ambientet e shkollave.

Çështjet mjedisore të cilat duhet të trajtohen janë të shumta dhe të profileve të ndryshme në Shqipëri. Problematika që synonte të ngrinte TJC, njëkohësisht edhe për të hapur rrugën për hartimin e zgjidhjeve të saj, është mungesa e konceptit të kopshtarisë dhe benefiteve të saj në moshat 6-7 vjeç (pra në klasat e para).

Më konkretisht, iniciativa u zbatua si një program modest i cili ndërthuri edukimin dhe praktikën e kopshtarisë në klasat e para, e cila filloj me disa prezantime njohëse me mësuesit, më pas me nxënësit dhe u finalizua me krijimin e një hapësire të gjelbër të mbjellë nga të vegjlit në oborret e shkollave.

Figura 46: Prezantime me nxënësit e klasave të para



Burimi: EDS Foundation

Kopshtet në shkolla kanë potencial të pashfrytëzuar për të përdorur oborrin e shkollës si një klasë, për të lidhur përsëri fëmijët me botën natyrore dhe burimin e vërtetë të ushqimit të tyre dhe për t'u mësuar atyre koncepte dhe aftësi të vlefshme për kopshtarinë dhe bujqësinë që integrohen me disa lëndë, të tilla si biologjia, shkenca, arti, edukimi shëndetësor dhe fizik, studimet shoqërore, si dhe disa qëllime edukative, duke përfshirë përgjegjësinë personale dhe shoqërore. Krijimi i një sipërfaqe të vogël parcelash brenda oborrit të shkollave krijon një mundësi të shkëlqyer për të ndryshuar jo vetëm habitatin e saj por edhe fillimin e një edukimi mjedisor praktik.

Figura 47: Krijimi i një hapësire të gjelbër të mbjellë nga nxënësit



Burimi: EDS Foundation

Gjatë zbatimit të këtij projekti janë zhvilluar disa orë edukative me nxënësit e mësuesit e dy shkollave fillore të përfshira në projekt (me në total 156 persona). Materiale e gjeneruara në këtë projekt si udhëzues për mbjelljen e bimëve si dhe materialet e nevojshme për kryerjen e mbjelljeve iu dorëzuan shkollave dhe stafeve të tyre. Një element i cili do të lejojë vijimësinë dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të kësaj nisme është përfshirja e mësuesve që në hapat e parë të procesit të cilët mund ta çojnë përpara këtë nismë edhe në vitet pasardhëse duke krijuar kështu kulturën për vlerat që sjell gjelbërimi në tërësi por kryesisht ai në zonat urbane.



### 3.5.3 SUGJERIME

- **Mirëmbajtja e këtyre hapësirave pas përfundimit të projektit;**

Pas realizimit të projektit, shkollave iu dorëzua baza materiale e blerë për realizimin e projektit. Gjithashtu, vazot e drurit u parashikuan dhe u ndërtuan qëllimisht të lëvizshme, në mënyrë të tillë që të mos pengojnë qarkullimin e njerëzve dhe automjeteve.

- **Shtirja e kësaj metodologjie në të gjithë shkollat e Tiranës e më tej në të gjithë rajonin;**

Gjatë proceseve të konsultimeve e takimeve me palë interesi, si pjesëmarrës nga Bashkia Tiranë, përfaqësues të shkollave private kanë shprehur interesin e tyre që kjo praktikë të zbatohet dhe në shkolla të tjera në vazhdim.

- **Përfshirja e orëve mjedisore në kurikulat mësimore të shoqëruara me praktika konkrete;**
- **Shtimi i hapësirave të gjelbra në perimetrin e shkollave dhe angazhim i nxënësve në mirëmbajtjen e tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe kujdesin ndaj natyrës.**

### 3.6 PROJEKTI: EKONOMI QARKULLUESE NËPËRMJET KOMPOSTIMIT TË MBETJEVE ORGANIKE NË BALDUSHK

**Organizata zbatuese:** [Instituti i Politikave Mjedisore](#)

**Vendi i zbatimit:** Njësia Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë

#### 3.6.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES

Menaxhimi i mbetjeve është një problematikë e cila shoqëron vendin tonë tanimë prej disa vitesh. Kjo dëshmohet në faktin që ky sektor është shpallur ndër sektorët me përparësi nga Qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet miratimit të dy dokumenteve strategjike në vitin 2020, që drejtojnë hartimin e politikave të këtij sektori për vitet e ardhshme, "Dokumenti i Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020 – 2035"<sup>30</sup> (dokumenti i politikave strategjike) dhe "Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta"<sup>31</sup> (plani sektorial).

Pavarësisht disa masave drejt përmirësimit të ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, ka ende problematika lidhur me mirëmenaxhimin e tyre, sidomos në zona Rurale, kjo për shkak edhe të mbulimit jo të mirë të territorit me shërbim, si dhe mungesës së kontrollit nga ana e autoriteteve vendore.

<sup>30</sup> Miratuar me VKM Nr. 418, datë 27.05.2020

<sup>31</sup> Miratuar nga Këshilli Kombëtar Territorial me Vendim Nr. 1 datë 13.01.2020

Qarku i Tiranës referuar të dhënave të INSTAT,<sup>32</sup> është ai i cili menaxhon sasinë më të madhe të mbetjeve (rreth 98.5% të totalit). Megjithatë, situata në terren pasqyron një realitet disi ndryshe nga shifrat zyrtare, pasi shpesh herë vihen re grumbuj mbetjesh të pamenaxhuara në krah të rrugëve rurale, apo lumenj në territorin e bashkisë.

Përpos mbetjeve urbane, mbetjet e zonave rurale përbëjnë një problematikë të shtuar, prej mbetjeve të ngurta e të gjelbra të prodhuara nga aktiviteti bujqësor.

Praktikat për reduktimin e sasisë së mbetjeve janë të pakta dhe hierarkia e menaxhimit të mbetjeve nuk aplikohet në asnjë bashki të vendit. Kompostimi, një praktikë që bart potencial të pashfrytëzuar për të reduktuar sasinë e mbetjeve organike në zonat rurale, praktikohet në mënyrë sporadike nga banorët, që nuk arrijnë të reduktojnë në mënyrë të qenësishme sasinë e kësaj tipologjie mbetjesh.

Aplikimi i kompostimit do të ndikonte në reduktimin e sasisë totale të mbetjeve të cilat depozitohen në landfille, vend-depozitime apo të pakontrolluara në mjedis, e do të kishte vlera ekonomike — humusi i krijuar nga ky proces mund të përdoret si pleh organik. Nga ana tjetër, ky proces do të kishte edhe vlera mjedisore, pasi gazi metan i cili krijohet nga dekompozimi i mbetjeve është 80 herë më i rrezikshëm për krizën klimatike sesa emetimet e dioksidit të karbonit.

### 3.6.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Njësia Administrative Baldushk është një nga zonat kryesore bujqësore në bashkinë e Tiranës, ku pjesa më e madhe e banorëve merren me bujqësi dhe është i zhvilluar sektori i agro-turizmit. Baldushku ka rreth 5,300 banorë dhe ka mbulim të pjesshëm nga shërbimet e grumbullimit të mbetjeve — pjesa e mbetur praktikon djegien apo depozitim të pakontrolluar të mbetjeve përgjatë lumenjve e rrëpirave. Mesatarisht, një banor i Baldushkut krijon 0,5 kg mbetje/ditë, ku më shumë se 60% janë mbetje organike. Këtu nuk futen mbetjet organike të prodhuara nga bujqësia, sasia e të cilave është e konsiderueshme.

Pjesa më e madhe e mbetjeve organike të dala nga procesi bujqësor, zakonisht digjen, hidhen në rrëpira, kanale, e lumenj, ose hidhen (jo gjithmonë) në koshat e pikat e grumbullimit të vendosura nga bashkia. Kjo shkakton ndotje të ajrit nga djegia e mbetjeve organike, ndotje të lumenjve dhe deteve (e rrjedhimisht rritjen e algave të dëmshme në det, si pasojë e dekompozimit të mbetjeve organike), mbushje të koshave të mbeturinave me mbetje organike, duke rritur kostot e transportit dhe duke shkaktuar prodhim të gazit metan në vend depozitimit të Sharrës (si pasojë e dekompozimit anaerobik). Përveç pasojave tepër të dëmshme për mjedisin dhe klimën, kemi dhe humbje të pjellorisë së tokës si pasojë e moskthimit të lëndës organike në ara. Banorët e Baldushkut aktualisht nuk aplikojnë kompostimin e mbetjeve organike dhe nuk kanë

<sup>32</sup> Vjetari Rajonal Statistikor 2022

njohuri rreth kryerjes së procesit të përshtatshëm të kompostimit. Si pasojë, kemi dhe humbje ekonomike për bujqit e zonës, të cilët zakonisht blejnë plehra kimikë për të plehëruar të mbjellat.

Ky projekt synoi të adresojë potencialin e praktikave të kompostimit dhe të risë ndërgjegjësimin e komunitetit të zonës së Baldushkut nëpërmjet aktiviteteve teorike dhe praktike.

Faza e parë e zbatimit të projektit përbëhej nga vizita në terren në zonën e Baldushkut, për të kuptuar më mirë situatën e menaxhimit të mbetjeve në këtë njësi administrative si dhe për të evidentuar familje potenciale të cilat do të dëshironin të përfshiheshin në mënyrë aktive në projekt. Paralelisht me këtë proces, filloi puna për hartimin e një udhëzuesi për mënyrën e kompostimit, i cili do t'u jepej fermerëve të zonës si dhe atyre që do të bëheshin pjesë e projektit një dokument praktik i cili ilustron hapat e procesit të kompostimit hap pas hapi si dhe teknikat e nevojshme për të përftuar një humus me cilësi të mirë.

Figura 48: Foto nga depozitimi i mbetjeve në Nj.A. Baldushk



Burimi: Instituti i Politikave Mjedisore

Pas hartimit të udhëzuesit përfaqësuesit e organizatës organizuan një seri aktivitete të advokuese e trajnuese me banorë të zonës që ilustronin të mirat e procesit të kompostimit të mbetjeve organike urbane dhe atyre të kopshteve të gjelbra, dhe mënyrën e zbatimit në oborret e banesave të tyre.

Në këtë drejtim, u zhvilluan 3 trajnime në të cilën morën pjesë rreth 40 banorë - gjatë këtyre trajnimeve, u dëshmuar interes i shtuar nga disa prej banorëve për t'i zbatuar këto praktika të qëndrueshme e miqësore me mjedisin në mënyrë të vazhdueshme.

Figura 49: Foto nga trajnimi i fermerëve në Nj.A-në Baldushk



Burimi: Instituti i Politikave Mjedisore

Me përzgjedhjen e familjeve fermere që do të bëheshin pjesë aktive e projektit, filloi dhe shpërndarja e 31 kontejnerëve të kompostimit të cilët do t'i shërbejnë banorëve për të kryer procesin e kompostimit të mbetjeve organike në mënyrë të kontrolluar në oborret e shtëpive të tyre.

Figura 50: Foto nga shpërndarja e kontejnerëve të kompostimit në Baldushk



Burimi: Instituti i Politikave Mjedisore

Aktivitetet e më vonshme u fokusuan kryesisht në monitorimin dhe asistimin e fermerëve, për t'u siguruar integritetin e procesit të kompostimit dhe angazhimin e të gjitha familjeve

të përfshira në projekt. Procesi i kompostimit kërkon balancën e duhur të ushqyesve ndërmjet mbetjeve me përmbajtje karboni (bari i thatë, gjethe apo degë të thata) dhe mbetjeve me përmbajtje azoti (mbetjet e kuzhinës, bari i njomë) - nëse ky proces nuk kryhet në raportin e duhur rrezikon që mbetjet të çlirojnë erëra kundërmuese.

Figura 51: Foto nga procesi i monitorimit të familjeve gjatë aplikimit të kompostimit



Burimi: Instituti i Politikave Mjedisore

Në përfundim të projektit, u realizua edhe një takim përmbyllës në qytetin e Tiranës, ku morën pjesë fermerë të zonës së Baldushkut, përfaqësues të bashkisë së Tiranës dhe përfaqësues të OSHC-ve. Pjesëmarrësit u njohën me projektin, aktivitetet e zbatuara dhe arritjet e tij. Fermerë kishin sjellë edhe një sasi të vogël humusi të përfutur nga procesi i kompostimit, si një shenjë simbolike e arritjeve të projektit. Në këtë takim, përfaqësuesve të bashkisë iu kërkua që të ndërmarrin më tepër aktivitete ndërgjegjësuese për të promovuar konceptin e kompostimit në familje në zonat rurale si një alternativë e qëndrueshme e menaxhimit të mbetjeve dhe e promovimit të konceptit të ekonomisë qarkulluese.

Figura 52: Foto nga takimi i fundit i projektit të zbatuar nga IPM



Burimi: Instituti i Politikave Mjedisore

### 3.6.3 SUGJERIME

- Mbulim më i mirë i zonave rurale me kosha për grumbullimin e mbetjeve urbane;
- Aplikimi i hierarkisë së mbetjeve dhe promovimi i praktikave 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim)
- Promovimi i praktikave të kompostimit në familje apo në shkallë më të gjerë, në nivel fshati apo njësie administrative;
- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese për të rritur njohuritë për të mirat e kompostimit të mbetjeve organike;
- Incentivimi, aty ku është e mundur, i familjeve të cilat aplikojnë kompostimin;
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet fermerëve dhe biznese të cilat tregtojnë inpute bujqësore si një mënyrë për të incentivuar procesin e kompostimit. Në këtë mënyrë produkti i fermerëve mund të sjellë të mira ekonomike për ta.

## 3.7 PROJEKTI: MONITORIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE NËPËRMJET DIXHITALIZIMIT TË TË DHËNAVE

**Organizata zbatuese:** [Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit](#)

**Vendi i zbatimit:** Bashkia Divjakë, Roskovec, Kavajë

### 3.7.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES

Në kuadër të arritjes së objektivave në vitin 2030, parlamenti shqiptar ka miratuar ligjin Nr. 155/2020<sup>33</sup> për ndryshimet klimatike, i cili ka për qëllim të kontribuojë në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, të mundësojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe të kontribuojë në përpjekjet globale ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet plotësimit të detyrimeve të Shqipërisë ndaj Konventës. Specifikisht, sipas këtij ligji<sup>34</sup>, institucionet vendore e bizneset janë të detyruara të raportojnë në kohë reale tek Agjencia Kombëtare e Mjedisit mbi gjendjen e klimës, e gazet serrë. Bashkitë në Shqipëri kanë mungesa të kapaciteteve dhe njohurive mbi ndërtimin e inventarëve të gazeve serrë e rrjedhimisht nuk kanë ngritur një databazë e cila do t'i shërbejë për monitorimin e vazhdueshëm të këtyre gazeve.

Energjia, e në veçanti arritja e sigurisë energjetike duke ekuilibruar faktorin klimaterik, është prioritet kryesor sot i vendeve në botë. Shqipëria si nënshkruese e marrëveshjes së Parisit dhe vend kandidat i Bashkimit Europian ka detyrim arritjen e objektivave për reduktimin e gazeve serrë, uljen e konsumit të energjisë dhe arritjen e sigurisë energjetike.

<sup>33</sup>[https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/2021010413081820201227203009ligji%20nr.%20155,%20dt.%2017.12.2020\\_compressed.pdf](https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/2021010413081820201227203009ligji%20nr.%20155,%20dt.%2017.12.2020_compressed.pdf)

<sup>34</sup> Neni 23 (pika ë), neni 29

Në vitin 2020, Bashkimi Europian miratoi Axhendën e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet të cilës i orienton vendet e BP të bëjnë të mundur dekarbonizimin e sektorëve duke i dhënë prioritet klimës, energjisë dhe lëvizshmërisë. Për të arritur neutralitetit të klimës deri në vitin 2050, qytetet duhet të rishikojnë praktikën e qeverisjes — për këtë arsye, Komisioni Europian ka propozuar reduktimin e emisioneve të gazeve serrë me 55% deri në vitin 2030. Sipas Axhendës së Gjelbër, sektori i ndërtesave është një nga sektorët kryesorë i cili ka potencialin më të lartë për kursimin e energjisë. Instrumente të ndryshme financiare (si kontrata e performancës së energjisë, kreditë e buta, etj.) mund të përdoren për të arritur një nivel më të lartë të shkallës së rinovimit të ndërtesave private dhe atyre publike, duke përfshirë elemente të efikasitetit të energjisë.

Kërkesa për energji në sektorin e ndërtesave publike përfaqëson një sfidë për Shqipërinë. Në vitin 2015, konsumi final për energji ishte rreth 37% e kërkesës kombëtare për energji. Cilësia e shërbimit të shpërndarjes së energjisë në ndërtesa është shumë më e ulët sesa është në vendet e Bashkimit Europian. Referuar Atlasit Global të Karbonit, niveli i emetimeve në Shqipëri përgjatë vitit 2020 ka qenë 4.5 Mt. CO<sub>2</sub>.

Bashkitë sot janë nën një presion të zhvillimit ekonomik që përbëhet nga shumë sektorë përgjegjës për nivelet e tanishme të emetimeve të karbonit. Zhvillimi ekonomik në shumë sektorë drejtohet nga trysni mjedisore, ekonomike e sociale, të cilat janë në konflikt me njëra-tjetrën. Rritja e çmimit të energjisë është një çështje tepër relevante që po i detyron bashkitë të përballen me një emergjencë energjetike nëpërmjet masave emergjente për të rritur efikasitetin e energjisë (e duke u shndërruar në qytete me karbon të ulët).

### 3.7.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Zhvillimi i një plani të efikasitetit të energjisë dhe klimës është një nga masat që janë të nevojshme për t'u ndërmarrë nga çdo bashki për të arritur objektivat e saj për efikasitetin e energjisë dhe reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë. Këto objektivat duhet të jenë si sasiore në natyrë (kWh dhe CO<sub>2</sub> të ruajtur) dhe cilësore, të filla si rritja e përgjegjësisë dhe ndërgjegjësimit në lidhje me dobitë e efikasitetit të energjisë dhe klimës. Nevoja për të përshtatur politikën e zhvillimit bashkiak me kërkesat e vendit dhe politikën e reja të BE-së, sa i përket reduktimit të emetimeve të gazrave serrë është një sfidë për secilën bashki në vendin tonë. Hartimi i planeve dhe zbatimi i masave të EE kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që ndikon në uljen e kërkesës për ngrohje dhe energji elektrike si dhe reduktimin e përdorimit të lëndëve djegëse të cilat janë ndotëse të mjedisit. Miratimi i një politike të tillë është një përparësi për të ndërmarrë veprime që çojnë në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Në këtë drejtim, projekti i zbatuar nga IMMT synon të asistojë tre bashki në vend, respektivisht bashkinë e Kavajës, Roskovecit, e Divjakës në vlerësimin e emetimit të

gazeve serë në disa sektorë kryesorë të ekonomisë dhe monitorimin e efikasitetit të energjisë të ndërtesave publike në këto bashki.

Me qëllim vlerësimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> dhe vlerësimin të konsumit të energjisë së godinave publike, zbatuesit e projektit krijuan platformën dixhitale "Monitorimi i gazeve serrë"<sup>35</sup>. Realizimi dhe zhvillimi i platformës dixhitale të monitorimit të konsumit të energjisë dhe vlerësimin të emetimit të gazeve serrë për çdo sektor është bazuar në "Protokollin e gazeve serre sipas qyteteve"<sup>36</sup> i cili konsiston në grumbullimin, verifikimin dhe raportimin e nivelit të gazeve serre brenda territorit të bashkisë.

Elementet kryesore të platformës konsistojnë në hedhjen e të dhënave mbi profilin e bashkisë (si numri i banorëve, PBB, sipërfaqja) dhe hedhja e të dhënave për sektorët e marrë në shqyrtim. Sektori i energjisë përbëhet nga 6 nën-sektorë (rezidencial, publik, bujqësor, shërbime, prodhimi dhe ndërtimi), dhe sektorë e tjerë përfshijnë transportin, mbetjet, proceset industriale dhe përdorimin e tokës.

Figura 53: Pamje e platformës dixhitale për monitorimin e gazeve serë



Burimi: InstitutInstituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit

Platforma u popullua me të dhëna nga pyetësorë për objektet nën administrimin e bashkive e vlerësimin e disa shërbimeve (si ndriçimi publik, shërbimi i menaxhimit të mbetjeve, transporti, sektori rezidencial, tregtar dhe i shërbimeve, bujqësia, peshkimi dhe

<sup>35</sup> <https://ghgcity.al/home>

<sup>36</sup> <https://ghgprotocol.org/greenhouse-gas-protocol-accounting-reporting-standard-cities>



pylltaria). Nëpërmjet mbështetjes e bashkëpunimit të bashkive në të cilat u zbatua projekti u mundësua aksesimi në këto të dhëna të cilat nuk ishin publike më parë.


Figura 54: Foto nga procesi i grumbullimit të të dhënave në bashkitë e projektit



Burimi: Institutul Institutit për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit


Pas procesit të grumbullimit të të dhënave, ato u përpunuan nga zbatuesit e projektit për të evidentuar sektorët të cilët emetojnë më tepër gaze me efekt serrë si dhe godinat në administrim të njësive të vetëqeverisjes vendore të cilat konsumojnë më tepër energji elektrike. Më poshtë paraqiten të dhëna të cilat evidentojnë institucionet të cilat konsumojnë më shumë energji elektrike në bashkitë e marra në studim.

Grafiku 15: Konsumi i energjisë elektrike në kWh në bashkinë Roskovec




Burimi: InstitutInstituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit

Grafiku 16: Konsumi i energjisë elektrike në kWh në bashkinë Divjakë



Burimi: InstitutInstituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit

Grafiku 17: Konsumi i energjisë elektrike në kWh në bashkinë Kavajë



Burimi: InstitutInstituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit

Përfaqësuesit e IMMT zhvilluan një seri trajnimesh 2 ditore në çdo bashki më qëllim rritjen e kapaciteteve e trajnimin e përfaqësuesve të bashkisë në përdorimin e platformës dixhitale, si dhe në editimin e të dhënave, në mënyrë që ata të ishin të aftë që këtë ushtrim ta kryenin e dhe në vijim, pas përfundimit të projektit.

Këto takime/trajnime shërbyen për të konsultuar edhe gjetjet e dala nga të dhënat e analizuara si dhe nisur një proces diskutimi për hartimin e Planeve Lokale të Veprimit për Energjinë dhe Klimën, të cilat tanimë janë detyrim ligjor për secilën bashki në vend.

Paralelisht me këto trajnime, zbatuesit e projektit nisën një proces diskutimi për projekte prioritare të cilat mund të hartoheshin nga ta, për të adresuar çështjen e konsumit të energjisë të evidentuar nga analiza e të dhënave. Në këtë drejtim, filloi një proces i hapur konsultimi me grupet e interesit për të diskutuar projekte potenciale të cilat mund të hartohen e zbatohen duke zbatuar element të efikasitetit të energjisë në secilën nga bashkitë e përfshira në projekt.

Figura 55: Foto nga procesi i konsultimit me grupet e interesit në bashkitë e projektit



Burimi: InstitutInstituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit

Në përfundim të procesit konsultimit janë hartuar tre projekte pilot për secilën nga bashkitë:

- Studim impiant foto-voltaik "Shkolla 9-Vjeçare Mehmet Babamusta", Bashkia Kavajë;
- studim impiant foto-voltaik "Godina e Re e Bashkisë Roskovec", Bashkia Roskovec;
- Studim impiant foto-voltaik "Stacioni i Pompave Vadtëse Sulzotaj", Bashkia Divjakë.

Nga gjetjet e projektit të financuar nga Green-AL, organizata IMMT ka hartuar një projekt propozim lidhur me investimin në efikasitetin e energjisë në një shkollë të mesme në bashkinë Kavajë, me të cilën ka aplikuar në projektin "EU for Municipalities" dhe ka fituar të drejtën për zbatimin e këtij projekti.

Si një nga aktivitetet i cili ka pasur qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit IMMT ka zhvilluar edhe disa takime me student të shkollave të mesme në shkollën “Miti Zoi Zaka”, Bashkia Divjakë; “Mahmut Babamust”, Bashkia Kavajë; “Aden Vrapi”, Bashkia Roskovec.

Figura 56: Foto nga takimet ndërgjegjësuere me studentët e shkollave të mesme në bashkitë e projektit



Burimi: InstitutInstituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit

### 3.7.3 SUGJERIME

- Ngritja e një platforme të unifikuar për vlerësimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> e cila përdoret nga të gjitha bashkitë në vend;
- Hartimi i “Planeve Lokale të Veprimit të Energjisë dhe Klimës” në përputhje me kërkesat e legjislacionit;
- Ngritja e një strukture në bashki për monitorimin e zbatimit të planit;
- Marrja e masave për dekarbonizimin e sektorëve të transportit, bujqësisë e sektorë të tjerë të cilët kanë vlera të larta emetimi të CO<sub>2</sub>;
- Përfshirja e “Prokurimit Publik të Gjelbër” në proceset e prokurimit nga ana e bashkive.

#### **Masa për reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> në ndërtesa:**

- Mbledhja e centralizuar e të gjitha të dhënave relevante për ndërtesat (karakteristikat e ndërtesave, vitet e ndërtesave, viti dhe përshkrimi i rindërtimeve, konsumi i energjisë i të gjitha llojeve, faturat mujore për energjinë e konsumuar, etj.);
- Përgatitja dhe përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit të ndërtesave;
- Kryerja e inspektimeve të energjisë në ndërtesa;
- Instalimi i sistemeve diellore për ngrohjen e ujit në objektet arsimore, kulturore, sportive dhe të administratës në pronësi të bashkive;

- Zëvendësimi i instalimeve të ndriçimit në institucionet arsimore me ato moderne, instalimet e ndriçimi që janë efikase në përputhje me normat dhe rregulloret europiane.

### 3.8 PROJEKTI: FUQIZIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR MROJTJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI

**Organizata zbatuese:** [Eco Partners for Sustainable Development](#)

**Vendi i zbatimit:** Njësitë administrative Zharrëz, Marinëz, Kuman, Verbas, dhe Sheqishte të bashkive Roskovec & Patos

#### 3.8.1 SFONDI/PREZANTIMI I TEMËS-ÇËSHTJES

Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, vendimmarrësve dhe bizneseve, arrihet duke fuqizuar zërin e OSHC-ve dhe komuniteteve vendore për të kërkuar të drejtat e tyre për të pasur një mjedis të shëndetshëm.

Informimi dhe pjesëmarrja e publikut në vendimet të cilat kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë mjedisore dhe shëndetin kanë hapësira për përmirësim. Komunitetet rurale janë të painformuara dhe të pa-fuqizuara që të reagojnë dhe të ushtrojnë presionin ndaj pushtetit vendor, për çështje në lidhje me monitorimin dhe rehabilitimin mjedisor. Projekti adresoi në mënyrë të drejtpërdrejtë mungesën e transparencës dhe informacionit rreth të dhënave të monitorimit të ndotjes mjedisore rreth vendeve ku operon industria nxjerrëse (Patos-Marinëz) si dhe vështirësitë e komunitetit dhe shoqërisë civile për të ngritur dhe për të adresuar zërin e tyre.

#### 3.8.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Pas hapjes së projektit në bashkëpunim me laboratorin e Universitetit Bujqësor të Tiranë, nisi procesi i matjeve të indikatorëve të ujit dhe të tokës në pikat e përzgjedhura në Aranitas, Zharrëz dhe zona përreth uzinës së përpunimit të naftës në Ballsh. Këto matje u bënë në dy periudha: janar – shkurt 2022 dhe maj – korrik 2022 për të parë diferencën dhe ndikimin e ndotjes në terren në periudha të ndryshme. Matjet e monitorimit të ajrit janë bërë në dy periudha të ndryshme përkatësisht prill-qershor 2022.

Pas përfundimit të matjeve, ekspertët përkatës u angazhuan në finalizimin e raportit të plotë mjedisor, duke vënë në krahasim të dhënat e përfuara nga matjet e mostrave të ujit, tokës dhe cilësisë së ajrit por dhe nga raporti vjetor i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Raporti ka ofruar të dhëna nëpërmjet vlerësimit nga ekspertë mjedisi të pavarur, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Laboratorin Shkencor të Mjedisit dhe Universitetin Polis. Gjetjet u konsideruan të dobishme për të sensibilizuar komunitetin e

prekur të zonës, organet e pushtetit vendor, shoqërinë civile dhe grupet e interesit. Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), si partner akademik, u angazhua në procesin e vlerësimit në terren dhe marrjes së mostrave të tokës dhe ujit. Matjet dhe të dhënat laboratorike për ajrin janë bërë të mundura nga Laboratori i Mjedisit, e Universiteti Polis. Matjet e ajrit u kryen nëpërmjet aparaturave portative *Aeroqual* (AQM 65 Ambient Air Monitoring Station), duke paraqitur në kohë reale minimumin, maksimumin dhe mesataren e ndotësve. Gjatë këtyre muajve, në partneritet me shoqatën "Epoka e Re", është hartuar pyetësi për vlerësimin ekonomik dhe social i cili u shpërnda *online*, si dhe përmes takime në komunitet dhe shkolla.

Paralelisht filloi puna dhe për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Social. Kujdes i veçantë iu kushtua përzgjedhjes së kampionëve të përfshirë në këtë proces vlerësues, në mënyrë që të sigurohej informacioni nga të gjitha kategoritë përbërëse të komunitetit: të rinjtë, amvisat, nënat e reja, qytetarët me problematika të shëndetit, qytetarë dhe grupe nga shtresa të marginalizuara.

Figura 57: Fotografi nga fushata e ndërgjegjësimit në bashkitë Patos e Roskovec



Burimi: Eco Partners for Sustainable Development

Gjatë periudhës qershor dhe shtator është kryer punë për finalizimin e Raportit të Vlerësimit Mjedisor, si komponent kryesor i projektit.

Në vijim u organizuan takime me komunitetet e adresuara të bashkive Patos dhe Roskovec, titullarëve të të cilave iu prezantuan gjetjet e raporteve.

**Fushata e Ndërgjegjësimit** - Prezantimi i projektit/raporteve në mënyrë të thjeshtuar në 6 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme të bashkive Patos dhe Roskovec.

**Fushata e Gjelbërimit** – Dy aksione gjelbërimi (mbjellje fidanësh) u organizuan në territoret e Bashkive Patos dhe Roskovec. U konsideruan zona me prioritet zonat më të ndotura nga industria naftë-nxjerrëse.

Figura 58: Foto nga procesi i gjelbërimit në bashkitë Patos e Roskovec



Burimi: Eco Partners for Sustainable Development

**Debat Konstruktiv** - Aktorët vendas, partnerët dhe komuniteti ishin pjesëmarrës në debatin konstruktiv, me qëllim evidentimin e nivelit të ndotjes në zonat e prekura nga industria naftë-nxjerrëse dhe fuqizimit të zërit të OSHC-ve dhe komunitetit.

Figura 59: Foto nga procesit i konsultimit të gjetjeve të projektit në bashkinë Roskovec



Burimi: Eco Partners for Sustainable Development



### 3.8.3 SUGJERIME

Ndotja në zonën Patoz-Marinëz është e hershme dhe do të vazhdojë për shumë vite. Kontributi i mëparshëm i aktiviteteve industriale në ndotjen e mjedisit nuk mund të diferencohet nga kontributi i viteve të fundit. "E drejta për jetën" dhe "E drejta për të pasur një mjedis të shëndetshëm" është sanksionuar në Konferencën e Stokholmit (1972), si e drejtë themelore e njeriut si dhe është e drejtë kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.<sup>37</sup> Shqipëria ka ratifikuar konventat ndërkombëtare për mjedisin dhe ka përafuar të drejtën mjedisore europiane, ku janë përcaktuar përgjegjësitë për institucionet, përfshirë dhe ato vendore.

Institucionet qendrore dhe vendore kanë të përcaktuar detyrimet për zbatimin e kuadrit ligjor për të mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

#### **Për bashkinë:**

Rekomandohet rishikimi i vlerave të raportimeve, dhe krahasimi i tyre me gjetjet në terren edhe nga palë të treta. Në vijim, rekomandohet dhe rakordimi i këtyre gjetjeve në funksion të përmirësimit të parametrave dhe të uljes së ndotjes në Patos-Marinëz.

Gjithashtu, rekomandohet adaptimi dhe zbatimi i "Sistemit të Monitorimit, Menaxhimit dhe Informimit Mjedisor" (SMMIM). Ky sistem i menaxhimit të mjedisit mund të shqyrtohet e të autorizohet nga këshilli bashkiak dhe të zbatohet nga punonjësit e bashkisë në bashkëpunim me komunitetin dhe grupet e interesit. SMMIM është në përputhje me standardet e BE dhe në përputhje me modelin e zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). Zbatimi i sistemit SMMIM bëhet i nevojshëm në rastet kur territori ka risk të lartë kontaminimi nga aktivitetet industriale siç është zona industriale e naftës Patos-Marinëz.

Shembulli më i mirë i bashkëpunimit të kompanive private me komunitetin është projekti TAP. Projekti ka kompensuar dëmet në pajtueshme me standardet më të larta të zbatuara nga BEI, BERZH, FMN dhe BB.

*Bashkia ka të drejtë jo vetëm të informohet nga subjektet por dhe të jetë palë e procesit të auditimit mjedisor.*

*Bashkia duhet të kërkojë pranë subjekteve që shfrytëzojnë burimet e naftës brenda territorit të saj, masa përmirësuese dhe kompensuese në përfitim të komunitetit si psh:*

- *Impiante për pastrimin e ujit, të cilat mund të instalohen me mbështetjen financiare të kompanive në qendër të fshatrave;*

---

<sup>37</sup> Kushtetuta e RSH

- Gjelbërimi i hapësirave publike;
- Rehabilitimi i rrugëve dhe i objekteve shkollore ose hapësirave sociale/rekreative;
- Mbështetje për fermerët për rehabilitimin e tokave të ndotura.

#### **Për shoqërinë civile:**

- E drejta e informimit për standardet që zbatojnë subjektet dhe për gjendjen e mjedisit. Në rastet e aksidenteve ose kur evidentohen problematika mjedisore, nga institucionet lokale dhe përfaqësuesit e komunitetit, duhet kërkuar jo vetëm përmirësimi i situatës por edhe masa zbutëse e kompensuese për komunitetin.

#### **Ndërgjegjësimi dhe edukimi mjedisor:**

- Komuniteti ose banorët e zonës duhet të kuptojnë efektet e ndotjes mbi shëndetin dhe të ulin nivelin e ekspozimit ndaj ndotjes;
- Shmangie kontakti (pirje dhe larje) me ujërat nëntokësorë ose uji i puseve të kontaminuar;
- Ndërgjegjësimi i banorëve dhe në veçanti fëmijët të shmangin kontaktet dhe dheun dhe ujin e ndotur;
- Forcimi i masave të higjienës dhe shmangia e hyrjes së mbetjeve në banesë me anë të rrobave të punës, këpucëve etj.

#### **Disa këshilla të dobishme për fermerët dhe banorët rurale:**

- Të shmanget kultivimi i perimeve dhe kulturave që konsumohen direkt nga njerëzit në afërsi të puseve ose zonave me shkallë të lartë ndotje;
- Të shmanget kullotja në afërsi të pellgjeve të naftës ose ujërave teknologjike dhe të mënjanohet pirja e ujit të kontaminuar nga kafshët shtëpiake;
- Te informohen qe kultivimi i misrit dhe jonxhës ndikon në shpërbërjen graduale të hidrokarbureve të akumuluar në tokë;
- Të bëjnë kujdes duke shmangur ujitjen e bimëve me ujëra të ndotur me naftë.

## **4.SUGJERIME DHE MASA**

Rajoni Qendror është rajoni me zhvillimin më të shpejt socio-ekonomik në vend, në të është përqendruar numri më i lartë i popullsisë rezidente, institucioneve kryesore administrative e arsimore si dhe përqendrimi më i lartë i ndërmarrjeve prodhuese në vend. Ky rajon shtyn përpara zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe ka mundësinë për të vendosur standardin për çështje mjedisore edhe për rajonet e tjera.

Territoret e këtij rajoni kanë diversitet dhe larmishmëri ku identifikohen zona me vlera të larta natyrore e të peizazhit, burimet ujore, malet dhe bregdeti të cilat duhet të zhvillohen

në mënyrë të qëndrueshme duke nxitur zhvillimin e turizmit dhe rritur mirëqenien social ekonomike të banorëve të këtij rajoni.

Nga ana tjetër zhvillimi është kthyer në kërcënim për burimet natyrore dhe mjedisin në tërësi, shfrytëzimi dhe ndotja e të cilit janë duke u kthyer në problematikë për banorët aktual por edhe shfrytëzimin e tyre nga brezat e ardhshëm e për këtë arsye duhet një qasje gjithëpërfshirëse duke marrë masa konkrete për mbrojtjen e tij. Ky është një konflikt jo i panjohur në histori, ruajtja e ekuilibrit midis zhvillimit dhe konservimit të vlerave natyrore ka pasur gjithnjë debat por rezultati është i fillë që ndërhyrjet kanë sjell çrregullim të funksioneve që njeriu i merr në formën e shërbimeve të ekosistemit sikundër edhe cenimin e cikleve natyrore, mikroklimës e rrjedhimisht cilësisë së jetës.

Mungesa e kontrollit të territorit dhe e monitorimit të vazhdueshëm të burimeve natyrore dhe shkarkimeve në mjedis ka lejuar prej më shumë se 1 dekadë që statusi i i disa komponentëve mjedisorë të degradojë, në disa raste edhe në mënyrë të pakthyeshme. Në një periudhë ku dixhitalizimi i informacionit është në nivelet më të larta të përdorimit të tij, e ndihmon ekspertët dhe politikë-bërësit në vendimmarrje, mungesa e aplikimit të tij në monitorimin e mjedisit dhe elementëve të tij është thuajse e pakuptueshme. Përdorimi i ortoimazherisë, sensorëve të cilët monitorojnë cilësinë e ajrit, ujit, zhurmës etj. është një mjet i cili do të rriste ndërgjegjësimin qytetar, do të ulte rastet e abuzimit dhe do të ofronte të dhëna në kohë reale, duke mundësuar kështu vendimmarrjen të bazuar në të dhëna.

Në aspektin mjedisor, reforma territoriale e vitit 2014 rezulton të ketë degraduar komponentë mjedisorë urbanë, habitate dhe shërbime të ekosistemit të cilët rezultojnë tërësisht të humbura. Nisur nga ky fakt, propozimi për rishikimin e mundshëm (në cilëndo periudhë kohore) do të ishte që territoret të shihen në funksion të marrëdhënies që kanë me natyrën dhe ekosistemin sesa në raport me statistikën apo orientimin politik të votueseve në këto territore. Thënë kjo, propozimi kahershëm i ekspertëve urbanistë dhe mjedisorë në Shqipëri për të ndarë rajonet sipas pellgjeve/ baseneve ujëmbledhës në vend mund të rimerret për të adresuar problematika të mirëmenaxhimit të territorit dhe lehtësuar monitorimin e tij.

Me qëllim adresimin e këtyre problematikave, duhet rritur përfshirja e publikut dhe grupeve të tjera të interesit në diskutimin për çështjet mjedisore, e përfshirja në mënyrë aktive gjatë procesve të rishikimit të legjislacionit, hartimit të planeve të menaxhimit të burimeve dhe zbatimit të projekteve rehabilituese, të cilat me gjasë do të ndikojë në ndërgjegjësimin e grupeve të interesit dhe marrjen e vendimeve gjithëpërfshirëse.

Një aktor i rëndësishëm në këtë proces janë organizatat e shoqërisë civile, të cilat kanë kapacitete dhe potencial për të shërbyer si një urë lidhëse ndërmjet komunitetit dhe institucioneve në nivel lokal e kombëtar për të lehtësuar dialogun e përçarur zërin e komunitetit në instancat përkatëse. OSHC-të mund të ofrojnë njohuritë e tyre në rritjen e kapaciteteve të administratës publike, informimin dhe edukimin e publikut, monitorimin

e sektorëve të ndryshëm mjedisor si dhe të përfshihen në proceset e përafrimit të legjisllacionit Shqiptar me atë të BE.

Disa masa për adresimi e problematikave mjedisore, në mënyrë joshteruese, paraqiten më poshtë:

- Konsolidimi dhe përditësim ciklik i planeve për menaxhimin e baseneve ujore;
- Monitorimi i baseneve ujore për të identifikuar, gjurmuar dhe parandaluar ndotjen apo shkarkimet në këto burime;
- Zbatimi i praktikave të bazuar te natyra për parandalimin e zvogëlimin e erozionit lumor e atij detar;
- Rikualifikim dhe rikonceptim i funksionit te rezervuarëve për vaditje si edhe HEC-eve të vogla sidomos atyre në brendësi të zonave të mbrojtura si edhe atyre që aplikojnë akumulim të ujit sipërfaqësor në tuba;
- Rehabilitimi i kanaleve vaditëse e kulluese, me qëllim shmangien e përmytjeve por edhe sportin ndaj bujqësisë;
- Monitorimi i cilësisë së ujërave të cilët përdoren për vaditje;
- Hartimi i një rregulloreje e cila përcakton qartë periudhën e vaditjes, pasi ndikon drejtpërdrejt prodhimin bujqësor dhe jetën e fermerëve;
- Monitorimi i llojit dhe sasisë së pesticideve të përdorur në sektorin e bujqësisë me qëllim shmangien e ndotjes së tokës;
- Rritja e asistence ndaj fermerëve lidhur me ndikimin e ndryshimeve klimatike në bujqësi;
- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuere lidhur me ndikimin e ndryshimeve klimatike në burimet ujore, bujqësi etj.;
- Ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urban;
- Shtimin dhe rinovimin e infrastrukturës së KUZ dhe KUB;
- Hartimi i planeve lokale për menaxhimin e cilësisë së ajrit në zonat urbane;
- Hartimi i planeve lokale për menaxhimin e ndotjes akustike në zonat urbane;
- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit dhe ndotjes akustike në zonat urbane;
- Marrja e masave për parandalimin e ndotjes së tokës nga aktiviteti mineral e industrial;
- Monitorimi i aktivitetit të industrisë së shfrytëzimit të hidrokarbureve me qëllim evidentimin në kohë të ndotjes potenciale në ujë, ajër e tokë;
- Promovimi i praktikave të kompostimit në shkallë të vogël (familje) e në shkallë të madhe (fshati, njësie administrative)
- Shtimi i infrastrukturës për grumbullimin e mbetjeve në zonat të cilat nuk marrin shërbim;
- Aplikimi i hierarkisë së mbetjeve;
- Aplikimi i parimit ndotësi paguan dhe përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit;
- Aplikimi i praktikave të ekonomisë qarkulluese për të kapur vlerën e produktit dhe ulur sasinë e mbetjeve;

- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe bizneseve për të promovuar eko-materialet dhe eko-dizajnin;
- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit lidhur me praktikën 3R dhe të mirat që sjell;
- Mbështetja e skemave incentivuese për bizneset që zbatojnë parimet e ekonomisë qarkulluese;
- Hartimi i planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura;
- Zbatimi i iniciativave për përfshirjen e komunitetit në menaxhimin e ZM-ve;
- Shtimin e burimeve njerëzore në monitorimin e ZM-ve;
- Hartimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor në administrim të bashkive;
- Aplikimi i masave për përfshirjen e komunitetit në mirëmenaxhimin e pyjeve;
- Instalimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për zjarret në pyje;
- Hartimi i planeve vendore të efikasitetit të energjisë;
- Incentivimi i qytetarëve të cilët duan të aplikojnë element të EE në banesat e tyre;
- Diversifikimi i burimeve të energjisë duke promovuar energjinë e rinovueshme me fokus te energjia diellore për auto konsum në nivel familjar.

## Referenca

Analiza e tregut Rajonal të Punës dhe Zhvillimit Ekonomik në Elbasan, Shtator 2021, IDRA. Buletini Mujor Klimatik, Instituti i Gjeoshkencave.

Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020 – 2035, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

LIGJ Nr. 124/2015 PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË, i ndryshuar.

LIGJ Nr. 155/2020 PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE.

MUSHKËRI TË GJELBRA PËR QYTETET TONA BOTIMI III, 2021, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. <https://drive.google.com/file/d/1wZS3il9ZQvksrbnZPA1wbNlSU1q8HVS/view>.

Niko Pano, Pasuritë ujore të Shqipërisë, Tiranë 2008.

Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar 2023, Agjencia Kombëtare e Zhvillimit të Territorit.

Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Tiranë-Durrës 2030, Agjencia Kombëtare e Zhvillimit të Territorit.

Plani i Menaxhimit të basenit Ujor për Basenin e Lumit Erzen, Qershor 2022, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor për Basenin e Lumit Ishëm, Prill 2022, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015 – 2023, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit 2023, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Raporti i Gjendjes në Mjedis 2021, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit, Tiranë 2019, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri, Maj 2017. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. [https://bujqesia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/12/Strategjia\\_U\\_K\\_korrik\\_2017\\_konsultim-1.pdf](https://bujqesia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/12/Strategjia_U_K_korrik_2017_konsultim-1.pdf)

Tregu i Punës 2021, INSTAT. <https://www.instat.gov.al/media/10066/tregu-i-punes-2021.pdf>

*The Alternative View of Environmental Progress*, April 2021. *Albanian's Negotiations with EU and Chapter 27*. [https://inca-al.org/media/files/2021/04/24/GREEN27\\_ShadowReport\\_Englisht\\_web\\_Final.pdf](https://inca-al.org/media/files/2021/04/24/GREEN27_ShadowReport_Englisht_web_Final.pdf)

*The Fourth National Communication of Albania on Climate Change*, September 2022, Ministry of Tourism and Environment.

Third National Communication of Albania to UNFCCC, March 2016, Ministry of Tourism and Environment.

Vjetari Rajonal Statistikor 2021, INSTAT. [https://www.instat.gov.al/media/9432/vjetari-statistikor-2021\\_final-29122021.pdf](https://www.instat.gov.al/media/9432/vjetari-statistikor-2021_final-29122021.pdf)

Vjetari Rajonal Statistikor 2022, INSTAT. [https://www.instat.gov.al/media/11123/vjetari-statistikor-rajon-al-2022\\_04.pdf](https://www.instat.gov.al/media/11123/vjetari-statistikor-rajon-al-2022_04.pdf)



© CoPLAN, 2023

*Ky material është pronësi intelektuale e  
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
Tiranë, Shqipëri*

